

DITURIA ISLAME

REVISTË MUJORE FETARE, SHKENCORE E KULTURORE • Nr. 418 • SHTATOR 2025



| SI TA PËRKUJTOJMË ME DINJITET
LINDJEN E PEJGAMBERIT A.S.

| EDUKIMI I FËMIJËVE NË MES TË
FAMILJES DHE SHKOLLËS

| MËSHIRA SI THELB I EDUKIMIT PROFETIK

Urimi i Myftiut Tërnavë, me rastin e fillimit të vitit të ri shkollor 2025/2026

Të dashur qytetarë,

Vëllezër dhe motra!

“Nxënia e diturisë është obligim për çdo besimtar dhe besimtare.” – Muhamedi a.s.

Sot po e dëshmojmë 1 shtatorin, ditën që shënon fillimin e vitit të ri shkollor për më të dashurit tanë, për fëmijët tanë me të cilët Zoti na bekoi dhe i dha shije dhe kuptim jetës sonë.

1 shtatorin – ditën e parë të shkollës, në rend të parë ua uroj me zemër të gjithë nxënësve tanë anekënd atdheut tonë të dashur, pastaj mësuesve, arsimtarëve dhe profesorëve, të cilët kontribuojnë në edukimin dhe arsimin e brezave, të gjithë prindërve që për shkollimin e fëmijëve të tyre nuk kursejnë asgjë nga vetja, e në fund uroj në veçanti të gjithë shkollarët që sot për herë të parë do të ulen në bankat shkollore.

Të dashur besimtarë!

Si prindër që jemi, kemi për obligim parësor edukimin dhe arsimimin e dhuratës më të çmuar me të cilën na bekoi Zoti Fuqiptotë. Në këto kohëra të vështira me plot sfida, kemi për obligim të shtojmë kujdesin prindëror dhe familjar, që fëmijët tanë t'i edukojmë drejt me vlera të larta morale, si dhe të kultivojmë te ta virtytet e çiltra fetare, kombëtare dhe njerëzore.

Këtij misioni të shenjtë prindëror mund t'ia dalim vetëm nëse kujdesemi – në rend të parë si familje – në mënyrë konsistente dhe duke bashkëpunuar ngushtë me mësimdhënësit në shkolla. Kështu do t'i ofrojmë shoqërisë fëmijë të edukuar dhe të arsimuar, të cilët do të jenë të dobishëm për veten e tyre, për familjen, për vendin dhe për mbarë kombin, e mbi të gjitha, faqebardhë do ta kryejmë misionin e shenjtë prindëror me të cilin na ka nderuar Zoti i Madh.

Lus të Madhin Zot që ky vit shkollor të jetë një vit i mbarë me plot suksese, një vit i ngritjes së cilësisë së edukimit dhe shkollimit, një vit i kultivimit të virtyteve morale!

Me punë, angazhim, këmbëngulje dhe sakrificë, rezultatet nuk mungojnë asnjëherë.

Urime viti i ri shkollor!

Myftiu i Kosovës,

Naim ef. Tërnavë

- 2 Urimi i Myftiut Tërnavë, me rastin e fillimit të vitit të ri shkollor 2025/2026

EDITORIAL

- 4 Përmbysja e injorancës me lindjen e më të mirit njeri

FETARE

- 5 Si ta përkujtojmë me dinjitet lindjen e Pejgamberit a.s.
Dr. Rijad Imeri
- 8 Pejgamberi Muhamed a.s. – burim i pakontestueshëm i normave juridike islame
Dr. Selatin Mehani
- 13 Pejgamberi a.s., model i përkryer i jetës bashkëshortore dhe familjare (1)
Prof. ass. dr. Ilmije Kuqi
- 17 Mëshira si thelb i edukimit profetik
Rashit Zylfiu
- 20 Ngjarja e elefantit – një qasje klasike dhe moderne
Prof. ass. dr. Valmire Batatina – Krasniqi
- 24 Muhadramët – bashkëthemelues të hallkës së parë të medhhebit hanefi
Dr. Muhamed Stublla
- 28 Eutanazia në optikën e fesë islame
Verona Rrahmani



FAMILJE & EDUKIM

- 31 Komponentët e edukimit ndërmjet asaj se çka lipset të jenë dhe realitetit
Dr. Myrvete Allmeta
- 34 Teoria para përvojës – edukimi qytetar pa themel vleror
PhD. Merjeme Gashi



DITURIA ISLAME

Revistë mujore fetare, shkencore e kulturore

Nr. 418 • viti 38 • Shtator 2025
• Rebiul Evvel 1447
• Çmimi 1 €

Boton

Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, Prishtinë

Redaksia

Kryeredaktor: Mr. Driton Arifi

Anëtarë:

Dr. Ejup Haziri, Merita Boroci,
Mr. Muharrem Tërnavë,
Mr. Vedat Shabani.

Sekretar & lektor: Bajram Zeqiri

Redaktor artistik & teknik:
Bashkim Mehani

Adresa

"Dituria Islame",
rr. "Bajram Kelmendi", nr. 182,
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel: +384 38 224 024

E-mail: redaksia@dituriaislame.net
www.dituriaislame.net

Shtypi:
"Printing Press", Prishtinë.



- 37 Edukimi i fëmijëve në mes të familjes dhe shkollës – nevoja për një modelim të integruar
Prof. ass. dr. Ferdi Kamberi

- 42 Shkolla, dija dhe vlerat e tyre
Imer Topanica

- 45 Intoleranca në ushqim
Agron M. Rexhepi, MD, PhD, MSc, Urata Rexhepi,
Nderim Rexhepi

KULTURË

- 48 Ndikimi i mendimit orientalist në Perëndim
Abdulvehab el Karesh
- 50 El Biruni - një studiues i gjithanshëm
Sead Ahmetaj
- 53 Fakulteti i Studimeve Islame në Prishtinë – ombrellë e dijes islame
Dr. Azmir Jusufi

AKTIVITETE

- 58 Myftiu Tërnavë priti në takim lamtumirës këshilltarin për Çështje Fetare të Turqisë, z. Bunjamin Albayrak





Përmbysja e injorancës me lindjen e më të mirit njeri

“Allahu nuk më ka dërguar që t’ua vështirësoj (jetën njerëzve), as që të sillem ashpër, por më ka dërguar si mësues dhe lehtësues.”

(Muslimi, 1478)

Në një periudhë të venitjes së udhëzimit hyjnor mbi faqen e dheut, si dhe në një kohë të braktisjes së rrugës së drejtë, dhe mu në atë trevë që injoranca ishte kryefjala e njerëzve të saj, Allahu i Gjithmëshirshëm për zgjodhi ta dërgonte një njeri që do ta rigjallëronte misionin e profetësisë që andejpari, kishte kohë që ishte harruar edhe aroma e tij. Makthi i injorancës i cili kishte lëshuar shtat krejt në fqinjësi të Shtëpisë së Shenjtë-Qabesë, kishte stisur idhujtarinë si besim, kaosin si rend, padrejtësinë si autoritet, ndërsa dijen dhe urtësinë si luks që se vrite mendjen askush për to. Gjendja e njerëzimit ishte parandjellëse për të keq, dhe klithte me rënkim për nevojën e lindjes së dikujt, që njeriut do t’i tregonte përsëri se çfarë do të thotë të jesh njeri. Mu atëherë, dhe për një synim aq të dëlirë lindi më i miri njeri – Muhamedi, paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi të.

Muhamedi a.s. është vula e profetësisë, lindi dhe u dërgua në atë nënqiell të vrenjtur, por të shenjtë e sigurisht të paharruar nga Zoti i tij. Në sytë e shumë vrojtuesve, dërgimi i tij në cilindo vis tjetër do të denjonte më shumë, ngase ai në atë kohë nuk ngjasonte me një truall të pëlleshëm për risaletin e tij. Kurrsesi, vendimet e Krijuesit, s’lejnë vend për rastësi. Lindja, dërgesa, jetesa e vuajtjet e tij, mu në atë vend, që të gjitha ishin brenda “hartës së qëndisur” të kaderit të Zotit. Ai e bëri të qartë këtë gjë kur në Kuran tha: “Është e vërtetë se Allahu u dha dhuratë të madhe besimtarëve, kur ndër ta, nga mesi i tyre dërgoi të dërguar që atyre t’u lexojë shpalljen e Tij, t’i pastrojë ata, t’ua mësojë Librin dhe urtësinë, edhe pse, më parë ata ishin krejtësisht të humbur.” (Ali Imran, 164). Përshkrimi hyjnor nga Zoti ynë për gjendjen e lajthitjes së skajshme të atyre njerëzve ishte i spikatur. Andaj, nga mesi i tyre lindi i Dërguari, i cili ndryshe nga ç’mund të pritej filloi misionin e tij me ftesën kumbuese për përndritje të mendjes e për dituri. Përzgjedhja e tij si i dërguar vërtet ishte begati, e asaj kryebegatie pa asnjë mëdyshje i parapriu vetë mirësia e lindjes së tij.

Çdo njeri që dijen e merr si busull të jetës, e urtësinë e ka aspiratën më të lartë të rrugëtimit të tij, lindjen e Muhamedin a.s. e sheh si dritë shprese në një botë të zhytur në injorancë e mizori. Një bote të dehur në sorollatje e amulli, iu dërgua ai që kumbueshëm do ta ftonte për këndellje, besim në një Zot e fisnikëri. Ai, ballëhapur do të përkufizonte misionin e tij si një mësues, që po ua mësonte njerëzve të mirën, e po ua lehtësonte vështirësitë e tyre në jetë, siç edhe transmeton Xhabiri se e ka dëgjuar atë duke thënë: “Allahu nuk më ka dërguar që t’ua vështirësoj (jetën njerëzve), as që të sillem ashpër, por më ka dërguar si mësues dhe lehtësues.” (Muslimi, 1478). Andaj sot, nesër e kurdoherë gjer në kataklizëm, secili mësues ka të drejtë të krenohet se me këtë epitet të dëlirë, dikur u cilësua edhe më i miri njeri. Mësues, në parim ishte pra edhe vetë ai.

Premisat për suksesin e tij, për shumëkënd ngjasonin me një mirazh: sa më afër që dukej, aq më shumë shuhej shpresa tek i eturi për ujë e freski. A. Lamartine (filozofi e poeti francez) kishte të drejtë kur shprehej: “Jam pyetur: A ishte Muhamedi profet? Dhe unë përgjigjem: Shikoni jetën e tij!...Nëse madhështia e qëllimit, vogëlsia e mjeteve dhe madhështia e rezultateve janë tri kriteret e gjeniut njerëzor, atëherë kush ka guximin ta krahasojë ndonjë burrë të madh të historisë me Muhamedin?” (Histoire de la Turquie, 276 /1).

Andaj, në vend të marrjes së ngjarjes sihariqese të lindjes së tij si pikënisje për polemika ngatërruese e irriti, të cilat jo rrallë përfundojnë me akuza të ndërsjella pa shije e me gjasë dhe pa dituri, do të duhej që në çdo kohë t’i kthehemi me zell studimit të lindjes, jetës dhe veprimtarisë së tij! E, përtej debateve shterpë të mbushura me pezëm, e ndiejmë thellë në shpirt se sevdaja e rikujtimit të lindjes së Muhamedit a.s., është krejt e natyrshme, hiç e shtirur, dhe si e tillë nuk mund të shuhet nga frika tashmë e tretur e shenjtërimit të tepruar të figurës së tij.

Mr. Driton Arifi

Si ta përkujtojmë me dinjitet lindjen e Pejgamberit a.s.

Dr. Rijad Imeri

LINDJA SI MESAZH HYJNOR DHE PROCES NATYROR

Lindja, si vendim hyjnor dhe si proces natyror, ngërthen në vete mesazhe të fuqishme për intelektin e njeriut, të cilat duhet të lënë gjurmë në zemrën dhe jetën e tij, në formimin e personalitetit të tij, në botëkuptimet dhe konceptet e tij, rreth vetes së tij dhe rreth çdo gjëje që ekziston rreth tij.

Kjo ngase pa pikënisje nuk ka proces, e pa proces nuk ka as finalizim, e udhëzimi hyjnor na i sqaron më së miri ligjet hyjnore në natyrë. Kjo në njërën anë tregon madhështinë e Krijuesit dhe të krijimtarisë së Tij dhe në anën tjetër tregon se çdo krijesë, e cila jeton në

përputhshmëri me ligjet e Krijuesit në natyrë, do të arrijë mirëqenien dhe lumturinë e saj dhe çdo tentim-largimi nga kjo harmoni, shkakton devijim dhe shkatërrim.

Fjalët hyjnore pa reshtur ia rikujtojnë qenies njerëzore këto parime, sa që Zoti e emërtoi Kuranin edhe si Rikujtues (Dhikr), ia sqaroi dobinë e rikujtimit duke thënë: “Rikujto, sepse sigurisht rikujtimi u bën dobi besimtarëve.” (Dharijat 55), ashtu siç i sqaroi konsekuencat e atyre që i shmangen këtij rikujtimi hyjnor: “E kush i shmanget rikujtimit Tim, ai do të ketë jetë të vështirë...” (Ta Ha 124).

Lindja është një vendim hyjnor dhe proces natyror që mbart mesazhe të fuqishme për njeriun. Pa pikënisje nuk ka proces, e pa proces nuk ka finalizim.



E pasi që Kurani është multidimensional në mësimet e tij, po ashtu edhe rikujtimet e tij janë nga më të ndryshmet, duke filluar nga krijimi i këtij universi, që ende shkencëtarët vazhdojnë të mbesin gojëhapur para këtij fakti, e gjer te gjallesat më të thjeshta: “A nuk e dinë mohuesit, se qiejt dhe Toka kanë qenë një tërësi, e Ne i kemi ndarë ato; e nga uji Ne kemi krijuar çdo gjë (të gjitha gjallesat)? Dhe vallë, nuk po besojnë ata?” (Enbija 30).

Ai flet edhe për pikënisjen e njeriut, si qenie e dalluar nga të tjerat: “(Rikujtoju atyre) kur Zoti yt u tha engjëjve: “Me të vërtetë, Unë do ta krijojë një (krijesë) njeri prej balte.” (Sad 71); Flet edhe për origjinën e qenieve paralele që jetojnë mbi sipërfaqen e tokës: “E xhindet i krijoj prej flakës së zjarrit.” (Rahman 15).

SHEMBUJ TË KRIJIMIT DHE PROFETËT

E një vëmendje të veçantë ia kushtoi njeriut të parë Ademit a.s., duke e bërë krijimin e tij në formë të përkryer dhe vazhdimin e racës së tij njerëzore si një ndër argumentet më të fuqishme të ekzistimit të Krijuesit absolut: “Dhe, prej argumenteve të Tij (Zotit), është që ju u krijuat prej dheut, pastaj përnjëherë jeni bërë njerëz dhe jeni shpërndarë në të gjitha anët.” (Rum 20); Hodhi dritë edhe mbi fazat e zhvillimit të embrionit: “O ju njerëz, nëse dyshoni për ringjalljen, atëherë (mendoni krijimin tuaj). Ne u krijuam ju prej dheu, pastaj prej uji, pastaj prej një gjaku të ngjizur, pastaj prej një sa kafshatë mishi, që është krijesë e formuluar ose e pa formuluar, në mënyrë që t’ju sqarojmë. Ne e përqendrojmë në mitër deri në një afat të caktuar, e mandej u nxjerrim foshnje dhe ashtu të arrini pjekurinë tuaj. Ka që dikush prej jush vdes herët, e dikush të jetojë deri në pleqëri të thellë, në mënyrë që mos dijë asgjë nga dija që ka pasur. E ti e sheh tokën e thatë-të vdekur, e kur Ne ia lëshojmë asaj ujin ajo gjallërohet, shtohet dhe nga të gjitha llojet rritë bimë të këndshme. Këtë (që ta dini) se Allahu është Ai i vërteti dhe se Ai ringjallë të vdekurit dhe Ai ka fuqi për çdo gjë.” (Haxh 5).

E nga rikujtimi i fuqisë absolute të Allahut ishte edhe krijimi i Isait a.s., vetëm nga një femër e virgjër, duke i thyer ligjet e zakonshme në të cilat zhvillohet jeta njerëzore: “Ai (Xhibrili) tha: “Ja, kështu ka thënë Zoti yt; ajo për Mua është lehtë, e për ta bërë atë (djalë e krijuar pa babë) argument për njerëzit e edhe mëshirë nga ana e Jonë. Kjo është çështje e kryer!” (Merjem 21).

E Isai a.s. ishte mirënjohës ndaj kësaj dhuntie hyjnore, për këtë thoshte: “Dhe, le të jetë selami (paqja, shpëtimi) mbi mua në ditën që kam lindur dhe në ditën që do të vdes dhe në ditën që do të ringjallem!” (Merjem 33).

E gjithë kjo dëshmon se besimtari është mirënjohës dhe falënderues ndaj Krijuesit të tij, kurse profetët e Zotit a.s. ishin falënderuesit dhe lavdëruesit më të mirë të Zotit të madhërisëm dhe shëmbëlltyra më e mirë për pasuesit e tyre.

Lindja e cila e bëri të ndryshoi rrjedhën e historisë njerëzore, padyshim, është lindja e ndritur e Pejgamberit tonë, Muhamedit a.s.


LINDJA E MUHAMEDIT A.S. DHE MESAZHI I SAJ

Muhamedi a.s., si përmbyllës i pejgamberisë dhe shpalljes hyjnore, mbetet modeli më fisnik për ne, se si të madhërohet e falënderohet Krijuesi Fuqiplotë për mirësitë e Tij në përgjithësi dhe mirësinë e jetës në veçanti.

Ai a.s., për ta shprehur përluljen ndaj Zotit të Tij dhe mirënjohjen e thellë për mirësitë e tij, agjëronte çdo të hënë, saqë shokët e tij, kureshtar për ta njohur këtë sekret të këtij adhurimi javor të Muhamedit a.s. e pyetën dhe i thanë: “O i Dërguar i Zotit, ne po të shohim që po agjëron çdo të hënë, a na e tregon arsyen e agjërimit tënd? Ai u përgjigj: “Unë agjëroj të hënave, sepse në këtë ditë kam lindur, në këtë ditë jam përzgjedhur si Pejgamber dhe në këtë ditë më është shpallur Kurani.”¹

Muhamedi a.s. e llogariste përzgjedhjen e tij si Pejgamber dhe shpalljen e Kuranit si një jetë të dytë të tij, për këtë ishte falënderues ndaj Allahut sa herë që vinte ajo ditë, por ky falënderim nuk do të ishte i përmbushur nëse nuk do ta falënderonte Krijuesin edhe për jetën e tij të parë, pra për lindjen e tij.

E për lindjen e tij, ai thoshte me krenari: “Unë jam lutja e babait tim Ibrahimit a.s., paralajmërimi dhe përgëzimi i Isait a.s. dhe nëna ime kishte parë (në ëndërr) se po dilte nga ajo



Lindja e Muhamedit a.s. ishte paralajmërim i ngadhënjimit të dritës së udhëzimit kundrejt errësirës së devijimit, i ngadhënjimit të diturisë kundrejt injorancës, i ngadhënjimit të dinjitetit njerëzor kundrejt shfrenimit shtazor dhe i ngadhënjimit të drejtësisë hyjnore kundrejt padrejtësisë njerëzore.

një dritë madhështore e cila i ndriçoi edhe pallatet e Damaskut.”²

Po ashtu, ai në mënyrë praktike ua mësonte shokëve të tij një lutje tejet të bukur dhe mbresëlënëse, duke e quajtur atë edhe si “zonja e lutjeve”, e në të cilën, duke e rikujtuar pikënisjen e tij, thoshte: “Zonja e lutjeve është të thuash: “O Allah, Ti je Zoti im, nuk ka Zot tjetër pos Teje, më ke krijuar mua dhe unë jam rob i yt, unë do të qëndroj në besën tënde dhe premtimin tënd aq sa të kem mundësi...”³

E familja e Pejgamberit a.s., të edukuar nën pishtarin hyjnor, dinin se si të ishin të mirësjellshëm në raste gazmore, sidomos atëherë kur ndodhte ndonjë lindje në një shtëpi. Husejni r.a., nipi i Muhamedit a.s., i përgëzonte ata prindër që ishin begatuar me fëmijë me këto fjalë: “Begatia e Allahut qoftë mbi dhuratën tuaj, e falënderofshi Dhuruesin tuaj, u rrit me shëndet të plotë dhe u furnizofshi me mirësjelljen e tij!”⁴

Kështu besimtari i gëzohet lindjes së çdo foshnje, ngase çdo foshnje është një shpresë e ardhmërisë sonë të përbashkët. Autorja e mirënjohur amerikane, Eda J. Leshan, e përshkruan lindjen e një foshnje në këtë formë: “Një foshnje e porsalindur është si një fillim i çdo gjëje, është një mrekulli, një shpresë dhe një ëndërr e të gjitha mundësive.”

E lindja, e cila e bëri të ndryshoi rrjedhën e historisë njerëzore, padyshim, është lindja e ndritur e Pejgamberit tonë, Muhamedit a.s., të cilën Zoti i Madhërishëm në mënyrë përkëdhelëse ia rikujtonte atë atij duke i thënë: “A nuk të gjeti ty jetim, e të siguroi vendstrehim?!” (Duha 6).

Sikur ky citat kuranor na aludon në atë, se secili person, i cili ndjehet jetim, i vetmuar, i braktisur, i huaj në këtë botë, do të gjej vendstrehim dhe prehje në jetëshkrimin e Muhamedit a.s., që nga lindja e tij e gjerë në ato momente kur

ia dorëzoi shpirtin e tij të dëlirë Zotit të Lartësuar dhe se lindja e tij është dritë që duhet ta ndriçoj çdo pallat dhe çdo shtëpi, ashtu siç e ëndërroi edhe nëna e tij dhe ashtu siç e përshkroi Zoti i Madhërishëm atë në librin e Tij: “O ti Profet, ne të dërguam ty si dëshmitar, përgëzues e paralajmërues dhe thirrës për tek Allahu me lejen e Tij si dhe kandil ndriçues.” (Ahzab 46).

Lindja e Musait a.s. ishte paralajmërim për fundin e Faraonit dhe tiranisë së tij, fundin e robërisë së popullit të tij, fundin e mizorisë, mashtrimit dhe padrejtësisë, për këtë ai i tmerruar nga kjo mundohej t'i shmangej këtij fundi duke i mbytur foshnjat e porsalindura, por urtësia e Zotit është mbi çdo dredhi të njeriut.

Po ashtu, edhe lindja e Muhamedit a.s. ishte paralajmërim i ngadhënjimit të dritës së udhëzimit kundrejt errësirës së devijimit, i ngadhënjimit të diturisë kundrejt injorancës, i ngadhënjimit të dinjitetit njerëzor kundrejt shfrenimit shtazor dhe i ngadhënjimit të drejtësisë hyjnore kundrejt padrejtësisë njerëzore.

Shkatërrimi i Abrahas dhe ushtrisë së tij gjigante nga zogi të vegjël para lindjes së Muhamedit a.s., si dhe lëkundjet dhe rrëzimet e idhujve për toke,⁵ ishin një paralajmërim dhe manifestim shtesë që ndodhi pikërisht në momentet që lindi ai, ngase lindja e tij ishte hapi i parë drejt ndryshimit të cilin e priste me shekuj shoqëria njerëzore në përgjithësi dhe besimtarët në veçanti.

Lindja, jeta dhe veprimtaria e Muhamedit a.s. mbetet frymëzimi më i mirë i çdo besimtari/e, në çdo kohë dhe në çdo vend, ngase ajo na mëson se si ta vlerësojmë jetën tonë, se si t'i njohim potencialet tona e t'i shfrytëzojmë ato në të mirë të vetes e të shoqërisë, se si të mos dekurajohemi para sfidave të jetës dhe të mos gjuhëzohemi para presionit të injorancës, ngase Zoti asnjëherë nuk i braktisë robërit e Tij, se si ta ndërtojmë jetën tonë dhe familjen tonë mbi parime hyjnore, të cilat na sigurojnë dinjitet në këtë botë dhe në botën e përherëshme, se si të unifikojmë në rrugën e tij, se si ta shijojmë ëmbëlsinë e besimit, ëmbëlsinë e paqes dhe drejtësisë, se si t'i mëshirojmë krijesat e Zotit, që përmes saj ta fitojmë mëshirën e të Gjithmëshirshmit, Mëshirëplotit, ashtu siç i edukonte Pejgamberi i mëshirës shokët dhe pasuesit e tij duke u thënë: “Të mëshirshmit i mëshiron i Gjithmëshirshmi, mëshironi ata që janë në tokë, do të ju mëshiroj Ai që është në qiell.”⁶

1 Muslim b. Haxhaxh, *Sahih Muslim*. (2, Kajro, Shtypshkronja Isa el Babij, 1955), 819.

2 Ahmed b. Hanbel, *Musned Imam Ahmed*. (36, Muesesetu Risaleh, 2001), 596.

3 Muhamed Ismail El Buhari, *Sahih el Buhari*. (5, Damask, Dar ibën Kethir, 1993), 2323.

4 Jahja b. Sheref Neveviu, *El Edhkar*. (Bejrut, Dar el Fikr, 1994), 289.

5 Ibën Kethiri në librin e tij “*El Bidaje ve Nihaje*” thotë: “E kanë regjistruar shumë autorë të biografisë profetike se janë rrëzuar idhujt në momentet e lindjes së tij fisnike dhe kjo është një mrekulli më kuptimplote dhe më e fuqishme se sa thyerja e një idhulli me dorë”.

6 Sulejman b. Eshath Ebu Davud, *Sunen Ebi Davud*, (7, Dar er Risaleh 2009), 298.

Pejgamberi Muhamed a.s. – burim i pakontestueshëm i normave juridike islame

Dr. Selatin Mehani

Në terminologjinë e muhadithëve, Suneti përfshin gjithçka që i atribuohet Pejgamberit a.s., nga thëniet, veprimet, miratimet, si dhe cilësitë e tij morale e fizike, qoftë para shpalljes, qoftë pas saj.

HYRJA

Pejgamberi Muhamed a.s. përbën figurën qendrore të besimit islam dhe burimin themelor të ligjësisimit pas Librit të Allahut. Ai nuk është vetëm bartës i shpalljes hyjnore, por edhe interpretues, sqarues dhe zbatues i saj në realitetin praktik të jetës së myslimanëve. Në shkencën e Usul el fikh, Suneti i Pejgamberit a.s. zë vendin e dytë në hierarkinë e burimeve të Sheriatit, duke qenë referencë e pakontestueshme për nxjerrjen e normave juridike islame, në harmoni dhe plotësim të dispozitave kuranore. Rëndësia e

kësaj teme qëndron në faktin se në epokat e ndryshme historike, përfshirë edhe kohën bashkëkohore, janë shfaqur mendime që nënvlerësojnë ose vënë në dyshim autoritetin normativ të Pejgamberit, duke pretenduar mjaftueshmërinë e Kuranit si burim i vetëm. Një qasje e tillë bie ndesh me konsensusin (ixhmanë) e dijetarëve të ymetit¹ dhe me parimet themelore të jurisprudencës islame. Për këtë arsye, sqarimi i bazës tekstuale, teorike dhe historike të autoritetit të tij në fushën e legjislacionit është domosdoshmëri për çdo studiues të Sheriatit.



PËRKUFIZIMI I SUNETIT NË JURISPRUDENCËN ISLAME

Duke qenë se autoriteti i Pejgamberit Muhamed a.s. në ligjësimin islam manifestohet kryesisht përmes Sunetit të tij, është e domosdoshme të sqarohet kuptimi i termit Sunet në disiplinat e ndryshme islame, në mënyrë që të kuptohet saktësisht roli i tij si burim i normave sheriatike. Termi Sunet “السنة” përbën një nga konceptet themelore të jurisprudencës islame dhe ka rëndësi qendrore në studimet e Usul el fikh. Përdorimi i tij nuk është njëdimensional; përkundrazi, kuptimi ndryshon sipas disiplinës shkencore dhe kontekstit metodologjik. Prandaj, para trajtimit të autoritetit të Sunetit si burim i normave sheriatike, është e domosdoshme sqarimi i përkufizimeve të tij në fushat kryesore të dijes islame.

Kuptimi gjuhësor

Në gjuhën arabe, fjala ‘sunnet’ nënkupton rrugë, metodë ose praktikë e ndjekur,² pavarësisht nëse është e mirë apo e keqe.³ Ky kuptim përfshin çdo model sjelljeje të përsëritur dhe të pranuar nga një grup apo komunitet. Shembull i këtij përdorimi gjendet në hadithin profetik: “Kush vendos në Islam një rrugë të mirë (سنة حسنة), ai do të ketë shpërblimin e saj dhe shpërblimin e atyre që veprojnë sipas saj pas tij...”⁴ (Muslimi, 1017), ku termi nuk ka domethënie të kufizuar juridike, por nënkupton metodë ose traditë të ndjekur. Apo hadithi tjetër: “Patjetër do t’i ndiqni rrugët e atyre që kanë qenë para jush, pëllëmbë për pëllëmbë dhe krah për krah, madje edhe nëse do të hynin në strofkën e hardhucës, do t’i ndiqnit ata.”⁵ (Buhariu, 3456, Muslimi, 2669).

KUPTIMI NË TERMINOLOGJINË FETARE

Kuptimi te dijetarët e hadithit (muhaddithët)

Në terminologjinë e muhaddithëve, Suneti përfshin gjithçka që i atribuohet Pejgamberit a.s., nga thëniet, veprimet, miratimet, si dhe cilësitë e tij morale e fizike, qoftë para shpalljes, qoftë pas saj.⁶ Ky përkufizim është përfshirës dhe nuk kufizohet vetëm tek aspekti normativ, por shërben si bazë për regjistrimin dhe klasifikimin e transmetimeve profetike.

Kuptimi te juristët (fukahatë)

Sipas juristëve mysliman, Suneti është një kategori veprimi fetar që është i ligjësuar nga Sheriati, por nuk është obligativ (farz ose vaxhib).⁷ Kryerja e tij sjell shpërblim nga Allahu, ndërsa lënia nuk sjell ndëshkim.⁸ Sipas hanefive, Suneti përkufizohet si: “Atë (veprim) që Pejgamberi a.s. e ka kryer rregullisht, ndërkohë që ndonjëherë e ka lënë pa ndonjë arsye

Kurani
përmban
parimet
themelore,
ndërsa Suneti i
shpjegon, i
detajon ose i
kufizon ato
sipas urtësisë
së shpalljes.

penguese.”⁹ Ky dallim tregon se megjithëse Suneti ka një status të fortë rekomandues, lënia e tij e rastësishme nuk konsiderohet mëkat, ndryshe nga farzi ose vaxhibi. Ky kuptim i Sunetit ka natyrë vlerësuese, jo burimore, pra nuk e trajton Sunetin si burim ligjësimi, por si një shkallë të caktuar të dispozitave fetare brenda klasifikimit juridik islam.

Kuptimi tek usulistët

Në shkencën e Usul el fikh, Suneti përkufizohet si gjithçka që është transmetuar nga Pejgamberi a.s., përveç Kuranit, e që ka vlerë në nxjerrjen e dispozitave sheriatike.¹⁰

Ky përkufizim është qendror për studimin tonë, pasi e vendos Sunetin në funksionin e tij si burim ligjësimi, me autoritet të plotë detyrues, duke përfshirë thëniet, veprimet



dhe miratimet e tij, me kusht që të kenë lidhje të drejtpërdrejtë me normat juridike. Ky përcaktim siguron koherencë në analizë dhe shmang konfuzionin me kuptimet e tjera terminologjike, duke e pozicionuar Sunetin në vendin që i takon brenda hierarkisë së burimeve të Sheriatit.

RËNDËSIA E BURIMEVE TË USUL EL FIKH NË NXJERRJEN E NORMAVE SHERIATIKE

Shkenca e *Usul el fikh* përcakton rregullat dhe metodologjinë për nxjerrjen e dispozitave juridike nga burimet autentike të Sheriatit. Burimet themelore janë të pranuar unanimisht nga dijetarët: **Kurani**, **Suneti**, **ixhmaja** (konsensusi) dhe **kijasi** (analogjia). Në këtë hierarki, Kurani qëndron në krye si shpallja e drejtpërdrejtë e Allahut, ndërsa Suneti, i përcjellë në formë të thënieve, veprimeve dhe miratimeve të Pejgamberit a.s., pason si burim i dytë me autoritet të plotë detyrues. Rëndësia e këtyre burimeve qëndron në funksionin e tyre të ndërthurur: Kurani përmban parimet themelore, ndërsa Suneti i shpjegon, i detajon ose i kufizon ato sipas urtësisë së shpalljes. Ixhmaja përfaqëson konsensusin e dijetarëve në çështje të caktuara, duke garantuar unitetin e interpretimit juridik, ndërsa kijasi ofron zgjidhje për çështje të reja përmes analogjisë me dispozita të ngjashme të bazuara në tekstet hyjnore.

Vendosja e Sunetit menjëherë pas Kuranit nuk është rezultat i një preference historike, por rrjedhojë e drejtpërdrejtë e urdhërimeve kuranore për bindje ndaj Pejgamberit a.s., si në ajetin: “Ajo që i Dërguari ua jep (nga urdhrat) merreni; dhe nga ajo që ju ndalon, ndalohuni!” (El Hashër, 7).

Ky tekst kuranor e vendos autoritetin profetik në një shkallë detyrueshmërie të barasvlershme me vetë shpalljen e Kuranit në fushën e ligjësisimit. I Dërguari e vërteton këtë kur thotë: “Vërtet, mua më është dhënë Kurani dhe bashkë me të diçka e ngjashme me të.”¹¹ (Tirmidhiu, 2664). Për rrjedhojë, mohimi i autoritetit të Sunetit nënkupton prishjen e rendit metodologjik të Usul el fikh dhe cenimin e vetë strukturës së legjislacionit islam.

I DËRGUARI MUHAMED A.S., SI BURIM I NORMAVE SHERIATIKE

Autoriteti i Pejgamberit Muhamed a.s., në nxjerrjen e dispozitave sheriatike është i rrënjësor në vetë tekstin e

Nga këndvështrimi usulist, veprimet dhe urdhrat e Pejgamberit a.s. ndahen në ato që kanë funksion legjislativ dhe ato që i përkasin natyrës së tij si individ ose udhëheqës politik.

Kuranit dhe në praktikën e pandërprerë të ymetit. Kurani urdhëron qartësisht bindje ndaj Pejgamberit a.s., duke e bërë ndjekjen e tij kusht të besimit: “Kush i bindet të Dërguarit, i është bindur Allahut.” (En Nisa, 80) dhe “Merrni atë që ju jep i Dërguari dhe largohuni nga ajo që ai ju ndalon.” (El Hashër, 7). Këto ajete e vendosin Sunetin në pozitën e një burimi detyrues, dhe pjesë e shpalljes hyjnore në kuptimin e udhëzimit dhe normativitetit.

Në traditën profetike, hadithet autentike dëshmojnë se ai a.s., nuk fliste nga pasioni personal, por në bazë të shpalljes: “Ai nuk flet nga dëshira e tij; nuk është tjetër veçse shpallje që i shpallet.” (En Nexhm, 3–4). Kjo nënkupton se dispozitat e formuluar prej tij, kur janë të lidhura me ligjësimin, kanë të njëjtën detyrueshmëri si tekstet kuranore.

Nga këndvështrimi usulist, veprimet dhe urdhrat e Pejgamberit a.s. ndahen në ato që kanë funksion legjislativ dhe ato që i përkasin natyrës së tij si individ ose udhëheqës politik. Kriteri dallues është që vetëm veprimet dhe thëniet e tij të lidhura me udhëzimin fetar dhe normat e adhurimit e të marrëdhënieve juridike kanë vlerë obliguese. Kjo qasje siguron ruajtjen e kuptimit të pastër të Sunetit

si burim i dytë i Sheriatit, duke shmangur interpretimet e gabuara ose aplikimet jashtë kontekstit të tij original.

Në këtë mënyrë, Pejgamberi a.s. nuk është vetëm transmetues i Kuranit, por edhe burim i drejtpërdrejtë i ligjësisimit përmes Sunetit, duke e bërë atë shtyllë të pazëvendësueshme në strukturën e burimeve juridike islame. Mohimi i këtij roli do të nënkuptonte rrëzimin e një prej themeleve të Usul el fikh dhe zbehjen e unitetit metodologjik të legjislacionit islam.

Detyrimi për ta ndjekur dhe pasuar Pejgamberin Muhamed a.s. fillimisht iu drejtua sahabëve, të cilët ishin dëshmitarë të drejtpërdrejtë të shpalljes dhe praktikës së tij, e më pas ky detyrim u shtri për të gjithë gjeneratat pasuese të ymetit. Ajetet kuranore shpesh zbritnin në formë të përgjithshme dhe pa detaje të hollësishme; këto detaje i sqaronte dhe i demonstronte praktikisht i Dërguari a.s.. Kështu, urdhri për faljen e namazit u përmend në Kuran pa përshkrimin e numrit të rekateve dhe mënyrës së kryerjes, të cilat u sqaruan nga Pejgamberi a.s. me fjalën dhe veprën e tij, siç dëshmohet në hadithin: “Faluni siç më keni parë mua të falem.”¹² (Buhariu, 6008). Urdhri për dhënien e zekatit u shoqërua me sqarimin e sasisë dhe kategorive përmes Sunetit të tij. Po ashtu, agjërimi i Ramazanit u detajua në aspektet e kushteve, gjërave që e prishin dhe rregullave praktike përmes udhëzimit profetik.

Edhe haxhi, me kushtet dhe ritet e tij, u sqarua nga Pejgamberi a.s. përmes praktikës së tij, i cili tha: “Mësoni prej meje mënyrën e kryerjes së riteve tuaja (të haxhit)”¹³ (Muslimi, 1297), duke u bërë kështu shembull referues për ymetin.

Ky funksion i Pejgamberit a.s. si shpjegues i shpalljes është theksuar qartë në fjalën e Allahut: “Dhe Ne të shpallim ty rikujtuesin (Kuranin), që t’u shpjegosh njerëzve atë që u është zbritur.” (En Nahl, 44). Po ashtu, Allahu i urdhëron besimtarët të kthehen tek i Dërguari a.s. për sqarim dhe gjykim në çdo çështje të paqartë: “Dhe Ne nuk kemi dërguar të dërguar vetëm që të i binden (atij) me lejen e Allahut. Por jo! Pasha Zotin tënd, ata nuk do të jenë besimtarë derisa të të marrin ty për gjykatës në atë që kanë mosmarrëveshje mes tyre...” (En Nisa, 64–65).

Gjithashtu, Allahu e ka përmendur bashkë me shpalljen edhe “urtësinë”, që dijetarët e kanë shpjeguar si Sunetin profetik:¹⁴ “Allahu u ka dhënë juve Librin dhe Urtësinë...” (Ali Imran, 164).

Suneti i saktë
nuk mund të
jetë në
kundërshtim
real me Kura-
nin, sepse të
dy janë shpall-
je nga Allahu.
Në rastet ku
Suneti kufizon
ose sqaron
dispozita kura-
nore, kjo
konsiderohet
shpjegim dhe
jo kundërshtim.

Autoriteti i Pejgamberit a.s. si gjykatës dhe burim legjislacioni shihet edhe në hadithin e njohur të Muadh b. Xhebelit, ku vihet në pah Suneti si burim i normave sheriatike dhe ixhtihadi i Muadhrit në rastet kur tekstet mungojnë.

Ky autoritet i pakontestueshëm i Pejgamberit a.s. është një shtyllë e besimit dhe e Sheriatit. Ata që nuk e pranojnë atë si gjykatës dhe burim vendimmarrjeje bien në kundërshtim me urdhrin hyjnor për bindje të plotë ndaj tij, siç thotë Allahu: “Thuaj: Binduni Allahut dhe të Dërguarit! Por nëse ata kthejnë shpinën, Allahu, me të vërtetë, nuk i do mohuesit.” (Ali Imran, 32). Kështu, mosbindja ndaj Pejgamberit a.s. nuk është thjesht mosrespektim i tij, por një akt që bie ndesh me vetë themelet e besimit. Këto argumente tekstuale tregojnë se praktika dhe udhëzimet e Pejgamberit a.s. janë jo vetëm plotësuese të shpalljes, por edhe pjesë e saj tërësore, me autoritet të barabartë në vendimmarrjen juridike islame.

Kushtet e Sunetit për t’u konsideruar burim i normave juridike islame



Në shkencën e Usul el fikh, autoriteti normativ i Sunetit nuk është i pakushtëzuar, por bazohet në disa kritere themelore që garantojnë vlefshmërinë e tij si burim ligjësimi. Këto kushte synojnë të sigurojnë që dispozitat e nxjerra nga Suneti të jenë të mbështetura në transmetim autentik, të kenë përmbajtje me relevancë ligjore dhe të jenë në përputhje me parimet e Sheriatit.

1. Autenticiteti i transmetimit (صحة السند والماتن)

Kushti i parë dhe më themelor është që hadithi të jetë i saktë, me zinxhir transmetimi të pandërprerë, me transmetues të drejtë dhe të besueshëm, dhe me përmbajtje të pastër nga kundërshtitë e brendshme ose të jashtme. Shkenca e hadithit ka zhvilluar kritere të rrepta për këtë qëllim, duke e bërë Islamin unik në ruajtjen e burimeve të tij ligjësores. Parimi bazë në këtë kusht mbështetet në fjalën e Pejgamberit a.s.: “Kush gënjen (duke u referuar) mbi mua me vetëdije, le ta përgatisë vendin e tij në zjarr.”¹⁵ (Buhariu, 107, Muslimi në parathënie).

2. Përcaktimi i burimit profetik

Përmbajtja e Sunetit duhet t'i atribuohet drejtpërdrejt Pejgamberit a.s, qoftë si thënie, veprim apo miratim. Transmetimet që i atribuohen sahabëve ose tabiinëve mund të kenë vlerë në fikh, por nuk përbëjnë Sunet profetik në kuptimin usulist. Këtë parim e orienton qartë edhe Kurani Fisnik, ku Allahu i Madhëruar thotë: “*Merrni atë që ju jep i Dërguari dhe largohuni nga ajo që ai ju ndalon.*” (El Hashër, 7).

3. Përmbajtje me vlerë normative

Suneti duhet të ketë përmbajtje me funksion ligjësues (të përcaktojë, të sqarojë, të plotësojë ose të përjashtojë një dispozitë të Sheriatit). Veprimet e Pejgamberit a.s. që lidhen vetëm me zakone personale, preferenca individuale apo specifika të misionit të tij nuk kanë efekt normativ për të gjithë ymetin. Këtë parim e mbështet edhe hadithi i Muadh b. Xhebelit, i cili, kur u dërgua nga Pejgamberi a.s. në Jemen, u pyet prej tij: “Me çfarë do të gjykos?” Ai u përgjigj: “Sipas Librit të Allahut.” Pejgamberi a.s. e pyeti: “Po nëse nuk gjen aty?” Ai tha: “Sipas Sunetit të të Dërguarit të Allahut.” Ky dialog dëshmon qartë se Suneti ishte burim i drejtpërdrejtë i vendimmarrjes juridike, menjëherë pas Kuranit, dhe se kjo metodë u miratua nga vetë Pejgamberi a.s..

4. Të mos kundërshtojë Kuranin

Suneti i saktë nuk mund të jetë në kundërshtim real me Kuranin, sepse të dy janë shpallje nga Allahu. Në rastet ku Suneti kufizon ose sqaron dispozita kuranore, kjo konsiderohet shpjegim dhe jo kundërshtim. Allahu e pohon këtë parim kur thotë: “Ai nuk flet nga dëshira e tij; nuk është tjetër veçse shpallje që i shpallet.” (En Nexhm, 3–4). Ky ajlet konfirmon se Suneti autentik është pjesë e shpalljes hyjnore dhe, për rrjedhojë, assesi nuk mund të jetë në kundërshtim

me Kuranin. Nëse në shikim të parë duket se ekziston kundërshtimi midis Sunetit dhe Kuranit, kjo është vetëm perceptim njerëzor; pasi analiza e kujdesshme tekstuale dhe metodologjike tregon se midis tyre nuk mund të ketë mospërputhje reale, pasi të dy burojnë nga i njëjti burim hyjnor.

5. Qartësia e kuptimit dhe zbatueshmëria

Për të qenë burim normativ, Suneti duhet të ketë kuptim të qartë dhe të jetë i zbatueshëm në realitetin juridik. Hadithet e paqarta ose me kuptim të dyshimtë kërkojnë interpretim përmes parimeve të Usul el fikh.¹⁶

Përmbushja e këtyre kushteve garanton që Suneti të mbetet burim autentik dhe i pakontestueshëm i normave sheriatike. Në fakt, mosnjohja ose injorimi i këtyre kritereve është arsyeja kryesore pse lëvizja e njohur si kuranistët dhe disa studiues të orientalistikës e kanë refuzuar Sunetin si burim të dytë të Sheriatit. Ata kanë ngritur dyshime mbi autenticitetin e haditheve dhe kanë pretenduar se legjislacioni islam duhet të mbështetet vetëm në Kuran. Megjithatë, verifikimi i rreptë i zinxhirëve të transmetimit, roli i pazëvendësueshëm i Sunetit në detajimin e dispozitave kuranore dhe konsensusi i pandërprerë i ymetit në pranimin e tij, e bëjnë këtë qëndrim të papranueshëm si në planin tekstual, ashtu edhe në atë metodologjik.

- 1 Shih: Abdulganij Abdulhalik, *Huxhijjetu es Sunneh*, (Ed dar el alemije lil-kitab el islami, Riad, bot. 1, 1986), f. 21-22.
- 2 Ismail b. Hammad el Xheverhij, *Es Sihah Taxh el lugah ve sihah el arabije*, (rec. Ahmed Abdulgafur Attar), f. 8312, lënda سنن
- 3 Shih: Dr. Mustafa es Siba'i, *Es Sunnetu ve mekanetuha fi et-teshri' el islamij*, (El mekteb el islamij, dar el verrak, bot. 2), f. 65.
- 4 Muslim b. El Haxhaxh b. Muslim en Nejsaburi, *Sahih Muslim*, (Bejt el efkar ed duvelije, Riad), libri i zekatit, f. 392, nr. 69-1017.
- 5 Muhamed .b Ismail, *Sahih el Buhari*, (El Bushra, 2016), Kitab el enbija, f. 1591, nr. 3456. Dhe: Muslimi, po aty, Kitab el ilm, f. 1071, nr. 2669.
- 6 Shih: Dr. Mustafa es Siba'i, *Es Sunnetu ve mekanetuha fi et-teshri' el islamij*, po aty, f. 65.
- 7 Po aty, f. 66.
- 8 Shih: Abdulganij Abdulhalik, *Huxhijjetu es Sunneh*, po aty, f. 52, sipas El Bejdavi.
- 9 Po aty, f. 54, sipas El Kemal ibën el Humam.
- 10 Po aty, f. 68.
- 11 Muhamed b. Isa et Tirmidhi, *El Xhami' el kebir*, (rec. Dr. Beshar Maruf Avvad, dar el garb el islami, bot.1, 1996), vëll. 4, f. 399, nr. 2664, dhe të tjerë.
- 12 Muhamed b. Ismail, *Sahih el Buhari*, po aty, Kitab el edeb, f. 2681, nr. 6008.
- 13 Muslim b. El Haxhaxh b. Muslim en Nejsaburi, *Sahih Muslim*, po aty, nr. 1297.
- 14 Shih: Dr. Mustafa es Siba'i, *Es Sunnetu ve mekanetuha fi et-teshri' el islami*, po aty, f. 68.
- 15 Muhamed b. Ismail, *Sahih el Buhari*, po aty, Kitab el ilm, kapitulli i ndalimit të gënjeshtres ndaj të Dërguarit a.s., f. 189, nr. 107. Muslimi, po aty, në parathënien e Sahihut të tij, f. 3.
- 16 Shih kushtet e të punuarit me Sunet në Usul el fikh te: Ebu Hamid Muhamed b. Muhamed el Gazali, *El Mustasfa*, (rec. dr. Ahmed Zekij Hammad), f. 200 e tutje.

Pejgamberi a.s., model i përkryer i jetës bashkëshortore dhe familjare (1)

Prof. ass. dr. Ilmije Kuqi

Pejgamberi Muhamed a.s. paraqet shembullin më të përkryer të moralit dhe karakterit njerëzor në historinë e njerëzimit. Kur bashkëshortja e tij, nëna e besimtarëve, Aisheja r.a., u pyet për moralin e tij, ajo dha një përgjigje shumë domethënëse: “Morali i tij ishte Kurani.”¹

Allahu xh.sh. e edukoi dhe e përgatiti atë në mënyrën më të përsosur, duke e bërë një model të gjallë të Kuranit që ecte mes njerëzve. Përsosmëria e tij shfaqej në çdo aspekt: në besim, në moral, në marrëdhënie ndërnjerëzore dhe në udhëheqje. Lidhur me këtë, Allahu xh.sh. në Kuran thotë: “Ju e kishit shembullin më të lartë në të Dërguarin e Allahut, kuptohet, ai që shpreson në

shpërblimin e Allahut në botën tjetër, dhe e përmend shumë shpesh Allahun.” (El Ahzab, 21).

Jeta e Pejgamberit a.s. karakterizohet nga një ekuilibër i mrekullueshëm në të gjitha sferat e jetës. Si udhëheqës shpirtëror, ai ishte shembulli më i lartë i devotshmërisë. Si bashkëshort, kultivonte dashurinë dhe respektin më të thellë. Si baba, shfaqte dhembshurinë dhe kujdesin më të madh. Si udhëheqës, mishëronte drejtësinë dhe mëshirën në harmoni të përkryer.

Një aspekt veçanërisht i rëndësishëm i moralit të tij ishte sjellja brenda familjes. Ky aspekt meriton vëmendje të veçantë, sepse sjellja e njeriut në shtëpi është pasqyra më e

“Më i miri prej jush është më i miri për familjen e tij, dhe unë jam më i miri prej jush për familjen time.”

Muhamedi, a.s.



vërtetë e karakterit të tij. Ndryshe nga shumë njerëz që shfaqin edukatë në publik dhe janë krejtësisht ndryshe në privatësi, Pejgamberi a.s., ruante të njëjtin standard të lartë moral në çdo situatë. Sjellja e tij në shtëpi ishte një model i përkryer për ndërtimin e marrëdhënieve familjare.

Në vijim do të shqyrtojmë më hollësisht aspektet e ndryshme të moralit të Pejgamberit a.s. në familje, duke u fokusuar në mënyrën se si ai sillej me bashkëshortet dhe familjarët e tij. Përmes këtij punimi, do të zbulojmë një model që na ndriçon rrugën drejt ndërtimit të shtëpive të qëndrueshme dhe të lumtura, të bazuara në besim dhe devotshmëri.

RREGULLI PROFETIK NË MARRËDHËNIET FAMILJARE

I Dërguari i Allahut xh.sh., Muhamedi a.s., ishte njeriu më i mirë që ka njohur ndonjëherë njerëzimi. Ai mishëroi përsosmërinë e moralit njerëzor dhe mbetet një model i shkëlqyer për të gjithë njerëzimin përgjatë shekujve. Në veçanti, ai vendosi një shembull të pakrahasueshëm në fushën e marrëdhënieve familjare. Mësimet e tij për trajtimin e familjes, veçanërisht të bashkëshorteve, u bënë gurthemel për vlerësimin e karakterit të një burri të mirë në Islam. Ai ka thënë: “Më i miri prej jush është më i miri për familjen e tij, dhe unë jam më i miri prej jush për familjen time.”²

Ky hadith përçon një mesazh të thellë që pasqyron moralin e lartë të Pejgamberit a.s. dhe rëndësinë themelore të familjes në jetën e një besimtari. Koncepti i “familjes” në këtë kontekst shtrihet përtej kuptimit të ngushtë, duke përfshirë jo vetëm bashkëshorten dhe fëmijët, por edhe të afërmit dhe madje edhe anëtarët e komunitetit të gjerë që ishin pjesë e rrethit të tij social.³

Më deklaratën e tij “Unë jam më i miri prej jush për familjen time”, Pejgamberi a.s. nuk ofroi vetëm një këshillë teorike, por vetë u bë një model i gjallë, një dritë udhëzuese për çdo burrë mysliman që aspirojnë të ndërtojnë një familje të shëndetshme, të qetë dhe të mbështetur në besim e dashuri.

Urdhërimi për t'i trajtuar mirë gratë nuk buroi nga një boshllëk shoqëror, por përkundrazi ishte një korrigjim i statusit të gruas në kohën e xhahiljetit. Këtë transformim thelbësor e përshkruan më së miri Umer ibën el Hattabi r.a. me fjalët e tij plot domethënie: “Pasha Allahun, në kohën e xhahiljetit, ne nuk i konsideronim gratë të rëndësishme derisa Allahu zbriti për to atë që zbriti dhe u ndau atyre atë që u takon.”⁴

*“Pasha Allahun,
në kohën e
xhahiljetit, ne
nuk i konside-
ronim gratë të
rëndësishme
derisa Allahu
zbriti për to atë
që zbriti dhe u
ndau atyre atë
që u takon.”*

Umer ibën el Hattabi r.a.

Islami vendosi një sistem të plotë që kërkon nga burrat të respektojnë gratë në të gjitha rolet e tyre - si nëna që duhen nderuar, si bashkëshorte që duhen dashur dhe respektuar, si motra dhe bija ndaj të cilave duhet treguar dhembshuri dhe mbrojtje. Mbi të gjitha, Islami ndaloi në mënyrë kategorike çdo formë të keqtrajtimit apo padrejtësisë ndaj grave.⁵

SHEMBUJ TË SJELLJES SË PEJGAMBERIT MUHAMED A.S. ME BASHKËSHORTET E TIJ

Sira profetike dhe burimet historike na ofrojnë një pasqyrë të qartë dhe gjithëpërfshirëse të sjelljes shembullore të Pejgamberit Muhamed a.s. me bashkëshortet e tij, si në shtëpi ashtu edhe gjatë udhëtimeve dhe në çdo situatë tjetër. Ai përfaqësonte një bashkëshort ideal, të dashur, të drejtë dhe të kujdesshëm. Më poshtë do të paraqesim disa shembuj nga jeta e të Dërguarit të Allahut, Muhamedit a.s., që ilustrojnë moralin e tij të shkëlqyer si bashkëshort.

Drejtësia dhe kujdesi i Pejgamberit a.s. ndaj bashkëshorteve

Pejgamberi a.s. mishëronte shembullin më të përkryer të drejtësisë dhe sjelljes së mirë ndaj njerëzve, veçanërisht ndaj familjes së tij. Ai tregonte kujdes të veçantë për gratë e tij dhe interesohej për gjendjen e tyre. Rutina e



tij e përditshme përfshinte vizita të rregullta pas namazit të sabahut dhe ikindisë. Transmetohet nga Ibën Abbasi r.a., të ketë thënë: “Kur i Dërguari i Allahut a.s. falte namazin e sabahut, qëndronte ulur në vendin ku falej dhe njerëzit uleshin rreth tij derisa lindte dielli. Pastaj hynte te gratë e tij, një nga një, i përshëndeste dhe lutej për to. Kur ishte dita e njërës prej tyre, qëndronte tek ajo (atë natë).”⁶

Kështu që çdo ditë, në fillim të ditës, ai kalonte pranë secilës, e përshëndeste dhe lutej për të. Ndërsa në fund të ditës, ai bisedonte dhe i bënte shoqëri. Aisheja r.a. ka thënë: “Kur i Dërguari i Allahut a.s. kthehej nga namazi i ikindisë, ai hynte te gratë e tij dhe i afrohej ndonjëres prej tyre.”⁷

Këto vizita, edhe pse të shkurtra, ishin plot dashuri dhe konsideratë, duke u dhënë atyre ndjenjën e vlerësimit dhe respektit. Bedrudin el Ajni, në lidhje me hadithin, ka thënë: “Ajo që ndodhte në fillim të ditës ishte vetëm përshëndetje dhe lutje, ndërsa ajo që ndodhte në fund të saj ishte ndejë, afërsi, shoqërim dhe bisedim. Ose mund të themi, ai nganjëherë e bënte këtë në fillim të ditës, e nganjëherë në fund të saj, dhe nuk ishte i qëndrueshëm vetëm në njërin prej këtyre kohëve.”⁸ Ai i trajtonte gratë e tij në mënyrë të barabartë, duke mos favorizuar asnjërin mbi tjetrën në trajtimin e tij. Këtë e dëshmon edhe Aisheja r.a., duke thënë: “I Dërguari i Zotit a.s. nuk favorizonte asnjërin prej nesh në ndarjen e kohës së qëndrimit te ne. Rrallë kalonte ndonjë ditë pa na vizituar të gjithave, i afrohej secilës grua pa e prekur (pa marrëdhënie intime), derisa arrinte tek ajo që ishte në ditën e saj dhe flinte tek ajo.”⁹

Ai e bënte këtë për t’u dhënë atyre ndjesinë e afërsisë dhe për t’i qetësuar zemrat e tyre, në mënyrë që të ndahej prej tyre i dashur dhe i mirëpritur, për të kaluar më pas natën tek ajo që i përkiste radha në atë ditë, duke lënë secilën me një zemër të kënaqur dhe të qetë.¹⁰

Pavarësisht përgjegjësiave të shumta si udhëheqës shpirtëror dhe shtetëror, Pejgamberi a.s. gjente kohë për t’u kujdesur për familjen e tij. Një shembull është rasti i nënës së besimtarëve, Aishes r.a., e cila i tregoi të Dërguarit a.s. një tregim të gjatë dhe interesant, të njohur si “rrëfimi i Ummu

Në jetën e përditshme, i Dërguari i Allahut a.s. demonstronte një nivel të lartë modestie dhe respekti. Ai ndante momentet më intime me familjen e tij, duke pirë nga e njëjta enë dhe duke ndarë ushqimin me bashkëshortet e tij.

Zera’ut”. Në të përmendeshin njëmbëdhjetë gra të cilat ishin betuar të mos fshehin asgjë për burrat e tyre dhe secila përshkroi marrëdhënien me burrin e saj. Ajo që e përshkroi burrin e saj më së miri dhe i numëroi më shumë mirësitë e tij ishte gruaja e Ebu Zarut. Pas këtij rrëfimi, Pejgamberi a.s. iu drejtua Aishes dhe i tha: “Unë jam për ty si Ebu Zera’ për Ummu Zera-n.”¹¹ Ky hadith tregon dashurinë, butësinë dhe vëmendjen që i Dërguari i Allahut a.s. tregonte ndaj bashkëshortes së tij.

Mirësjellja e Pejgamberit a.s. ndaj bashkëshorteve

I Dërguari i Allahut a.s. e dallonte nëse gratë e tij janë të kënaqura apo të pakënaqura me të. Në një nga bisedat e bukura mes tij dhe Aishes r.a., ai i thotë asaj: “Unë e di kur ti je e kënaqur me mua dhe kur je e zemëruar me mua.” Ajo pyeti: “Si e di këtë?” Ai u përgjigj: “Kur je e kënaqur me mua, thua: ‘Jo, për Zotin e Muhamedit.’ Dhe kur je e zemëruar me mua, thua: ‘Jo, për Zotin e Ibrahimit.’ Ajo e pranoi: ‘Po, për Zotin, o i Dërguar i Zotit, unë vetëm emrin tënd e braktis.’”¹²

Në jetën e përditshme, i Dërguari i Allahut a.s. demonstronte një nivel të lartë modestie



dhe respekti. Ai ndante momentet më intime me familjen e tij, duke pirë nga e njëjta enë dhe duke ndarë ushqimin me bashkëshortet e tij. Aisheja r.a. transmeton: “Ndodhte të pija diç gjatë ciklit, pastaj (të njëjtën) ia jepja Pejgamberit a.s. dhe ai vendoste gojën e tij në vendin ku unë kisha vendosur gojën time dhe pinte. Gjithashtu, ka pas raste kur haja ndonjë pjesë të mishit të mbetur në kockë duke qenë me cikël, pastaj të njëjtin ia jepja Pejgamberit a.s. dhe ai vendoste gojën e tij në vendin ku kisha vendosur unë gojën time.”¹³

Ky akt tregon përsosmërinë e përlusës së të Dërguarit a.s.,¹⁴ si dhe respektin dhe dashurinë e tij për gruan e tij.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm i virtytit të tij ishte butësia dhe mirësjellja e vazhdueshme. I Dërguari i Zotit a.s. gratë e tij i nderonte dhe kurrë nuk i poshtëronte. Ai i udhëzonte dhe i këshillonte, por kurrë nuk i ofendonte apo lëndonte me fjalë apo vepra. Gratë e tij jetuan me të në një jetë dinjitoze. Asnjëra prej tyre nuk e përjetoi ndonjëherë, as edhe një herë, që ai ta kishte fyer, qoftë edhe me një fjalë. Aisheja r.a. ka thënë: “I Dërguari i Allahut a.s. kurrë nuk e ka goditur ndonjë shërbëtor, as ndonjë nga gratë e tij, as nuk ka goditur diçka me dorën e tij, përveç kur luftonte në rrugën e Allahut.”¹⁵

Ky hadith thekson bukurinë, mëshirën dhe moralin e lartë të të Dërguarit të Allahut a.s. në mënyrën si ai sillej me të tjerët, sidomos me anëtarët e familjes së tij dhe ata nën kujdesin e tij.

Në çështjet e përditshme, si për shembull në lidhje me ushqimin, Pejgamberit a.s. tregonte mirësjellje. Nëse i pëlqente, e hante, përndryshe e linte, pa e kritikuar kurrë ndonjë ushqim. Këtë e dëshmon Ebu Hurejra r.a., i cili ka thënë: “Pejgamberi a.s. kurrë nuk e ka kritikuar ndonjë ushqim. Nëse i pëlqente, e hante, përndryshe e linte.”¹⁶

Ky hadith tregon për moralin e lartë të Pejgamberit a.s., thjeshtësinë dhe mirënjohjen e tij në të gjitha situatat.

Dashuria e tij shprehej edhe në mënyrën se si u drejtohej bashkëshorteve të tij, duke përdorur emra përkëdhelës. Ai tregohej i dashur me gratë e tij dhe zgjidhte emrat më të bukur për t'i thirrur ato. Për shembull, bashkëshorten e tij Aishen r.a. e thërriste me emra të dashur, si: “O Aish!”¹⁷, që është formë e shkurtuar e emrit Aishe. Ai gjithashtu, e thërriste me emrin: “Oj Humejra!”¹⁸, që është një përkëdhelje e butë e përdorur për të përshkruar lëkurën me një nuancë të lehtë të kuqerremtë. Në lidhje me këtë, Kadi Ijad ka thënë:

“I Dërguari i Allahut a.s. kurrë nuk e ka goditur ndonjë shërbëtor, as ndonjë nga gratë e tij, as nuk ka goditur diçka me dorën e tij, përveç kur luftonte në rrugën e Allahut.”

Aisheja, r.a.

“Ky është një zvogëlim (i emrit) që shpreh dhembshuri, mëshirë dhe dashuri.”¹⁹ Herë të tjera e nderonte atë duke e thirrur me emrin e babait të saj, si p.sh. duke i thënë asaj: “Oj bija e të sinqertëve!”²⁰

Prandaj, kjo mënyrë e të folurit dhe përkëdheljes nga ana e Pejgamberit a.s. është shprehje e dashurisë së thellë, butësisë dhe kujdesit ndaj bashkëshorteve të tij, dhe është shembull i bukur për marrëdhëniet bashkëshortore të ndërtuara mbi respekt, afërsi dhe dashuri të ndërsjellë.

Këta shembuj të sjelljes së tij të përkryer në familje na mësojnë se sa i vëmendshëm ishte Pejgamberi a.s. ndaj emocioneve dhe ndjeshmërisë së bashkëshorteve të tij. Edhe pse ai ishte i preokupuar me përgjegjësitë dhe shqetësimet e shtetit, luftës, thirrjes në fe, udhëheqjen e ymetit, atë nuk e shpërqendroi nga marrja e ndjenjave të gruas së tij në konsideratë. Pavarësisht të gjitha këtyre, ai nuk harroi kurrë të jetë bashkëshort i dhembshur, i ndjeshëm dhe i kujdesshëm ndaj ndjenjave të gruas së tij.

Këta janë shembuj madhështor të ekuilibrit mes jetës publike dhe jetës familjare, një model i përjetshëm për çdo burrë e çdo bashkëshort që dëshiron të ndërtojë një familje të shëndetshme dhe të lumtur, të bazuar në dashuri, respekt dhe mirëkuptim të ndërsjellë.

1 Ahmedî, nr: 25302, 42/183, Shejh Shuajbi thotë: “*Senedi i tij është sahih sipas kritereve të dy shejhëve*”.

2 Ebu Davudi, nr: 1977, 1/636, Et Tirmidhi, nr: 3895, 6/192, dhe thotë: “*Ky hadith është i mirë sahih*”.

3 Mirkatu el Mefatih, 5/2125.

4 El Buhari, nr: 4913, 6/157, Muslimi, nr: 1479, 2/1108.

5 Ahlakijatu't-Teamuli'l-Useri, fq.88-89.

6 El Muxhem el Evsat, nr: 8764, 8/324.

7 El Buhari nr: 5216, 7/34.

8 Umdetu el Karij, 20/244.

9 Ebu Davudi, 2135, 2/242, El Mustedrek, nr: 2760, 2/203. Hakimi ka thënë: “*Senedi i këtij hadithi është sahih*”. Këtë e miraton edhe Dhehebiu.

10 El Mufhim i Kurtubiut, 13/9.

11 El Buhari nr: 5189, 7/28, Muslimi, nr: 2448, 4/1896.

12 El Buhari, nr: 5228, 7/36, Muslimi, nr: 2439, 4/1890.

13 Muslimi, nr: 1/245 ,003.

14 Mirkatu el Mefatih, 2/494.

15 Ahmedî, nr: 25923, 43/92, Shejh Shuajbi thotë: “*Senedi i tij është sahih sipas kritereve të dy shejhëve*”.

16 El Buhari, nr: 3563, 4/190.

17 El Buhari, nr: 3768, 5/29.

18 Sunen el Kubra i Nesaiut, nr: 8902, 8/181. Ibën Haxheri, në Fet'hu el Bari, 2/444, thotë: “*Senedi i tij është sahih*”.

19 Mesharik el Envar ala Sihahi el Athar, 1/358.

20 Musned el Humejdi, nr: 277, 1/298, Et Tirmidhi, nr: 3175, 5/180.

Mëshira si thelb i edukimit profetik

Rashit Zylfiu

Allahu i Madhëruar në Kuranin fisnik thotë: “Ne nuk të kemi dërguar ty (o Muhamed), përveçse si mëshirë për botët.” (El Enbija, 107).

ÇFARË DO TË THOTË TË EDUKOJ ME MËSHIRË?

Ndër ndjenjat më fisnike që Allahu ka vendosur në zemrat e prindërve është ndjenja e mëshirës ndaj fëmijëve, butësia ndaj tyre dhe dashuria për ta. Kjo është një ndjenjë fisnike që jep rezultatet më të mira dhe ndikimet më të mëdha në edukimin, përgatitjen dhe formimin e fëmijëve. Prandaj, Sheriati i ndritur ka thelluar ndjenjën e mëshirës në zemrat e njerëzve dhe ka nxitur të rriturit; si prindërit, mësuesit dhe përgjegjësit, që të zbukurohen me këtë cilësi dhe të sillen sipas saj. Kur mëshira vendoset në zemrat e prindërve dhe thellohet në shpirtin e tyre, ata do të kryejnë obligimet e tyre dhe do të përmbushin të drejtat që Zoti ua ka caktuar ndaj kujdestarisë dhe përgjegjësisë së tyre ndaj fëmijëve.

MËSHIRA SI METODË E FUQISHME EDUKATIVE – JO DOBËSI, POR FUQI SHPIRTËRORE

Nga të gjitha vlerat që përfshin sistemi i vlerave etike islame, vlera më e lartë dhe më e rëndësishme që qëndron në majë të këtij sistemi është vlera e mëshirës. Mirëpo, këtë vlerë të madhe shpeshherë e humbasim në marrëdhëniet tona të përditshme, sepse ashpërsia ka zënë vendin e mëshirës në

shumë nga marrëdhëniet dhe sjelljet tona ditore.

Shembujt për këtë janë të shumtë, ndër ta: babai që është i ashpër me fëmijët e tij. Shumica e dijetarëve të edukimit pajtohen se nëse fëmija trajtohet me ashpërsi nga prindërit apo edukatorët, nëse ndëshkohet me rrahje të forta dhe qortime të rënda, nëse përbuzet dhe përqeshet vazhdimisht, kjo do të reflektohet në sjelljen dhe karakterin e tij, duke i shkaktuar ndjenja frike, tërheqjeje dhe mbylljeje në vetvete.

Dhuna ndaj fëmijëve në shtëpi, shkollë apo rrugë është një nga fenomenet më të përhapura sociale në kohët e fundit, e cila ka sjellë pasoja të shumta negative për fëmijët. Kjo kërkon që çdo njeri që ka kontakt dhe përgjegjësi ndaj fëmijëve të largohet nga dhuna. Islami i urdhëron të gjithë ata që kanë për detyrë edukimin dhe udhëzimin, e sidomos prindërit, që të sillen me moral të lartë, me butësi të pjekur dhe me sjellje të mëshirshme, në mënyrë që fëmijët të rriten me drejtësi, me guxim dhe me personalitet të pavarur. Kështu ata do të ndihen të respektuar dhe me dinjitet.

Prandaj, fëmijët duhet të trajtohen me metoda edukative që bazohen në butësi, dhembshuri dhe mëshirë. Islami me mësimit e tij të shëndosha dhe të përhershme, dhe Suneti profetik, janë të mbushura me shembuj të këtyre metodave.

MODELI PROFETIK I EDUKIMIT

Shembujt e mëshirës ndaj fëmijëve në sunetin profetik janë të shumtë. Profeti a.s.

Profeti a.s. ishte njeriu më mëshirues ndaj fëmijëve. Nga ai janë transmetuar shumë hadithe për mëshirën ndaj fëmijëve, qofshin meshkuj apo femra. Shfaqjet e mëshirës ndaj fëmijëve në sunet përfshijnë shumë forma.

ishte njeriu më mëshirues ndaj fëmijëve. Nga ai janë transmetuar shumë hadithe për mëshirën ndaj fëmijëve, qofshin meshkuj apo femra. Shfaqjet e mëshirës ndaj fëmijëve në sunet përfshijnë shumë forma.

Nga aspektet e mëshirës ndaj fëmijëve janë: puthja e tyre, butësia me ta, lutja për ta (dhe jo kundër tyre), drejtësia mes tyre, shpenzimi për ta, lënia e tyre të pasur (pas vdekjes), përsëritja me ta dhe dashamirësia ndaj tyre, butësia në sjellje, si dhe mëshira ndaj fëmijëve jetimë.



Puthja e fëmijëve: Puthja ka një rol të fuqishëm në zgjimin e ndjenjave dhe emocioneve të fëmijës, gjithashtu ndihmon në qetësimin e shpërthimeve emocionale. Ajo krijon një lidhje të fortë dashurie mes të rriturit dhe fëmijës, është dëshmi e mëshirës që buron nga zemra dhe ndjenjat, dhe shenjë e përlulësisë së të madhit ndaj të voglit. Ajo është një dritë që ndriçon zemrën e fëmijës, ia gëzon shpirtin dhe e bën më të hapur ndaj të tjerëve. Dhe mbi të gjitha, puthja është një sunet i vërtetuar nga Profeti a.s..

DISA NGA APLIKIMET EDUKATIVE

Këtu janë disa nga aplikimet edukative më të rëndësishme që dalin nga këto shfaqje të mëshirës:

Edukatorët duhet të jenë të mëshirshëm ndaj fëmijëve, sepse mëshira është një prej cilësive të edukatorit të suksesshëm, dhe te prindërit është edhe më e theksuar. Mëshira ndaj fëmijëve është nga themelet kryesore të rritjes së tyre dhe prej bazave të zhvillimit të tyre të shëndoshë psikologjik dhe shoqëror. Nëse fëmijët rriten pa dashuri, ata mund të bëhen individë të mbyllur, që nuk bashkëpunojnë dhe nuk integrohen në shoqëri.

Një edukatori që i mungon butësia, ai që është gjithmonë i vrenjtur, që e kursen buzëqeshjen, që nuk ia përkëdhel kokën fëmijës, që njeh vetëm ndëshkimin e jo shpërblimin, nuk është i përshtatshëm për edukim. Transmetohet nga Abdullah Amër bin Asi r.a., se i Dërguari i Allahut a.s., ka thënë: *“Nuk është prej nesh ai që nuk e mëshiron të voglin tonë dhe nuk e njeh të drejtën e të madhit tonë.”*¹

Një njeri i tillë është në kundërshtim me sjelljen e Pejgamberit a.s., i cili bënte shaka me fëmijët dhe sillej me butësi ndaj tyre.

Edukatorët duhet të sillen me fëmijët me butësi dhe respekt, sepse kjo sjellje i bën ata të shëndetshëm në personalitet, i mëson të mbështeten në vetvete dhe ua shton besimin në vete, i edukon me dashurinë ndaj të tjerëve, me ndjenjën e bashkimit dhe vëllazërisë, si dhe i mëson të sillen me dashamirësi dhe mëshirë ndaj të tjerëve, ashtu siç janë mësuar të trajtohen.

Transmetohet nga Aishja r.a., se disa beduinë erdhën tek i Dërguari i Allahut a.s. dhe i thanë: *“Ju i puthni fëmijët tuaj?”* Ai tha: *“Po.”* Ata thanë: *“Për Zotin, ne nuk i puthim!”*

Profeti u tha: *“Po ç’të bëj unë nëse Allahu jua ka hequr mëshirën nga zemrat?”*²

Gjithashtu transmeton Ebu Hurejra, r.a., se Akra ibën Habis e pa Profetin a.s., duke e puthur Hasanin (nipin e tij), dhe tha: *“Unë kam dhjetë fëmijë dhe nuk kam puthur asnjërin prej tyre.”* Profeti a.s., i tha: *“Kush nuk mëshiron, nuk mëshirohet.”*³

PËRDORIMI I LOJËS DHE SHAKASË NË EDUKIMIN DHE MËSIMDHËNIEN NDAJ FËMIJËVE

Profeti a.s. bënte shaka me fëmijët. Transmetohet nga Enesi ibën Maliku që ka thënë: *“Pejgamberi a.s. ishte njeriu me sjelljet më të mira. Kisha një vëlla të vogël që quhej Ebu Umejr. Kur Profeti a.s. vinte dhe e shihte, i thoshte: “O Ebu Umejr, çfarë bëri zogthi-nugejri?”*⁴

Me këtë shprehje lozonjare, Profeti a.s. i qasej fëmijëve dhe ushqente në shpirtin e tyre ndjenja të sinqerta dhe të mira, larg ftohtësisë, ashpërsisë dhe mohimit të të drejtave të fëmijës.

Një ndër të drejtat e fëmijës ndaj prindërve është që të trajtohet mirë, të edukohet me dashuri dhe mëshirë, të rrethohet me butësi dhe ndjenja të ngrohta, dhe t’i dhurohet gëzim në zemër, sepse kjo ndikon fuqishëm në formimin e personalitetit dhe zgjerimin e mendjes së tij, me kusht që të mos shndërrohet në përkëdhelje të tepërt që mund të dëmtojë seriozitetin e tij në jetë.

Duhet të ndërtojmë një klimë edukative që nuk i mëson fëmijët vetëm të “dinë”, por edhe të “ndjejnë”, të reflektojnë dhe të ndahen me të tjerët.

Profeti a.s. i gëzonte dhe i lumturonte fëmijët me mënyra të ndryshme: i priste mirë, i puthte, bënte shaka me ta, ua përkëdhelte kokat, i mbante në prehrin e tij të bekuar, u jepte ushqim dhe hante bashkë me ta. Të gjitha këto i bënte, sepse gëzimi ka ndikim të madh në shpirtin e fëmijës dhe është një mënyrë e mençur për ta bërë atë të lumtur.

Shakatë me fëmijët futin gëzim në zemrat e tyre, i ndihmojnë të zhvillojnë besim në vete, të shprehin vetveten dhe të shfaqin aftësitë e tyre. Edukatori i suksesshëm është ai që e përdor shakanë në shërbim të qëllimeve edu-

kative dhe e shfrytëzon këtë moment kur zemra e fëmijës është e hapur për të pranuar këshilla dhe udhëzime. Kjo është një nga rrugët më të sigurta drejt zemrave të fëmijëve, sepse ata janë krijuar me natyrë lozonjare dhe të dashur për lojë.

Sa më i dashur dhe shakaxhi të jetë edukatori, aq më shumë do ta duan fëmijët, do t'i afrohen dhe do t'i dëgjojnë këshillat. Madje, marrëdhënia mes mësuesit dhe nxënësit mbetet e qëndrueshme emocionalisht dhe mendërisht për shumë vite, për shkak të urës së dashurisë dhe afërsisë që krijohet përmes shakave dhe sjelljes së afërt.

Megjithatë, kjo lojë dhe afërsi nuk duhet të shndërrohet në përkëdhelje të tepruar, sepse ajo çon në çrregullime të personalitetit dhe sjellje jo të shëndetshme. Pasojat e përkëdheljes së tepërt janë: turpi i tepruar, mungesa e vetëbesimit dhe prapambetja në krahasim me moshatarët.

SI TË NDËRTOJMË SOT NJË EDUKIM MBI KËTË MODEL?

Në një kohë kur sfidat arsimore dhe shoqërore po e sfidojnë thellë formimin e brezave të rinj, rikthimi te modeli profetik i edukimit është një domosdoshmëri, jo thjesht një opsion. Ky model, që buron nga mëshira dhe mençuria e Profetit Muhamed a.s., na mëson se edukimi nuk është vetëm transmetim njohurish, por kultivim zemre dhe ndërtim karakteri.

Rikthimi te rrënjët e edukimit profetik duhet të fillojë në tri hapësira kyçe: në familje, ku fëmija e përjeton dashurinë e pakushtëzuar dhe disiplinën me urtësi; në shkollë, ku duhet të ndihet i vlerësuar dhe i udhëzuar drejt së mirës; dhe në xhami, ku përjetohet lidhja me Zotin dhe vlerat e qëndrueshme. Këto tre institucione kanë nevojë për përputhje në mesazhin dhe metodën e edukimit.

Edukatori, prindi dhe mësuesi janë bartësit e këtij modeli. Secili prej tyre është një hallkë e rëndësishme në zinxhirin e formimit njerëzor. Nëse e mishërojnë mëshirën në komunikim dhe dijen në veprim, bëhen shembuj të gjallë që frymëzojnë dhe udhëheqin me zemër.

Për të pasur sukses në këtë drejtim, duhet të ndërtojmë një klimë edukative që nuk i mëson fëmijët vetëm të “dinë”, por edhe të “ndjejnë”, të reflektojnë dhe të ndahen me të tjerët. Edukimi nuk është vetëm për mendjen, por edhe për shpirtin.

ÇFARË MUND TË BËJMË KONKRETISHT?

Të lexojmë e ndajmë me të tjerët libra që flasin për jetën dhe metodologjinë e Profetit a.s..

Të nxisim bashkëpunimin midis prindit, edukatorit dhe mësuesit për edukimin e fëmijës.

Të flasim me butësi dhe të veprojmë me drejtësi.

Të organizojmë aktivitete që përfshijnë ndjenjën, mendimin dhe besimin – jo vetëm teorinë.

Ky model nuk është ideal i paarrtshëm. Është thirrje për kthim te thelbi dhe një shpresë e madhe për të ardhmen.

Të rikthejmë frymën profetike në edukim

Edukimi i vërtetë nuk ndërtohet vetëm mbi fjalë e rregulla, por mbi dije dhe mëshirë. Këto dy shtylla janë të pandashme për t'i dhënë kuptim të plotë procesit të formimit të njeriut. Pa to, nuk ka edukim që prek zemrën dhe nuk ka dituri që ndriçon shpirtin.

Profeti Muhamed a.s. ishte më shumë sesa një mësues dijesh – ai ishte edukator i zemrave. Ai i mësoi njerëzit me butësi, me mëshirë dhe me shembullin e tij jetësor, duke formuar karaktere, jo vetëm duke dhënë informacione. Ai ishte përkufizimi më i lartë i edukimit me shpirt.

Sot, më shumë se kurrë, kemi nevojë të rikthejmë këtë frymë në shkolla, familje dhe xhami. Edukimi që ngjizet në dritën e dijes dhe mëshirës profetike është ai që mbetet i qëndrueshëm, i thellë dhe frytdhënës. Ky është mesazhi i kohës sonë: të mos harrojmë modelin profetik dhe ta bëjmë atë busull për gjeneratat që po rriten.

1 Shënojnë Ebu Davudi, Tirmidhiu, Ahmedii.

2 Shënon Buhariu.

3 Shënojnë Buhariu, Muslimi.

4 Shënojnë Buhariu, Ibën Maxhe, Tirmidhiu.

Literatura e konsultuar:

- *Tuhfetu'l Meudud bi Ahkami'l Meulud - Ibën Kajim el Xheuzijeh*
- *Ar Resulu'l-Muallim salAllahu alejhi ue sel-lem ue esalibuhu fi't-ta'lim - Abdulfettah ebu Guddah.*
- *Ar Rahmatu'n Nebeu'ijje: Delalatuha ue Mekasiduhu fi Terbijeti'n Nesh - Dr. Abdusamed er Rida-artikull.*
- *Minhatu Elhulan fi Mevduat suretu lukman - Prof. dr. Muhamed Abdulaziz el Avaxhiji.*
- *Seria e librave për edukimin e suksesshëm të familjes - Prof. dr. Abdul Kerim Bekkar.*



Ngjarja e elefantit – një qasje klasike dhe moderne

Prof. ass. dr. Valmire Batatina – Krasniqi

Kaptina El Fil, është shpallur në Mekë dhe, sipas renditjes kronologjike, ajo zë vendin e 19-të, pas kaptinës Kafirun.

Në Mushaf, gjendet e renditur si kaptina e 105-të. Kjo kaptinë risjellë në vëmendje një ngjarje që kishte ndodhur rreth 40 vjet para shpalljes së saj.

Tregimet për popujt e mëhershëm në Kuran përbëjnë një komponent thelbësor të diskursit hyjnor, me funksion edukativ, etik dhe historik. Këto tregime nuk paraqiten thjesht si ngjarje të së kaluarës, por si shembuj paradigmatike, që ofrojnë udhëzime morale dhe fetare për individin dhe shoqërinë. Nëpërmjet historive të popujve të mëhershëm, Kurani i ofron lexuesit mundësinë të reflektojë mbi sjelljet e veta dhe të mësojë nga gabimet historike të njerëzimit. Kësisoj, rrëfimet kuranore nuk janë vetëm pasqyrime të një realiteti të shkuar, por mjete të fuqishme të ndërtimit të vetëdijes shpirtërore, fetare dhe morale. Në këtë kontekst, edhe ngjarja e elefantit, e përmendur shkurtimisht në Kuranin famëlartë, zë një vend të veçantë. Duke qenë se ka ndodhur pak kohë para shpalljes së Kuranit, ajo ka një rëndësi të posaçme historike. Kaptina El Fil, si kaptina e 105-të në Kuran, e përmbledh

këtë ngjarje në mënyrë të shkurtër, por jashtëzakonisht të fuqishme dhe kuptimplotë. Emri më i njohur i saj i shënuar edhe në Mushaf është “Suretu’l-Fili” - kaptina e elefantit. Në ajetin e parë të kësaj kaptine thuhet: “A nuk e ke parë, se ç’bëri Zoti yt me poseduesit e elefantit?”, që i referohet ushtrisë së Ebrehesë, i cili me ushtrinë e vet me elefantë mësynë Qabënë për ta rrënuar.

KOHA E ZBRITJES DHE LIDHMËRIA E KAPTINËS ME NGJARJEN E FILIT

Kaptina El Fil, është shpallur në Mekë dhe, sipas renditjes kronologjike, ajo zë vendin e 19-të, pas kaptinës Kafirun.¹ Në Mushaf, gjendet e renditur si kaptina e 105-të. Kjo kaptinë risjellë në vëmendje një ngjarje që kishte ndodhur rreth 40 vjet para shpalljes së saj. Mesazhi i saj thelbësor është se i Dërguari i Allahut dhe numri i vogël i besimtarëve që e



ndoqën atë, nuk janë të braktisur e as të pambrojtur. Përkundrazi, nëpërmjet kësaj kaptine, Kurani u drejtohet kurejshëve (të cilët përpiqeshin t'i shtypnin ata) dhe të gjithë atyre që do të ndjekin rrugën e tyre deri në Ditën e Gjykimit, me paralajmërime të fuqishme hyjnore. Kjo kaptinë nënvizon qartë se ndihma e Allahut është e garantuar për besimtarët deri në ditën e fundit, ndërsa për mohuesit dhe armiqët e së vërtetës, ajo sjell lajmin e ndëshkimit dhe shkatërrimit, si në këtë botë, ashtu edhe në botën tjetër.

Zbritja e kaptinës El Fil lidhet me rrëfimin e “ashabu’l’fil” (poseduesit e elefantit), dhe në të trajtohet mënyra se si Zoti i Madhëruar shkatërroi ushtrinë e Ebrehesë në tentativën e tyre për të shkatërruar Qabenë. Edhe pse në burimet historike ekzistojnë transmetime të ndryshme rreth kësaj ngjarjeje, në thelb ato përputhen në një pikë të përbashkët: ngjarja buron nga faktorë të ndërlikuar politikë, ekonomikë dhe fetarë. Sa u përket arsyeve politike dhe ekonomike, gjatë shekujve V-VI pas erës sonë, që përkojnë me kohën e ngjarjes së Filit, qëllimi kryesor i bashkëpunimit mes Perandorisë Bizantine dhe mbretërisë Abisinite ishte marrja nën kontroll e rrugëve tregtare tokësore dhe detare që përshkonin Arabinë. Nga ana tjetër, arsyeja fetare kishte të bënte me përpjekjen për t'i shkëputur arabët nga lidhja e tyre shpirtërore dhe kulturore me Qabenë dhe për t'i orientuar drejt një kishe të madhe të ndërtuar në San'a, e cila synohej të bëhej qendra e re fetare për haxhilerët arabë. Megjithëse në shikim të parë kjo duket si një përpjekje me natyrë fetare, analizat historike tregojnë se qëllimi përfundimtar ishte ekonomik: zhvendosja e qendrës së pelegrinazhit do të rriste ndjeshëm rolin tregtar të Jemenit në kurriz të Mekës.² Megjithëse ekzistojnë disa mendime të ndryshme lidhur me kohën e ndodhjes së ngjarjes së elefantit (Fil), ku shumica dërmuese e transmetimeve historike pajtohen se kjo ngjarje ka ndodhur në shekullin e gjashtë pas erës sonë. Viti kur ndodhi kjo ngjarje njihet në literaturën islame si “Viti i Elefantit” (Amu’l-Fil). Pikërisht në të njëjtin vit ka lindur edhe i Dërguari i Allahut, Muhamedi a.s.. Sipas konsensusit të dijetarëve islamë, ngjarja e Filit ka ndodhur gjatë muajit muharrem, ndërsa lindja e Pejgamberit a.s. është regjistruar në muajin rebiul-evvel, rreth pesëdhjetë ditë pas ngjarjes.³ Studiuesi i njohur egjiptian, Muhamed Husejn Hejkel, pas shqyrtimit të mendimeve të ndryshme, përmend se Muhamedi a.s. ka lindur në vitin 570 të erës së re, që përkon me Vitin e Elefantit.⁴

Kaptina El Fil shërben si një ilustrim i drejtpërdrejtë i fuqisë absolute të Allahut për të shkatërruar çdo arrogancë dhe mjet njerëzor të vetëmbështetjes.

LIDHMËRIA E KAPTINËS EL FIL ME KAPTINËN PARAPRAKE

Kaptina El Fil paraqet një lidhje të ngushtë konceptuale me kaptinën pararendëse, El Humeze. Në këtë të fundit, Allahu i Madhëruar përshkruan gjendjen shpirtërore dhe sjelljen arrogante të individëve që janë të zhytur në grumbullimin e pasurisë dhe krenohen me të, duke përbuzur e tallur të varfrit dhe të pambrojturit. Ata besojnë se pasuria e tyre do t'u sigurojë përjetësi dhe mbrojtje absolute nga çdo e keqe. Por Zoti i gjithësisë ua bën të qartë se fundi i tyre do të jetë ndëshkimi i rëndë në zjarrin e Xhehenemit. Në këtë kuadër tematik, kaptina El Fil shërben si një ilustrim i drejtpërdrejtë i fuqisë absolute të Allahut për të shkatërruar çdo arrogancë dhe mjet njerëzor të vetëmbështetjes. Në këtë kaptinë rrëfhet rasti i ushtrisë së Ebrehesë, një forcë e madhe ushtarake që përfshinte edhe elefantë – simbol i fuqisë dhe epërsisë ushtarake – e cila u përpoq të shkatërronte Qabenë. Allahu, me urtësinë dhe fuqinë e Tij, e asgjësoi këtë ushtri përmes një ndërhyrjeje hyjnore: tufa zogjesh që hodhën mbi ta gurë nga balta e pjekur, duke i kthyer në një masë të shpërbërë dhe të padenjë, si gjethe të përtypura. Përfundimi i Ebrehesë dhe ushtrisë së tij është një shembull domethënës i faktit se as pasuria, as fuqia materiale, dhe as aleatët fizikë nuk mund të jenë mburojë ndaj ndëshkimit hyjnor. Ky rrëfim historik përçon një mësim të qartë: çdokush që me arrogancë i cenon të tjerët dhe mundohet të sfidojë drejtësinë e Zotit, do të përjetojë një fund të dhimbshëm dhe të mjerueshëm.⁵

KAPTINA EL FIL – SHPREHJE E NDIHMËS SË ALLAHUT

Fillimi i kësaj kaptine, paraqet një pyetje hyjnore drejtuar Muhamedit a.s.: *أَلَمْ تَرَ كَيْفَ فَعَلَ رَبُّكَ بِأَصْحَابِ الْفِيلِ* – “A nuk e ke parë, se ç'bëri Zoti yt me poseduesit e elefantit?”⁶ Kjo pyetje nuk ka për qëllim të verifikojë nëse ai ka qenë dëshmitar i drejtpërdrejtë i ngjarjes, por synon të nxisë kujtesën dhe njohurinë e tij për atë që ka ndodhur. Me fjalë të tjera, kuptimi i saj është: “A nuk ke dëgjuar?” ose “A e di se çfarë veprimi ndërmori Zoti yt ndaj pronarëve të elefantit – ndaj Ebrehesë dhe ushtrisë së tij, e cila marshoi drejt Mekës me qëllim të shkatërrimit të Shtëpisë së Shenjtë, Qabesë?” Në lidhje me këtë, mufesiri i njohur Taberiu thekson se shprehja “A nuk e ke parë?” - *أَلَمْ تَرَ* vije në kuptimin: “A nuk ke vështruar me syrin e zemrës që të kuptosh?”. Kjo shprehje, nuk i referohet shikimit fizik, por është një ftesë për të kuptuar ngjarjen në thellësi, për ta perceptuar atë me mendje dhe reflektim. Me këtë, qëllimi

është që Muhamedit a.s. t'i kujtohet dhe t'i bëhet e qartë se si ka ndodhur kjo ngjarje madhështore.⁷ Razi, përveç kuptimit “të dish”, i shton edhe kuptimin “të përkujtos”, duke nënvizuar se ngjarja e Ebrehesë është kaq e njohur dhe e sigurt, sa që arrin në shkallën e transmetimit të shumëfishtë (mutevativ). Ai thekson se ky është një tregues i famës së ngjarjes në mesin e arabëve dhe sjell në vëmendje vargun nga kaptina Jasin, ku thuhet: “*A nuk e panë ata, se sa gjenerata kemi zhdukur para tyre dhe ata nuk u kthyen.*”⁸ Ky krahasim e thekson universalitetin e ligjit hyjnor në histori: çdo popull që sfidon të vërtetën, përfundon i shkatërruar, pavarësisht fuqisë së tij materiale.⁹

Ndërkohë, Kurtubiu, shprehjen: “*A nuk e ke parë?*” e interpreton në formën: “*A nuk të është treguar?*”, duke e lidhur atë me konceptin e njoftimit të sigurt.¹⁰ Në lidhje me këtë, Sharavi, thekson se përdorimi i shprehjes: “*A nuk e ke parë?*”, nuk është rastësor, por lidhet ngushtë me mënyrën se si njeriu fiton diturinë. Sipas tij, njohja te njeriu fillimisht realizohet përmes shqisave – veçanërisht të dëgjuarit dhe të parët – dhe vetëm më pas përmes proceseve mendore e logjike. Pra, shqisat janë porta e parë e perceptimit dhe të kuptuarit, ndërsa të menduarit vjen si fazë e dytë pas përvojës shqisore. Këtë rend logjik e mbështet edhe një ajet kuranor, ku thuhet: “*Allahu ju nxori nga barqet e nënave tuaja (si*


Ngjarja e elefantëve është një ngjarje e jashtëzakonshme dhe madhështore, sepse një ushtri e fuqishme u shkatërrua nga gurë të vegjël të hedhur nga zogji po ashtu të vegjël – një zhvillim që nuk mund të shpjegohet në mënyrë natyrore, por që bart në vetvete dëshminë e një mrekullie.

foshnje), që nuk dinit asgjë. Ju pajisi me (shqisa për) të dëgjuar, me të parë dhe me zemër, ashtu që të jeni falënderues.”¹¹ Ky ajet, sipas Sharavit, tregon qartë se perceptimi shqisor është themeli i formimit të dijes te njeriu, andaj edhe përdorimi i formulës: “*A nuk e ke parë?*” në këtë kontekst është përzgjedhur me urtësi dhe qëllim të thellë.¹² Në këtë aspekt, shprehja i drejtohet në mënyrë universale çdo lexuesi të Kuranit në çdo kohë.

Ndërsa, pyetja që formohet përmes “*si*” e përmendur në ajet tregon aspektin cilësor të kësaj ngjarjeje. Nëse do të pyetj “*çfarë ndodhi?*”, fokusi do të ishte mbi përmbajtjen ose natyrën e ngjarjes. Por, përkundrazi, theksimi i mënyrës se si ndodhi ngjarja është një tregues i aspektit të saj të jashtëzakonshëm apo të mrekullueshëm. Kjo, sepse ngjarja nuk është një ngjarje e zakonshme, e përsëritshme, por përfaqëson një ndërhyrje të pazakontë hyjnore në rrjedhën e zakonshme të historisë. Edhe pse ndonjë dukuri e zakonshme mund të jetë në vetvete e jashtëzakonshme – si shembull, lindja dhe perëndimi i diellit apo krijimi i një gjallese – për shkak se ndodhin vazhdimisht, njeriu shpesh nuk i vlerëson siç duhet. Në të vërtetë, në raport me atributin krijues të Allahut, edhe këto janë mrekulli. Por pikërisht për shkak të përsëritjes, ato perceptohen si të zakonshme dhe nuk shkaktojnë habi te njeriu. Në këtë kuptim, ngjarja e elefantit (filit) është thellësisht e jashtëzakonshme. Ajo nuk përfaqëson thjesht një humbje apo shkatërrim ushtarak, por është një shfaqje e drejtpërdrejtë e fuqisë hyjnore në mbrojtje të Qabesë. Prandaj, për të shmangur trajtimin e saj si një ngjarje e rëndomtë historike, në ajet theksi nuk është vënë tek ajo se çfarë ndodhi, por te fakti se si ndodhi. Në këtë mënyrë, Kurani orienton lexuesin të vërejë natyrën e pazakontë dhe të mrekullueshme të kësaj ndodhie, duke i dhënë asaj një kuptim më të thellë akaidologjik dhe shpirtëror.

FUQIA E ALLAHUT MBI PLANET E NJERËZVE

Rrëfimi në këtë kaptinë vazhdon përsëri në formë pyetjeje: “*A nuk ua bëri përpyekjen e tyre të dështuar?*”¹³ duke vënë në pah faktin, se Zoti i Lartësuar ka për qëllim t'i kujtojë të



Dërguarit të Tij dhe të gjithë atyre që u është komunikuar mesazhi hyjnor, një ngjarje të jashtëzakonshme që dëshmon për fuqinë absolute dhe autoritetin e pakontestueshëm të Tij. Ai thekson se të gjitha fuqitë dhe autoritetet tokësore janë të nënshtruara ndaj vullnetit të Allahut, se Ai është Sunduesi Mbizotërues mbi krijesat e Tij, dhe se asnjë fuqi, sado e madhe të jetë, nuk mund ta pengojë apo sfidojë urdhrin e Tij. Ngjarja që përshkruhet në kaptinë është ajo e një populli që, me qëllim që të mposhte disa prej robërve të Allahut dhe t'u shkaktoje atyre dëme e vuajtje duke i shkatërruar edhe vendadurimin e tyre Qabenë, mobilizoi një ushtri të fuqishme, të përforcuar me elefantë – simbol i fuqisë dhe i autoritetit në atë kohë. Megjithatë, Zoti i Madhëruar, me urtësinë dhe fuqinë e Tij të pakufishme, i shkatërroi ata, me gjithë kurthet dhe planet e tyre, dhe kështu u dështoi çdo përpjekje, pavarësisht numrit dhe përgatitjes ushtarake që posedonin.¹⁴ Në këtë mënyrë në kuptim të përgjithshëm ky ajet thekson se suksesi nuk u takon atyre që posedojnë mjete materiale dhe forcë të jashtme, por atyre që janë nën mbrojtjen dhe ndihmën e Allahut. Fuqia e vërtetë i përket Allahut, dhe historia dëshmon se çdo përpjekje që synon të sfidojë të vërtetën është e destinuar të dështojë. Në këtë kontekst Zoti i Madhëruar thotë: “*Ata planifikonin dredhi, kurse Allahu ngrinte kurthe (kundër tyre), Allahu është më i miri i atyre që bëjnë kurthe.*”¹⁵

Në vazhdim të kësaj kaptine, Zoti i Madhëruar, ofron një shpjegim të qartë se si ndodhi kjo ngjarje e jashtëzakonshme duke thënë: “*Dhe Ai kundër tyre lëshoi shpendë që vinin tufë-tufë! Dhe i gjuanin ata me gurë nga balta e gurëzuar! Dhe ata i bëri si gjeth i grimcuar (i përtypur)!*”¹⁶ Në tefsiret klasike, kjo ngjarje është trajtuar në tërësi si një mrekulli hyjnore. Sipas tyre, Allahu i Plotfuqishëm deshi që ushtrinë e madhe të Ebrehesë ta shkatërronte me një ushtri të Tij, në këtë rast as me njerëz e as me engjëj, por me tufa të tilla zogjesh, - secili prej të cilëve mbante tre gurë një në sqep dhe nga një në secilën kthetër – që nuk ishin parë dhe as nuk ishin të njohur më parë nga arabët. Ata kishin ardhur nga drejtimi i detit dhe, pasi përmbushën misionin e tyre, u rikthyen nga kishin ardhur. Sipas një transmetimi që i atribuohet lkrimes, thuhet: “*Secili që u godit nga ata gurë, atij iu shfaqte lija.*”¹⁷ Sipas këtij transmetimi, për herë të parë në rajonin e Hixhazit sëmundjet si lija dhe fruthi janë shfaqur pas kësaj ndodhie.¹⁸ Sipas Abduhus, shprehja “zogj” e përmendur në ajet mund të nënkuptojë jo domosdoshmërisht zogj në kuptimin klasik, por edhe insekte si mizat, mushkonjat apo bartës të mikrobeve.¹⁹ Megjithatë, shumica e komentuesve kanë kundërshtuar këtë interpretim, duke e cilësuar atë si një tentativë për të racionalizuar një ndodhi që Kurani e paraqet si të mbinatyrshme dhe mrekullibërëse. Ndërsa, Raziu thekson se shprehja “zogj” e përmendur në ajetin kuranor përçon dy kuptime. Së pari, ai e lidh këtë formë me kuptimin e nënvlerësimit (tahkir), që në këtë kontekst ka për qëllim të theksojë madhësitë e asaj që ndodhi: përballë një ushtrie

të madhe, shfaqja e disa zogjve të vegjël dhe veprimi i tyre shërben për të dëshmuar fuqinë absolute të Allahut. Kuptimi thelbësor është se, edhe gjërat më të vogla, kur janë në shërbim të vullnetit hyjnor, marrin përmasa të jashtëzakonshme dhe bëhen të rëndësishme. Interpretimi i dytë i Raziut fokusohet te theksimi i madhësisë së ngjarjes. Ngjarja e elefantëve është një ngjarje e jashtëzakonshme dhe madhështore, sepse një ushtri e fuqishme u shkatërrua nga gurë të vegjël të hedhur nga zogi po ashtu të vegjël – një zhvillim që nuk mund të shpjegohet në mënyrë natyrore, por që bart në vetvete dëshminë e një mrekullie.²⁰ Po ashtu interpretuesi bashkëkohor Sharaviu shton se në këto ajete kuptohet qartë se nuk kemi të bëjmë thjesht me një akt të zakonshëm, por me një ndërhyrje të veçantë dhe të jashtëzakonshme, e cila nuk mund të realizohet nga askush tjetër përveç Allahut të Madhëruar.²¹ Si rrjedhojë, një forcë agresore që synonte shkatërrimin e Shtëpisë së Allahut (Qabesë) u ndëshkua në mënyrë të jashtëzakonshme, ndërsa banorët e Mekës, të cilët nuk kishin asnjë mundësi përballjeje dhe ishin tërhequr në male për t'i shpëtuar sulmit, dolën të paprekur nga kjo ngjarje. Kjo dëshmon për ndihmën hyjnore në mbrojtje të shenjtërisë dhe nderit të Qabesë.

Në këtë kontekst, urtësia e kësaj ngjarjeje, edhe pse në aspektin historik i përket një periudhe dhe vendi të caktuar, në përmbajtje përçon mesazh me vlerë universale. Ajo përfaqëson betejën ndërmjet të së vërtetës (hakut) dhe të së pavërtetës (batilit), duke lënë të nënkuptohet se, në fund, e vërteta gjithsesi do të triumfojë si një realitet që vazhdon deri në Ditën e Gjykimit. Kësisoj, shkatërrimi, dhuna dhe padrejtësia nuk do të mbesin të pa ndëshkuara qoftë herët apo vonë. Nga kjo rrjedh se detyra e besimtarit është të pozicionohet përkrah së drejtës, duke ndjekur udhëzimet e Kuranit, dhe të marrë qëndrim të qartë ndaj çdo forme padrejtësie e devijimi, në çdo kohë dhe rrethanë.

1 Kurtubi, *El Xhamiu 'l Ahkami' l Kuran*, XX/141.

2 Yıldırım, *İlmin Işığında Asrın Kuran Tefsiri*, XIII/ 6899-6700.

3 Mevdudi, *Tefhimu'l Kuran*, VII,241-242.

4 Muhamed Husejn Hejkel, *Hajatu Muhamed*, 120.

5 Sekafi, *El Burhan*, 218.

6 Fil, 1.

7 Taberi, *Xhamiu'l Bejan*, XXIV/605.

8 Jasin, 31.

9 Razi, *Mefatihul Gajb*, 32/289.

10 Kurtubi, *Xhamiu li Ahkami' l Kuran*, XX/187.

11 Nahl, 78.

12 Sharavi, *Tefsir suretejl el Fil ve Kurejsh*, 17-22.

13 Fil, 2.

14 Muhamed Abduh, *Tefsiru Xhuzi Amme*, 157-158.

15 Enfäl, 30.

16 Fil, 3-5.

17 Ibën Hisham, *Es Siretu'n Nebevije*, I/54-56.

18 Taberi, *Xhamiu'l Bejan*, XXIV/608.

19 Muhamed Abduh, *Tefsiru Xhuzi Amme*, 157-158.

20 Er Razi, *Mefatihul Gajb*, 32/291.

21 Sharavi, *Tefsir suretejl el Fil ve Kurejsh*, 22.

Muhadramët – bashkëthemelues të hallkës së parë të medhhebit hanefi

Dr. Muhamed Stublla

Në kohën e betejës së Bedrit, sipas burimeve historike ishin rreth 1500 myslimanë, në luftën e Bedrit morën pjesë 314 ose 20.9% e tyre. Nga këta 314, rreth 70 ose 22.3% banuan në Kufë, qytetin ku u themelua medhhebi hanefi. Kurse pjesëmarrës në besëlidhjen e Err Rudvanit – nën pemë – ishin rreth 1400, prej tyre në Kufë banuan rreth 300 ose 21.5%.

Pa dyshim se ata që besuan dhe qëndruan krah për krah me Muhamedin a.s. që nga fillimet e para të Islamit, duke përballuar çdo lloj shtypjeje politike, shoqërore, ekonomike, fizike, madje edhe vrasjen e më të dashurve të tyre, nuk janë njësoj me ata që më vonë gëzuan frytet e atyre sakrificave. Në kohën e betejës së Bedrit, sipas burimeve historike ishin rreth 1500 myslimanë, në luftën e Bedrit morën pjesë 314 ose 20.9% e tyre. Nga këta 314, rreth 70 ose 22.3% banuan në Kufë, qytetin ku u themelua medhhebi hanefi. Kurse pjesëmarrës në besëlidhjen e Err Rudvanit – nën pemë – ishin rreth 1400, prej tyre në Kufë banuan rreth 300 ose 21.5%.¹ Në atë kohë, në rastin më të mirë, nuk paramendohej se totali i myslimanëve të ishte më i madh se 12,000 pjesëtarë. Pra, nga 1500 sahabë që e vizituan Kufën, rreth 370 ose 24.6% prej tyre ishin nga pjesëmarrësit e Bedrit dhe besëlidhjes nën pemë. Sikurse vetëm 10 nga sahabët të kishin transmetuar fenë, do të mjaftonte që të konsiderohej zinxhiri i medhhebit hanefi i pa kontestuar ose mutevatir, kjo edhe sipas rregullave të hadithologëve, ndërsa 1500 sahabë që qëndruan në Kufë, sjellin qetësim shpirtëror për burimin e pa kontestuar të medhhebit, pavarësisht pretendimeve, e ndoshta nganjëherë edhe propagandës se Kufeja apo Iraku kanë qenë larg dhe nuk ka arritur hadithi atje. Këtë zinxhir e bëjnë edhe më të veçantë përfaqësuesit ose muxhtehidët më të mëdhenj të sahabëve, të cilët nuk ishin thjesht

vetëm transmetues, por ishin juristë, largpamës, udhëheqës fetarë dhe disa edhe bartës të institucioneve fetare dhe shtetërore. Studimet kanë treguar se nga 849 mendime fetare të Ibën Mesudit dhe Aliut r.a., 768 ose 90.3% përputhen me qëndrimet shkencore të medhhebit hanefi.² Kush guxon apo ka kompetencë të pretendojë se ata nuk menduan konform Sunetit?!

Pra, sahabët, mendimet e të cilëve 90% janë në përputhshmëri me medhhebin hanefi, konstatohet se ata vendosën themelet e mendësisë dhe rregullave hanefite. Mbaj mend, mos harro, medhhebi ka marrë diturinë nga të gjithë sahabët, medhhebi nuk vjen vetëm nga sahabët dhe dijetarët e Kufes. Gjithë këtë bagazh, angazhim, devotshmëri e sinqeritet, sahabët me kujdes dhe përkushtim e kanë bartur te tabiinët.

Tabiinë quhen të gjithë ata besimtarë të cilët i kanë takuar shokët e Muhamedit a.s.. Pra, tabiinët nuk janë takuar me Muhamedin a.s.. Edhe ata që e kanë takuar Muhamedin a.s., por Islamit e kanë pranuar pas vdekjes së tij, quhen tabiinë.

Ndërsa, ata ose ato që pranuan Islamit përderisa Muhamedi a.s. ishte në jetë, por nuk arritën ta takojnë atë quhen tabiinë muhadramë. Duke ditur që këta jetuan si myslimanë, ju përgjigjën thirrjes së Muhamedit a.s., edhe pse nuk e takuan atë, gjejmë prej dijetarëve që i quajnë edhe sahaibinjë. E vërteta është se nuk rangohen


nga sahabët, por janë më të afërmit e tyre.³ Faktikisht, sahabët dhe tabiinët muhadramë përbëjnë një hallkë zinxhirore të shkencës, edhe pse në rangim janë një shkallë pas, kjo pasi që ata jetuan dhe vdiqën në të njëjtën kohë dhe vend. Pejgamberi a.s. ka treguar se koha e tij dhe e shokëve të tij do të përfundojë brenda 100-vjeçarit të parë, kur njëherë ka thënë se pas 100 vjetësh do të vdesë çdo njëri që tash është gjallë.⁴ Tabiinët muhadramë, që jetuan dhe besuan Muhamedin a.s., hyjnë në këtë 100-vjeçar. Muhadrami i fundit që përmendet në këtë punim, ka vdekur në vitin 82 h., pas të cilëve jetuan edhe shumë sahaibinjë. Por, për nga vlera te Zoti, sahabët janë më të privilegjuar sesa muhadramët. Disa prej sahabëve kanë takuar Muhamedin a.s. pak ditë para se të vdiste, e kanë arritur nderin e sahabiut. Dija e tyre dhe sahabëve të rinj buron nga sahabët të cilët ishin shoqëruesit e Muhamedit a.s.. Tabiinët muhadramë jetuan me sahabët dhe fenë e morën nga ata, ngase nuk kishin nga kush tjetër ta merrnin atë. Dija e tabiinëve muhadramë mund të rangohet me sahabët, veçanërisht me sahabët e rinj, apo ata të cilët vetëm e kanë parë Muhamedin a.s., por nuk e kanë shoqëruar apo mësuar nga ai, sa që disa nga ata kanë transmetuar shumë pak hadithe drejtpërdrejt nga Muhamedi a.s..

Alkameja,
nxënës i Ibën
Mesudit dhe
dijetar i Kuranit,
mësoi nga
sahabë të njohur
dhe la një zinxhir
dijesh që forcoi
medhhebin
hanefi.

Ndër tabiinët muhadramë dhe muxhtehidët e veçuar në Kufe, të cilët përfaqësuan apo simbolizojnë bartjen e haditheve dhe dijes së Pejgamberit a.s. nga Ibën Mesudi dhe Aliu r.a., por edhe nga shumë sahabë të tjerë që ishin referenca dominuese e medhhebit hanefi, veçojmë:

Alkameh ibën Kajs en Nakhij, i cili ka lindur në kohën e Muhamedit a.s., por nuk e kishte takuar atë. Të gjitha transmetimet e tij vijnë nga sahabët. Pra, është muhadram, prej tabiinëve të parë. Alkameja ishte dijetar, imam dhe lexues i shkëlqyer i Kuranit, posedonte zë të bukur. Ishte besnik, i përpiktë, i njohur si transmetues i fuqishëm, asket dhe jurist i rrallë. I ngjante njërit prej sahabëve më të njohur për fetarizmin dhe diturinë e tij të jashtëzakonshme, Abdullah ibën Mesudit.⁵

Krahas shumë nxënësve të Ibën Mesudit, njeriu më i ditur dhe transmetuesi më i mirë i tij ishte Alkameja. Ibën Mesudi kishte thënë: “Nuk ndodh që unë të di diçka, e atë të mos e lexojë dhe dijë Alkameja.”⁶ Kjo dëshmi nga njëri prej sahabëve më të ditur, për nxënësin e tij, është pasuri, vlerë dhe krenari për Islamit në përgjithësi dhe në veçanti për shkollën juridike që i përket, medhhebin hanefi. Nga kjo kuptohet vazhdimësia, autenciteti dhe fuqia shkencore e medhhebit përmes së cilës shpjegohet Islami. Imam Shabiu numëroi fukahatë pas vdekjes së Ibën Mesudit, teksa të parin e rangoi Alkamen.⁷ Pas Ibën Mesudit, Alkames



iu kishte kërkuar që t'i mësonte njerëzit në xhami, por nuk pranoi,⁸ për shkak të modestisë. Alkameja ishte aq i ditur, sa që edhe nga shokët e Muhamedit a.s. e pyesnin për çështje fetare.⁹

Alkameja kishte mësuar dhe transmetuar nga sahabët më të ditur dhe më të dalluar, duke filluar nga mësuesit e tij kryesorë në Kufe – Irak, Ibën Mesudi dhe Aliu r.a., por edhe të tjerë si: Ebu Musa el Esharij¹⁰ dhe Habab ibën el Eret, që ishin në Kufe,¹¹ ndërsa Hudhejfe ibën el Jemani dhe Selman el Farisiu në el Medain, qytet në Irak.¹² Transmetoi edhe nga sahabiu i njohur, Ebu Derdaja që ishte në Damask – Sham. Pa dyshim që përqendrimin e kishte edhe në Medinë, veçanërisht tek: Omer ibën el Hatabi, Uthmani, Aisheja, Ebu Mesud el Ensari r.a..¹³ Kjo është dëshmi se dija e dijetarëve nuk përkufizohet vetëm me dijen e një lokacioni, andaj, si ka mundësi që medhhebi i cili u themelua, ndërtua, zhvillua dhe u shpërnda në shumicën të vendeve ku jetojnë myslimanët, të përkufizohet me një lokacion apo qytet?! Alkameja jetoi në kohën e sahabëve, vdiq në vitin 62 h.. Ai ishte prej më të diturve të kohës së tij, edhe pse në atë botë jetonin ende shumë nga sahabët. Pra, zinxhiri apo lidhja e dijes së medhhebit me Muhamedin a.s. përmes dijetarëve dhe juristëve si Alkameja, pa dyshim se është zinxhir i artë i transmetimit. Ai, për nga besueshmëria dhe dija, nuk zbret nën nivelin e sahabëve, por nga pozita e nderit është tabiin.

El Esved ibën Jezid en Nakhij, djali i vëllait të Alkames, e pranoi Islamin në kohën e Pejgamberit a.s., por ishte në Jemen dhe nuk e takoi atë, andaj quhet: tabiin muhadram.

Imam el Esvedi, ishte adhures i përkushtuar i Zotit xh.sh., lexonte Kuranin çdo javë, agjëronte thujse tërë vitin, vizitoi Qabenë shumë herë, si haxhi e umrexhi, ishte ndër juristët dhe transmetuesit e çmuar. Transmetoi prej sahabëve më të mëdhenj, prej Ebu Bekrit e tutje. Ndër sahabët që më së shumti i shoqëroi ishte Muadh ibën Xhebel, veçanërisht kur Muadhi r.a. ishte i deleguar i Pejgamberit a.s. në Jemen. Ishte i pandashëm nga Omer ibën el Hatabi, konsiderohej prej atyre që më së shumti përfituan nga Omeri r.a.. Pa dyshim që e shfrytëzoi Ibën Mesudin përderisa ishin të dy në Kufe. Imam el Esvedi ishte thesari i Kufes, veçanërisht pas vdekjes së Alkames. Ai mësoi dhe transmetoi edhe nga Aisheja r.a., e cila kishte thënë: “Në Irak, nuk ka njeri më të nderuar dhe të respektuar nga unë sesa El Esvedi.”¹⁴ Duke pasur parasysh se Iraku lulëzonte nga shumë besimtarë të devotshëm dhe të dijsëm, dëshmia e Aishes r.a. tregon për gjithpërfshirjen e virtyteve fetare dhe shkencore të El Esvedit r.a.. Vdiq në vitin

Këta dijetarë dhe transmetues tabiinë muhadramë, janë vetëm disa nga ajka e kësaj gjenerate, njëkohësisht themeluesit e medhhebit hanefi apo mendësisë së tij, krahas shabëve r.a..

75 h..¹⁵ Ky kalibër i devotshmërisë dhe dijes, jo vetëm që e fuqizojnë dhe e bëjnë të pakontestueshëm nivelin dhe zinxhirin e medhhebit, por të tillët janë krenari dhe mrekulli të Islamit. Allahu ata i përdori për ta siguruar bartjen dhe ruajtjen e mesazhit hyjnor në formën më të mirë. Përmes këtyre, medhhebi e transmeton dhe kupton Sunetin e Muhamedit a.s., andaj duhet ta pasojmë medhhebin.

Mesruk ibën el Exhdaë el Hamedani, pranoi Islamin sa ishte gjallë Muhamedi a.s., por nuk kishte fatin ta takonte atë,¹⁶ pra ishte tabiin muhadram. Imam Mesruku ishte asket i rrallë, dijetar i shquar, jurist dhe gjykatës.¹⁷ Transmetoi hadithe nga shumë sahabë, duke filluar nga më të njohurit dhe më të diturit, siç janë: Ebu Bekri, Omeri, Othmani, Aliu, Ibën Mesudi, Zejd ibën Thabiti r.a. etj..¹⁸ Imam Shabiu r.a. ka thënë: “Nuk kam parë kërkuar të diturisë nëpër horizonte më të përkushtuar sesa Mesrukun r.a..¹⁹ Tregohet se Imam Mesruku nuk e kishte të qartë një ajet të Kuranit, për këtë kishte udhëtuar prej Kufes në Egjipt, atje i treguan që personi që e dinte

këtë kishte shkuar në Sham, dhe menjëherë u nis për në Sham.²⁰

Imam Mesruku ishte prej dijetarëve dhe transmetuesve kyç të medhhebit hanefi. Disa e kualifikuan menjëherë pas Alkames. Jahja ibën el Maini ka thënë: “Është aq i pranuar, sa që është e ulët të shtrohet kjo pyetje.”²¹ Angazhimi i tij për kërkim të dijes, pavarësisht ku ishte ajo, dhe transmetimet nga Zejd ibën Thabiti, i cili jetoi në Medinë, i cili konsiderohet referencë kryesore në medhhebin shafi, janë dëshmi që tregojnë për gjerësinë dhe moskufizueshmërinë e medhhebit hanefi me vend dhe persona. Botëkuptimi se medhhebet, edhe ai hanefi, janë burim i vetëm nga një lokacioni, është i gabuar. Imam Mesruku ka thënë: “Nuk vdes përveçse duke e praktikuar Sunetin e Pejgamberit a.s., të Ebu Bekrit, Omerit...” Pra, si të kemi rezerva për medhhebin kur ai transmetohet dhe mësohet nga gjigantët e tillë shkencorë dhe fetarë. Vdiq në vitin 63h..²²

Shurejh ibën el Harith el Kindij, dijetar i shquar, imam dhe gjykatës i njohur.²³ Shabiu dhe gjykatësi Aliu r.a. e kanë quajtur “gjykatësi i arabëve”, ishte ekspert gjyqësor, në këtë fushë, ishte edhe më i avancuar se Alkameja.²⁴ Imam Shurejhin për gjykatës në Kufe e emëroi Omeri r.a., dhe vazhdoi në atë detyrë për rreth 60 vjet, në kohën e Othmanit, Aliut. Vdiq në vitin 80 h.. Islamin e pranoi në Jemen, prandaj nuk e takoi Muhamedin a.s., por konsiderohej prej tabiineve të parë,²⁵ muhadram. Ka transmetuar nga Omeri r.a., Othmani, Aliu, Zejd ibën Thabit, Ibën Mesudi.²⁶ Ky i fundit ishte dijetar e myfti i Kufes. Realisht, gjykatësit i japin

orientim logjikës vepruese të fesë, të cilën e mbushi me dije Ibën Mesudi dhe e zhvilloi Aliu r.a.. Imam Shurejhi ishte shembulli më i mirë i një gjykatësi se si të ndërlidhen teoritë fetare me praktikën.

Zirr ibën Hubejsh el Esdij, është pretenduar se është sahabi, por e vërteta është se e pranoi Islamin sa ishte Muhamedi a.s. në jetë, por nuk mundi ta takonte atë, pra ishte dijetar i shquar i tabiinëve të parë muhadram.²⁷ Ibën Mesudi r.a. e konsultonte për gjuhën arabe, ndërsa Ebu Vaili r.a., edhe pse ishte sahabi, nuk fliste për fe në prezencën e tij. Imam Zirri është transmetues i njohur dhe prej më të përzgjedhurve. Ka transmetuar nga Omeri r.a., Abdullah ibën Mesudi, Aliu, Abdurrahman ibën el Avfi, Ubej ibën Kabi, Hudhejfe ibën el Jemani, Ebu Vaili etj..²⁸ Jetoi dhe vdiq në Kufe në vitin 82h.²⁹

Amër ibën Mejmun el Udiy, shoqërues i Muadh ibën Xhebelit në Jemen, pastaj edhe në Sham, banor i Kufes, nxënës i Ibën Mesudit, kishte dëgjuar edhe Omerin r.a..³⁰ Është pretenduar se Amër ibën Mejmuni ka takuar Muhamedin a.s.,³¹ mirëpo shumica e dijetarëve konstatojnë se ai ka pranuar Islamin në Jemen, andaj nuk ishte takuar me të, pra është tabiin shumë i njohur muhadram. Nxënës dhe shoqërues i Ibën Mesudit r.a.,³² besueshmëria e tij është e pa kontestuar. Ishte i njohur për devotshmërinë e tij, ka vizituar Meken rreth 55 herë për haxh dhe umre. Një kohë ka banuar edhe në Sham. Ka vdekur në Kufe në vitin 74h.³³ Ai takoi shumicën e sahabëve, jetoi në qendrat më të mëdha të Islamit: Meke, Medine, Sham dhe Kufe. Dituria e tij përfshinte të gjitha provincat islame dhe shumicën e sahabëve.

Suvejd ibën Gafleh el Medhhexhij, nga Kufeja.³⁴ Lindi në Jemen, 46 vjet para hixhretit. Ai iu kishte bashkuar radhëve të myslimanëve, dhe së bashku me një grup ishin nisur për të vizituar Muhamedin a.s., arritën në ditën që u varros Muhamedi a.s., pra, ishte tabiin muhadram. Suvejdi, një kohë qëndroi në Medine, e shoqëroi Ebu Bekrin, Omerin, Othmanin, Aliun, mësoi dhe transmetoi nga Ibën Mesudi r.a.. Ishte shumë i ditur, u printe myslimanëve në namaze. Një kohë të gjatë të jetës së tij e kaloi në Kufe, prandaj është njohur si banor i Kufes, ku edhe vdiq, në vitin 82h..³⁵ Kur thuhet për dikë se ka mësuar nga Ebu Bekri, Omeri r.a., ose dikush nga sahabët e hershëm apo siç quhen, sahabët e mëdhenj, kuptohet se dëgjueshmëria dhe përfitimi nga sahabët që jetuan në kohën e tyre, jo vetëm që është i mundshëm, por edhe i pakontestueshëm. Pa dyshim dhe me siguri të pa kontestuar, themi se këta dijetarë tabiinë muhadramë, ishin ata që kuptuan dhe praktikuan Kuranin dhe Sunetin ashtu sikurse sahabët, pasi që ata ishin myslimanë që nga koha e Muhamedit a.s., takuan, mësuar dhe jetuan me sahabët. Ata ishin të përkushtuar të mësonin fenë nga njerëzit më të afërt të tij, si nga Ebu Bekri, Omeri, Othmani, Aliu, Ibën Mesudi, Ajshja, Zejd ibën Thabiti, etj.. Të gjithë këta jetuan dhe vdiqën në kohën e sahabëve, nga viti 63–82h., pas tyre jetuan edhe shumë sahabë të tjerë.

Këta dijetarë dhe transmetues tabiinë muhadramë, janë vetëm disa nga ajka e kësaj gjenerate, njëkohësisht themeluesit e medhhebit hanefi apo mendësisë së tij, krahas shabëve r.a.. Nëse dikush e konteston saktësinë dhe praktikimin e Sunetit nga kjo gjeneratë, sjell dyshime te sahabët dhe tabiinët muhadramë, është injorant, jeton në iluzionin e ëndrrave, dhe i tilli sulmon fenë islame.

- 1 Ibën Mensur, Seid, *Sunen*, (Dar Esamiçij, 1997), 1/4. Ibën es Sead, Muhamed, *Et Tabekat el Kubra*, (Bejrut, Dar el Kutub el Ilmijeh, 1990), 6/89.
- 2 Shih, Dituria Islame nr. 417, gusht 2025, f.15-16.
- 3 El Ebnasi, Burhanudin, *Esh Shedha el Fejah min Ulum ibën es Salah*, (Mektebetu err Rrushd, 1998), 2/535-526.
- 4 Muslim, Muslim ibën el Haxhaxh, *Sahih Muslim*, (Turki, Dar et Tibaah el Amirah, 1334 h) 7/186.
- 5 Ibën Hiban, Muhamed ibën Hiban, *Eth Thikat*, (Indi, Vizareh el Mearif Ilihukumeh el Alije el Hindijeh, 1973), 5/208.
- 6 Edh Dhehebij, Shemsudin, *Tedhkirah el Hufadh*, (Liban, Bejrut, Dar el Kurub el Ilmijeh 1998), 1/39.
- 7 El Hatib el Bagdati, Ebu Beker, *Terih Bagadadi*, (Bejrut, Dar el Kutub el Ilmijeh, 2004), 12/297.
- 8 Ibën Sead, Muhamed ibën Sead, *Et Tabekat el Kubra*, (Bejrut, Dar el Kutub el Ilmijeh, 1990), 6/149.
- 9 Edh Dhehebij, Shemsudin, *Tedhhib el Kemal fi Esma err Rrixhal*, (Bejrut, Mesesetu err Risaleh, 1992), 20/306.
- 10 Ibën Sead, *Et Tabekat el Kubra*, 6/95.
- 11 Ibën Sead, *Et Tabekat el Kubra*, 6/93.
- 12 Ibën Sead, *Et Tabekat el Kubra*, 7/230-231.
- 13 Ibën Sead, *Et Tabekat el Kubra*, 6/94.
- 14 Ibën Sead, *Et Tabekat el Kubra*, 6/134-138.
- 15 Ibën Sead, *Et Tabekat el Kubra*, 6/138.
- 16 Ibën el Ethir, Alij ibën Ebu Bekër, *Esed el Gabeh fi Mearifeti es Sahabe*, (Bejrut, Dar el Kutub el Ilmijeh, 1994) 1/150.
- 17 Ibën Sead, *Et Tabekat el Kubra*, 6/1145-է է.
- 18 Ibën Ebi Hatim, Abdurrahman ibën Muhamed, *Exh Xherreh ve etTadil*, (Bejrut, Dar Ihja et Turath el Arabij, 1952), 8/396.
- 19 El Fesvij, Jakub ibën Sufjan, *El Marifetu ve et Terih*, (Rijad, el Mutemejz li Tibah ve en Nesher ve et Tevzië, 2019) 9/316.
- 20 Muglletaji, Alaudin, *Ikmal Tedhim el Kemal fi Esmae err Rrixhal*, (Bejrut, Dar el Kutub el Ilmijeh, 2011) 6/216.
- 21 Ibën Ebi Hatim, exh Xherreh ve etTadil, 8/397.
- 22 Ibën Sead, *Et Tabekat el Kubra*, 6/145
- 23 El Ixhlj, Ahmed ibën Abdullah, *Mearifetu eth Thikat min Rixhal Ehl el Ilm ve el Hadith ve min ed Duafa ve Dhikr Medhehibihim ve Ahbarihim*, i njohur: *Eth Thikat*, (Saudi, Medine, Mektebu ed Dar, 1958), 1/451.
- 24 El Buahri, Muhamed ibën Ismail, *Et Terih el Kebir*, (Rijad, en Nashir el Mutemejz lit Tiba'ah ve et Tevzië, 2019) 5/371.
- 25 El Kurtubij, Jusuf ibën Abullah, *El Istiabeh fi Mearifetu es Sahabeh*, (Bejrut, Dar el Xhebel, 1992), 1/701-702.
- 26 En Nevevij, Muhjudin ibën Sheref, *Tedhhib el Esma ve el Lugat*, (Bejrut, Dar el Kutub el Ilmijeh), 1/243.
- 27 Muglletaji, Alaudin, *El Inabeh fi Marifeti el Muhtelif fihim mine es Sahabeh*, (Rijad, Mektebetu err Rruzhd li Neshri ve et Tevzië) 1/222.
- 28 Ibën Sead, *Et Tabekat el Kubra*, 6/161-162.
- 29 Ibën Hiban, *Eth Thikat*, 4/269.
- 30 El Buahri, *Et Terih el Kebir*, 7/458.
- 31 Ibën Asakir, *Terih Dimeshk*, 46/412.
- 32 El Ixhlj, *Eth Thikat*, 2/186.
- 33 Ibën Hiban, *Eth Thikat*, 5/166.
- 34 Ibën Hiban, *Eth Thikat*, 4/321.
- 35 Ibën Sead, *Et Tabekat el Kubra*, 6/132-134.

Eutanazia ne optikën e fesë islame

Verona Rrahmani

Eutanazia, që në greqisht do të thotë “vdekje e këndshme dhe e bukur”, i referohet vrasjes së pacientëve, vuajtja ose trajtimi i të cilëve është i pamjaftueshëm për të lehtësuar ose kuruar, ose për të siguruar një vdekje të rehatshme dhe të këndshme për ata që janë në këtë situatë.

ÇFARË ËSHTË EUTANAZIA? CILA ËSHTË QASJA E ISLAMIT NDAJ VDEKJES SË ASISTUAR?

Si e trajton Islami aktin e përfundimit të jetës së dikujt, i njohur si eutanazi, i cili është bërë gjithnjë e më e popullarizuar vitet e fundit, ndërsa fushëveprimi i tij është zgjeruar? A mund të marrë dikush me një sëmundje të pashërueshme ndihmë mjekësore për t'i dhënë fund jetës së tij? Eutanazia, që në greqisht do të thotë “vdekje e këndshme dhe e bukur”, i referohet vrasjes së pacientëve, vuajtja ose trajtimi i të cilëve është i pamjaftueshëm për të lehtësuar ose kuruar, ose për të siguruar një vdekje të rehatshme dhe të këndshme për ata që janë në këtë situatë. Fjala eutanazi, që nënkupton fundin e një ngërçi, mund të thuhet se ka katër forma të dallueshme në praktikën mjekësore bashkëkohore: 1. Eutanazia vullnetare, që do të thotë se është opsionale; 2. Eutanazia jo-vullnetare, që do të thotë se

ndërprerja e jetës përcaktohet nga profesionisti i kujdesit shëndetësor që trajton pacientin; 3. Eutanazia aktive, përfshin përshpejtimin e vdekjes përmes ndërhyrjes mjekësore; dhe 4. Forma e katërt dhe e fundit e eutanazisë arrihet duke ndërprerë trajtimin e pacientit.

Ata që kanë një qasje pozitive ndaj eutanazisë shpesh theksojnë se duhet të jenë të pranishëm tre elementë për të ndihmuar në përfundimin e jetës: 1. Pëlqimi i pacientit; 2. Dhimbjet e forta dhe të padurueshme; 3. Sëmundjet e pashërueshme.

Pasi kemi përvijuar një profil të përgjithshëm të eutanazisë, le t'i qasemi tani temës nga perspektiva e teksteve dhe vlerave islame.

Jeta është një besim dhe mbrojtja e saj është thelbësore – Mbi të gjitha, parimi i paprekshmërisë së jetës, i besuar njerëzimit nga Zoti, është një nga pesë parimet themelore që gjenden në të gjitha fetë hyjnore. Mbrojtja e jetës arrihet duke shmangur gjërat që mund ta dëmtojnë atë dhe, nëse hasen, duke i larguar



ato gjëra. Në të vërtetë, Zoti në Kuranin fisnik urdhëron: “Mos e vrisni veten”. Në Kuran thuhet: “Mos vrisni asnjë njeri padrejtësisht, gjë që Allahu e ka ndaluar”, një varg tjetër e përshkruan vrasjen e padrejtë të një personi si vrasje të të gjithë njerëzimit.

Edhe dëshira për vdekje nuk është e miratuar – Edhe dëshira për vdekje, e lëre më për t’ia marrë jetën, nuk është e pëlqyer. Profeti Muhamed a.s., ka thënë: “Askush prej jush nuk duhet të dëshirojë vdekjen për shkak të një fatkeqësie që e godet në këtë botë. Por kushdo që detyrohet të dëshirojë vdekjen duhet të thotë: “O Allah, më mbaj gjallë për sa kohë që jeta është e mirë për mua, dhe kur vdekja është e mirë për mua, merr shpirtin tim.”

Nuk ka sëmundje të pashërueshme - Koncepti i sëmundjes së pashërueshme gjithashtu nuk shihet në mënyrë të favorshme në Islam. Profeti Muhamed a.s., ka thënë: “Çdo sëmundje ka një kurë; nëse gjendet një kurë, ajo do të shërohet me lejen e Allahut”, duke i urdhëruar kështu njerëzit të përpiqen për trajtim. Në të vërtetë, shkenca mjekësore është në zhvillim të vazhdueshëm. Disa sëmundje që dikur ishin të pashërueshme, ato sot janë bërë sëmundje të thjeshta. Është gjithashtu e mundur që disa sëmundje që sot konsiderohen të pashërueshme, në të ardhmen të bëhen të shërueshme.

Nuk ka domosdoshmëri në marrëdhënien shkak-pasojë – Një pikë tjetër e rëndësishme në lidhje me këtë çështje nga perspektiva e Islamit është se marrëdhënia midis shkaqeve dhe pasojave nuk është absolute. Ekzistenca ose mosekzistenca e një gjëje nuk është e nevojshme për ekzistencën e një tjetre. Për shembull, djegia me zjarr ose shërimi me ilaç mund të përmenden këtu. Pambuku digjet në momentin që prek zjarrin. Kjo sepse thelbi i zjarrit është djegia. Megjithatë, aftësia e zjarrit për të djegur pambukun varet nga leja e Zotit. Në këtë rast, është Zoti ai që e ndez vërtet zjarrin. Në të vërtetë, kur populli i tij e hodhi Ibrahimin a.s. në zjarr, zjarri nuk mundi ta digjte atë, sepse Zoti nuk donte që ai të digjej. Sëmundjet kanë një situatë të ngjashme. Ashtu siç nuk është as ilaçi dhe as mjeku që e shëron pacientin, nuk është sëmundja që vret. Sëmundja është shkak. Një sëmundje që dihet se është fatale mund të mos e vrasë as personin që prek. Prandaj, veprimi i nevojshëm është të hulumtohen metodat e trajtimit, të përpiqesh për të gjitha kushtet për trajtim, të mbash moralin e pacientit lart dhe t’i lutesh Zotit.

Sëmundja është një sprovë – Për myslimanët, bota është një vend sprovash. Një nga vendet e sprovave është shpirti. Detyra e një personi të sprovuar nga një sprovë e tillë është të jetë i duruar dhe të ruajë vullnetin e tij. Zoti e shpreh këtë si më poshtë: “Ne gjithsesi do t’ju sprovojmë me diçka nga frika dhe uria, edhe me humbje të pasurisë dhe të jetës e të frutave.

Lidhur me eutanazinë pasive, e cila përfshin ndalimin ose refuzimin e trajtimit, Jusuf el Kardavi mban pikëpamjen se trajtimi është i detyrueshëm në rastet kur ka shpresë për shërim.

Dhe ti përgëzoji durimtarët. Të cilët kur i godit ndonjë e papritur vetëm thonë: “Ne jemi të Allahut dhe ne tek Ai po kthehemi!” Ata i pret bekimi dhe mëshira e Zotit të tyre, këta janë ata të cilët janë në rrugë të drejtë.” (El Bekare, 155-157). Siç kuptohet qartë në ajetet e lartpërmendura, një person nuk ka të drejtë dhe nuk ka autoritet për të marrë jetën e vet, pa marrë parasysh rrethanat.

Sëmundja është shlyerje për mëkatet, ata që janë të duruar do të fitojnë në planin afatgjatë – Detyra e një myslimani në rast sëmundjeje është ta largojë atë dhe të jetë i durueshëm. Profeti Muhamed a.s., deklaroi se sëmundja është një shlyerje për mëkatet, duke treguar se ajo duhet të durohet.

PIKËPAMJET E JURISTËVE BASHKËKOHORË ISLAMIKË MBI EUTANAZINË

Sot, juristët islamikë e konsiderojnë eutanazinë aktive si një çështje që kërkon shqyrtim serioz brenda kornizës së burimeve parësore të Islamit. Duket se qëndrimi i Kardavit, Bordit të Fetvave të Universitetit Al

Azhar, myftinjve egjiptianë dhe organizatave të tilla si ECFR/ Këshilli Evropian për Fetva dhe Kërkime, IMA/Shoqata Mjekësore Islame dhe IMANA/Shoqata Mjekësore Islame e Amerikës së Veriut është që nuk është e lejueshme që një pacient ta vrasë veten, është gjithashtu absolutisht e palejueshme që dikush tjetër ta vrasë atë, madje edhe me lejen e tij.

Lidhur me eutanazinë pasive, e cila përfshin ndalimin ose refuzimin e trajtimit, Jusuf el Kardavi mban pikëpamjen se trajtimi është i detyrueshëm në rastet kur ka shpresë për shërim. Asambleja e Akademisë së Fikhut Islamik, në sesionin e saj të tretë të mbajtur në Aman, kryeqytetin e Jordanisë, në 8 tetor të vitit 1986, shqyrtoi të gjitha aspektet e çështjes së shpëputjes së pacientëve nga pajisjet e kujdesit intensiv dhe, pasi dëgjoi shpjegimet e mjekëve specialistë, vendosin që kjo është e ndaluar. Akademia e Fikhut brenda Rabita al Alamil al Islami, një organizatë e themeluar për të siguruar koordinimin fetar dhe ndihmën e ndërsjellë midis vendeve islame, njoftoi gjithashtu në takimin e saj në Mekë në vitin 2015 se eutanazia (al katlu’r-rahim) është e ndaluar, edhe nëse kërkohet nga pacienti ose të afërmit e tij.

Kërkesa për të marrë mendime nga tre mjekë specialistë në lidhje me trajtimin – Sipas Akademisë, nëse mjeku specialist përgjegjës për trajtimin e pacientit është i bindur se trajtimi do t’i sjellë dobi pacientit dhe nuk do të shkaktojë dëm, ose se përfitimet ia kalojnë dëmit, ata duhet të vazhdojnë trajtimin, edhe nëse efekti është i përkohshëm. Sepse Zoti i

Plotfuqishëm mund t'i përgjigjet trajtimit në një mënyrë që tejkalon pritjet e mjekut.

EUTANAZIA NË FE

Eutanazia në Islam – Sipas Islamit, Zoti i ka dhënë njeriut një jetë. Prandaj, një person nuk ka të drejtë të vendosë për jetën e vet. Jeta e çdo qenieje të dhënë jetë nga Zoti merret gjithashtu nga Zoti. Si vetëvrasja, ashtu edhe eutanazia janë të ndaluara në Islam. Lënia e pacientëve të vdesin është gjithashtu një mëkat, dhe mjekët konsiderohen vrasës. Për më tepër, një person nuk ka të drejtë t'i japë fund jetës së një personi tjetër. Eutanazia është e ndaluar në pothuajse çdo shoqëri që ka përqafuar Islamin. Zoti në Kuranin fisnik thotë: “Kushdo që vret një person, përveç për një jetë ose për përhapjen e dëmeve në tokë, është sikur të ketë vrarë të gjithë njerëzimin. Dhe kushdo që shpëton jetën e një personi, është sikur të ketë shpëtuar të gjithë njerëzimin.” Kurani gjithashtu thotë: “O ju që keni besuar! Mos e vrisni veten! Vërtet, Allahu është mëshirues ndaj jush. Dhe kushdo që e bën këtë nga armiqësia dhe padrejtësia, Ne do ta hedhim në zjarr; dhe kjo është e lehtë për Allahun.” (En Nisa, 29-30) dhe “...mos e vrisni shpirtin që Allahu e ka ndaluar pa të drejtë. Allahu ju tregon këtë vetëm që të kujtoni.” (El Enam, 151).

Eutanazia në Judaizëm – Pikëpamja e njerëzimit dhe jetës njerëzore është themeli i kësaj feje. Në këtë fe, besohet se jeta njerëzore është dhënë nga Zoti dhe mund të merret përsëri nga Zoti. Eutanazia nuk konsiderohet e pranueshme në këtë fe, e cila e konsideron jetën të shenjtë.


Eutanazia në Krishterim – Në këtë fe, marrja e jetës së vet dhe e jetës së tjerëve është rreptësisht e ndaluar që nga lindja. Jeta njerëzore konsiderohet gjithashtu e shenjtë në këtë fe.

Eutanazia në Budizëm – Çdo murg që flet për avantazhet e vdekjes, mjerimin e jetës dhe mirësinë e jetës së përtejme, ose që inkurajon vetëvrasjen, përjashtohet nga profesioni i tij dhe nga feja. Kjo fe gjithashtu ndalon rreptësisht ndërprerjen e trajtimit për ata që janë të sëmurë në mënyrë të pashërueshme ose përpjekjen për të përshpejtuar vdekjen e tyre duke i lënë të vdesin.

EUTANAZIA NË DISA VENDE TË BOTËS

Eutanazia është e ligjshme në pesë vende të Evropës: Belgjikë, Holandë, Luksemburg dhe së fundmi në Gjermani dhe Spanjë.

Eutanazia në Kosovë – Eutanazia nuk është një koncept i përcaktuar në ligjin kosovar dhe nuk ka rregullore në lidhje me eutanazinë në Ligjin Penal. Kjo ndodh sepse, në ligjin tonë, e drejta për jetën është e drejta më themelore dhe nuk mund të shfuqizohet. Megjithatë, në vendin tonë, e drejta për jetën nuk konsiderohet një e drejtë nga e cila



Eutanazia në Europë:

- Blu:** Eutanazia aktive është legale
- E verdhë:** Vetëvrasja e asistuar është legale
- E gjelbër:** Eutanazia pasive është legale
- E kuqe:** Asnjë formë e eutanazisë nuk është legale / Çdo formë e eutanazisë e ndaluar
- E zezë:** Situatë juridike e paqartë
- Gr:** Nuk ka të dhëna

mund të hiqet dorë. Askush nuk ka të drejtë t'i japë fund jetës së vet ose jetës së një tjetri. Ekzistenca e çdo pëlqimi në këtë çështje nuk e eliminon paligjshmërinë e aktit. Në vendin tonë, një mjek që kryen në mënyrë aktive eutanazinë konsiderohet se ka kryer krimin e vrasjes me paramendim dhe dënohet me burgim. Jeta është dhurata më e çmuar që i është dhënë njerëzimit. Është në fuqinë tonë ta jetojmë atë siç zgjedhim. Ndonjëherë sprovohemi për ta vlerësuar këtë mundësi.

- Tuba Erkoç, “Fikhi Açidan Hayatın Sonuna İlişkin Tıbbi Sorunlar: Ötanazi”.
- Hayatın Başlangıcı ve Sonu Tıbbi, Dinî ve Etik Sorunlar, İstanbul 2013, s. 284-285.
- Mecmau'l-Fikhi'l-İslâmî | 11-16. (الإسلامي الفقه مجمع).
- Alpert, Rebecca, Grief and Rituals Surrounding Death A Jewish Approach, Religion, Death and Dying.
- İlmi hal: İslam ve Toplum.
- Türkiye Diyanet Vakfı Yayınları, Hadis Ansiklopedisi Kütüb-i Sitte.
- Hamdi, Ölümsüzlük İhtiyacı: İntihar, Ötanazi ve Reenkarnasyon, İstanbul: Boğaziçi Yayınları, 2011. Kaplan, Zvi, “Ben Petura”.
- Yahudilikte, Hristiyanlıkta ve İslam'da Ötanazi.
- İlahiyat Fakültesi Dergisi Kaya, Ali, “İslam Hukukuna Göre Ötanazi”, UÜİFD, VI, 6 (1994).
- Sarıkoğlu, Ekrem, Başlangıçtan Günümüze Dinler Tarihi, 7. bs.
- Isparta: Fakülte Kitabevi, 2011. Tan, Oğuzhan ve Ünal Yerlikaya, “Tıpla İlgili Problemler”.
- The Catholic Encyclopedia, “Euthanasia”, ed. Charles G. Herberman, vol. 5.

Komponentët e edukimit ndërmjet asaj se çka lipset të jenë dhe realitetit

Dr. Myrvete Allmeta

Ai popull që i kushton rëndësi edukimit është i gjallë, frymon, kurse ai popull që veç ha dhe pi dhe nuk do t'ia dije se ku bie edukimi i bijve të vet, atëherë nuk ka shpresë për të që të ngrihet dhe avancojë. Nëse flasim për edukimin, ne flasim për të ardhmen. Me të vërtetë e ardhmja e vendeve, e ardhmja e shoqërive, e ardhmja e popujve fillon me njeriun, fillon me fëmijën. Sot kemi dy lloje kulturash që duan të sfidojnë njëra-tjetrën: kulturën e betonit që na mbin si kërpudhë vend e pa vend në formë gradaçelash dhe kulturën e ndërtimit të njeriut. Profeti ynë, a.s. nuk la kështjella e saraje por la njeriun, la sahabët që shkuan e çliruan gjithë botën me besimin e pastër që poseduan. Për pesëmbëdhjetë shekuj myslimanët udhë-

hoqën botën dhe edukimi ishte ai që e mbajti gjallë ymetin dhe kulturën e tij. Por, para se të futemi në çështjet e edukimit, çfarë do të thotë fjala edukim dhe fjala fëmijë nga ana gjuhësore?

Kuptimi i parë në fjalor i fjalës edukim do të thotë: Zgjuarsi, shkathtësi, zgjuarsi dhe mirëkuptim.¹ Ndërsa kuptimi i dytë: Fitore, arritje, si dhe shpejtësi përvetësimi dhe të mësuarit dhe drejtim i gjërave të shtrembëra.²

Ndërsa fjala fëmijë, nga ana gjuhësore, përdoret për njerëz dhe kafshë të vogla, si në njëjës ashtu edhe në shumës.³ Nëse kuptimi i fëmijës përcaktohet gjuhësisht, është e rëndësishme të specifikohet fillimi dhe fundi i kësaj faze.

Sot kemi dy lloje kulturash që duan të sfidojnë njëra-tjetrën: kulturën e betonit që na mbin si kërpudhë vend e pa vend në formë gradaçelash dhe kulturën e ndërtimit të njeriut.



SA ZGJAT FËMIJËRIA NGA ANA KOHORE?

Ajo që e përcakton kohëzgjatjen e fëmijërisë është thënia e Zotit të Madhëruar: “O ju njerëz, nëse dyshoni për ringjalljen, atëherë (mendonin krijimin tuaj që) Ne u krijuam ju prej dheu, pastaj prej uji, pastaj prej një gjaku të ngjizur, pastaj prej një sa kafshatë mishi, që është krijesë e formuluar ose e paformuluar, në mënyrë që t’ju sqarojmë. Ndërsa atë që e dëshirojmë Ne, e përqendrojmë në mitër deri në një afat të caktuar, e mandej u nxjerrim foshnje dhe ashtu të arrini pjekurinë tuaj. Ka që dikush prej jush vdes herët, e dikush të jetojë deri në pleqëri të thellë, në mënyrë që të mos dijë asgjë nga dija që ka pasur.” (El Haxh, 5).

Ajeti na tregon me detaje fazat e jetës njerëzore, duke shpjeguar se fëmijëria vjen pas vendosjes së embrionit në mitër dhe ndarjes së tij prej saj në lindje, derisa të arrijë pubertetin dhe të arrijë moshën e përgjegjësisë.

Imam el Kurtubiu, Zoti e mëshiroftë, në interpretimin e këtij ajeti thotë: “Fjala fëmijë në ajet: “Pastaj Ne e nxjerrim secilin prej jush si fëmijë”, përfshin periudhën kohore që nga koha e ndarjes nga mitra deri në pubertet.”⁴

Fëmijët marrin një vëmendje të veçantë në epokën e sotme nga shoqatat dhe organizatat e ndryshme të themeluara veçanërisht për ta. Dhe nuk është çudi që fëmija të marrë këtë vëmendje, pasi numri i fëmijëve nën moshën pesëmbëdhjetë vjeç në botë arrin në 36% e popullsisë së botës. Kjo përqindje bie në 27% në Amerikën e Veriut dhe vendet evropiane, rritet në 42% në Afrikën Jugore dhe më pas rritet në 44% në vendet afrikane dhe aziatike.⁵

Kombet e Bashkuara vendosën ta shpallin vitin 1979 si Vitin e Fëmijës, për të tërhequr vëmendjen ndaj kujdesit ndaj fëmijëve dhe për të treguar interes në fazën e fëmijërisë.⁶

Një numër vendesh ndërmorën programe dhe hapa praktikë që i japin kësaj faze, fëmijërisë, meritën në fushat e shëndetit dhe arsimit, dhe duke u ofruar fëmijëve vende për lojë, argëtim dhe rekreacion, por në vendet e vogla, e sidomos ato të varfra e që flakët e luftës vazhdojnë t’ua djegin fëmijërinë, shumica dërrmuese e fëmijëve janë të privuar nga të drejtat e tyre më themelore njerëzore. Ata jetojnë nën barrën e urisë, lakuriqësisë dhe padrejtësisë sociale, dhe vuajnë nga të gjitha format e mjerimit dhe privimit. Shembull të gjallë për këtë kemi fëmijët në Gaza.

Sot, statusi i fëmijëve është një zgjatim i statusit të tyre të lashtë në botë, përveç zonave që njiheshin për monoteizëm. Në epokat e kaluara, njerëzimi nuk i njihte plotësisht të drejtat e fëmijëve. Spartanët vrisnin çdo fëmijë, mashkull apo femër, nëse kishin mangësi trupore si: sakatë ose të verbër.

*“Unë do të krijoj
një mëkëmbës
(që do të zbatojë
ligjet e Zotit) në
tokë.”*

(El Bekare, 30).

Kjo u mbështet nga filozofë grekë si: Platoni etj.. Ai bëri thirrje gjithashtu për ndarjen e fëmijëve nga nënat e tyre, duke sugjeruar që dadot dhe infermieret duhet të zëvendësojnë nënat në edukim dhe kujdes, ndërsa babai romak kishte të drejta të plota për të vendosur për jetën ose vdekjen e fëmijës.⁷

PO ISLAMI, ÇFARË VIZIONI KA PËR NJERIUN, PËR FËMIJËN?

Allahu e ngriti dhe e nderoi njeriun, duke e pajisur atë me mendje, zemër, shpirt, dëshirë, vullnet, gjë që e dallon atë nga krijesat e tjera. “Ne vërtet, i nderuam

pasardhësit e Ademit (njerëzit), u mundësuam atyre të udhëtojnë hipur në tokë, e në det. I begatuam me ushqime të mira, i lartësuam ata mbi shumicën e krijesave që Ne i krijuam.” (El Isra, 70).

Por jo vetëm, Islami e konsideron njeriun mëkëmbës që lipset ta ndërtojë tokën, ta lulëzojë atë. Zoti thotë në Kuran: “Unë do të krijoj një mëkëmbës (që do të zbatojë ligjet e Zotit) në tokë.” (El Bekare, 30).

Zoti e quajti atë mëkëmbës, sepse e zgjodhi njeriun midis krijesave të tjera si përgjegjës dhe drejtues. Kjo është ajo që është transmetuar nga Ibën Mesudi, Ibën Abasi dhe El Sudi. Ky mendim mbështetet nga fjalët e Zotit të Plotfuqishëm drejtuar Davudit, paqja qoftë mbi të: “O Davud, me të vërtetë Ne të kemi bërë ty mëkëmbës në tokë, prandaj gjyko midis njerëzve me të vërtetën dhe mos ndiq dëshirat, sepse ato do të



të largojnë nga rruga e Zotit.” (Sad, 25). Ky është mendimi i shumë dijetarëve të tefsirit.⁸

Ky mëkëmbës që ta përmbushë misionin për të cilin është caktuar, sigurisht që duhet të kalojë nëpër stacionin e fëmijërisë, që duhet të jetë një fëmijëri jo dosido, por fëmijëri e shëndetshme nga ana fizike, mentale dhe shpirtërore.

Nëse do ta vëzhgojmë një fëmijë, atëherë do të vinim re se ai vjen në këtë botë i pajisur me energji, prirje, instinkte, aftësi dhe talente nga më të ndryshmet. Ai është i brishtë si një bimë e vogël që kërkon kujdes për t’u rritur, duhet ujitur, duhet t’i punohet toka, t’i plehërohet, t’i hiqen barërat e këqija etj.. Kur këto shërbime i ofrohen farës, ajo mund të rritet e të lulëzojë dhe japë fryte.

Por, që fëmija të rritet shëndetshëm fizikisht, mentalisht dhe shpirtërisht, vallë çfarë komponentësh ka nevojë në edukimin e tij?

TRASHËGIMIA GJENETIKE PRINDËRORE

Edukimi nuk bëhet në një ditë-natë, por fillon herët, që në bark të nënës, madje edhe më parë. Nga Aisheja, r.a., nëna e besimtarëve, transmetohet se Pejgamberi ynë, a.s., ka thënë: “Përzgjidheni njeriun me të cilin do lindni fëmijët tuaj.” Kur lexoj këto hadithe, sinqerisht më duket se ka mbaruar koha e edukimit siç duam ne.

Çdo ditë e kuptojmë që ne mundohemi të mbjellim, por filizat tanë shkulen me zor nga toka jonë për t’u mbjellë në toka të tjera ku ujiten me çka nuk duam ne.

Literatura e letërsisë dhe filozofisë i ka mbushur mendjen rinisë për lidhje të tipit: “*Colpo di fulmine*” thënë ndryshe: “Dashuri me shikim të parë”, e partneri mund të zgjidhet nga rruga, një njeri që nuk i njihet as fara as fisi, dhe kështu i riu, apo e reja përplasen me partnerë të panjohur dhe harrojnë se fëmija kur lind trashëgon karakteristikat dhe atributet e babait dhe të nënës, të cilët janë paraardhësit e tij më të afërt. Por mund të marrë nga gjyshërit nga ana e nënës ose babait, ose mund t’u ngjajë xhaxhallarëve ose tezeve. Kjo ndodh për shkak të pllenimit të gjeneve që ndodhen në kromozomet e vezores së femrës, me spermatozoidet mashkullore gjatë aktit seksual.¹⁰

Trashëgimia konsiderohet një faktor që ndikon në zhvillimin e fëmijës, qoftë ai i plotë, apo i mangët. Fëmija do të trashëgojë fizionominë dhe intelektin nga paraardhësit e tij të afërt, por jo rrallëherë ndodh që të marrë edhe nga një pjesëtar i largët i fisit. Këtë na e argumenton

Edhe gjidhënia ndikon në karakterin e fëmijës; qumështi i një gruaje të devotshme është bereqet, ndërsa ai i ushqyer me haram nuk ka bekim.

hadithi i mëposhtëm: Transmetohet në një hadith nga Ebu Hurejre r.a. se një burrë shkoi te Pejgamberi a.s. dhe i tha: “O i Dërguar i Allahut, më ka lindur një fëmijë i zi.” Pejgamberi a.s., i tha: “A ke deve?” Ai tha: “Po.” Pejgamberi a.s., i tha: “Çfarë ngjyre kanë?” “Të kuqe” – i tha ai. Pejgamberi a.s., i tha: “A ka prej tyre deve larushe?” “Po” - i tha ai. Pejgamberi a.s., i tha: “Si ka ndodhur kjo?” Burri i tha: “Ka mundësi t’i ketë ngjarë paraardhësve të saj.” Pejgamberi a.s., i tha: “Ndoshta me djalnin tënd ka ndodhur e njëjta gjë.”¹¹

Nuk dua të kaloj në pikën tjetër këtu pa cekur gjidhënien, të cilën shumë nëna entuziazmohen nga shoqëria e afërt me kolege, mike etj., dhe për t’i forcuar më shumë lidhjet, zgjedhin gjidhënien si mundësi. Gjidhënia, është një prej faktorëve që ndikon në karakterin e fëmijës. Ebu Hamid el Gazali ka thënë: “Nuk duhet t’i lihet fëmija për gjidhënie, madje as për përkujdesje, vetëm se një gruaje të devotshme, fetare, e cila ha të lejuarën. Pa dyshim se qumështi i mbledhur me ushqim haram, nuk ka pikë bereqeti në të.”¹²

Një argument për atë që cekëm më lart, është transmetimi i Abdurrahman ibën Ebi Bekrit r.a., i cili thotë: “Ebu Bekri r.a. takoi një burrë nga arabët të quajtur Afir dhe i tha: “A nuk e di se çfarë thotë Pejgamberi a.s. për dashurinë?” “Dashuria dhe egërsia trashëgohen.”¹³

Të gjitha këto transmetime, rezultojnë se trashëgimia është një nga elementët themelorë të zhvillimit fizik, psikologjik dhe fizionomik të fëmijës, andaj duhet ta mirëzgjedhë prindin e fëmijës.

1 Muxhem Makajis *el Lughah*, nga Ibën Faris 1/395.

2 *El Kamus* nga El Fejruzabadi 125/3 dhe *Taxh el Arus* nga El Zubejdi 51/6.

3 Shih: *El Kamus el Muhit*, Fejruzabadi, 4/251.

4 *Tefsir el Kurtubij* 12/12.

5 Hulumtim mbi fëmijën midis realitetit dhe aspiratave nga Esma Muhamed / 482.

6 Shih artikullin “*Tragjedia Globale e Fëmijës*”, nga profesor Shihab el Dabouni / 101, revista Minar al Islam.

7 Shih: *El Fehrest* nga El Nadim / 306, *El Munjid* nga El A’lam 42/2, dhe Enciklopedinë Arabe: El Mira / 181.

8 Fahrudin er Rrazi, *Çelësat e Gajbit*, Bejrut: Dar Ihja el Turath el Arabi, botimi i III, 1420 hixhri, (2/389).

9 Hadithi transmetohet nga Ibën Maxheh (1968), El Hakimi (2687) dhe El Bejhakiu (14130).

10 Hulumtimi në Sociologjinë Edukative dhe Etike, dr. Ali Abdul Vahid Vafi / 36.

11 Hadithi është muttefek alejhi, Buhariu: 5/2032; Muslimi: 2/1137.

12 *Ihja’ulum ed din*, Ebu Hamid el Gazali 3/70.

13 Transmeton Buhariu në: *Ede bel Mufred* 1/118.

Teoria para përvojës – edukimi qytetar pa themel vleror

NXËNËSIT E MOSHËS 12-15 VJEÇ PËRBALLË PLANPROGRAMEVE TË NGARKUARA ME TEORI DHE TË VARFRA NË PËRVOJË PRAKTIKE

PhD. Merjeme Gashi

Fjala edukim rrjedh nga gjuha latine *educere*, që do të thotë të edukojë, zhvillim i aftësive trupore, mendore dhe morale. Ky i fundit mund të arrihet përmes mësimit të vlerave morale dhe shoqërore.

Familja është agjenti i parë i socializimit të fëmijës dhe institucioni kryesor për transmetimin e vlerave nga një brez në tjetrin. Megjithatë, me përfshirjen e fëmijës në institucionet edukativo-arsimore, si kopshti dhe shkolla, këto institucione marrin një rol të rëndësishëm në procesin e socializimit. Ato ndikojnë në formimin e bindjeve, besimeve, qëndrimeve dhe personalitetit të fëmijës. Qëllimi i tyre nuk kufizohet vetëm në ofrimin e njohurive shkencore dhe zhvillimin e aftësive intelektuale e profesionale, por shtrihet edhe në zhvillimin mendor, moral dhe social të individit.

Sipas fjalorit sociologjik të Oxfordit, edukimi/arsimimi është një koncept sa filozofik aq edhe sociologjik, i cili paraqet ideologjitë, kurrikulat, dhe teknikat pedagogjike të ngulitjes dhe menaxhimit të diturisë, si dhe riprodhimin shoqëror të personaliteteve

dhe kulturave.¹ Fjala edukim rrjedh nga gjuha latine *educere*, që do të thotë të edukojë, zhvillim i aftësive trupore, mendore dhe morale. Ky i fundit mund të arrihet përmes mësimit të vlerave morale dhe shoqërore. Qëllimi i edukimit të vlerave është të nxjerrë në pah anët e mira që ekzistojnë te fëmija, të ndihmojë në zhvillimin e plotë të karakterit të tij dhe të sigurojë që ky zhvillim të jetë i vazhdueshëm. Nga ky këndvështrim, fëmijëve duhet t'u ofrohet një arsimim i drejtë lidhur me situatat morale dhe jomorale. Edukimi duhet të jetë i ndërtuar në mënyrë të tillë që të njohë dhe zhvillojë tre përmasat e njeriut: njohëse, emocionale dhe të sjelljes (praktike).² Ndryshe nga lëndët e zakonshme akademike, të cilat fokusohen kryesisht në zhvillimin kognitiv, edukimi mbi vlerat synon të formojë tërësinë e individit, duke e pajisur atë me busullën morale të nevojshme



për të përballuar kompleksitetin e shoqërisë moderne.³

Sipas Emile Durkheim-it, edukimi është diçka shoqërore, dhe si rezultat, çdo shoqëri dhe çdo periudhë historike ka krijuar sisteme të veçanta të edukimit. Sjellja e drejtë dhe e gabuar moralisht mund të mos jetë e njëjtë në të gjitha kulturat dhe mund të mos ekzistojnë standarde morale universale në të gjitha shoqëritë. Megjithatë, vlerat morale të përbashkëta që iu mësohen fëmijëve në shumë shoqëri përfshijnë: ndershmërinë, dhembshurinë, respektin, etikën, virtytin, të qenët qytetar model, si dhe drejtësinë. Në përputhje me këtë, fëmijët kanë nevojë të socializohen duke mësuar vlerat, normat dhe traditat e shoqërive përkatëse.⁴

Çfarë përfitimi në rrafshin individual dhe atë shoqëror mund të ketë edukimi vleror? Gjatë mësimit dhe përvetësimit të vlerave, si: respekti, toleranca, gjithëpërfshirja etj., mundësohet forcimi i harmonisë shoqërore brenda komuniteteve diverse. Ky lloj edukimi inkurajon mirëkuptimin e ndërsjellë, pranimin e dallimeve dhe bashkëpunimin për qëllime të përbashkëta. Gjithashtu, edukimi mbi vlerat mund të shërbejë edhe si masë parandaluese ndaj problemeve të ndryshme shoqërore, përfshirë diskriminimin, dhunën, abuzimin me substanca dhe krimin, dukuri këto që çdo herë e më shumë kanë filluar të jenë prezente në shoqërinë tonë. Mësimi, përbrendësimi, ushtrimi dhe praktikimi i vlerave fuqizon individët të refuzojnë sjelljet e dëmshme dhe të mbështesin norma pozitive shoqërore. Si rezultat, ky lloj edukimi kontribuon në mirëqë-

Edukimi mbi vlerat mund të shërbejë edhe si masë parandaluese ndaj problemeve të ndryshme shoqërore, përfshirë diskriminimin, dhunën, abuzimin me substanca dhe krimin, dukuri këto që çdo herë e më shumë kanë filluar të jenë prezente në shoqërinë tonë.

nien e përgjithshme të individëve, duke nxitur stabilitet emocional, vetëdije dhe ndjenjë qëllimi. Edukimi vleror promovon shëndet të mirë mendor, marrëdhënie të shëndetshme dhe qasje të balancuar të jetës.⁵

Hulumtimet gjithashtu kanë treguar se fëmijët që mësojnë vlerat morale të shoqërisë së tyre që në fëmijëri shfaqin ndërveprime sociale të harmonizuara gjatë gjithë jetës. Ndërsa fëmijët që nuk mësojnë moralin, karakterizohen nga delikuenca, mungesa e respektit për të tjerët, përdorimi i drogës, braktisja e shkollës dhe konflikteve në shkollë.⁶ Prezenca e dukshme e dukurive devijante në mesin e nxënësve të shkollave fillore dhe të mesme të Kosovës është shqetësuese. Dhuna fizike, psikologjike, verbale, mungesa e ndjeshmërisë sociale, ngacmimet seksuale, përdorimi i substancave narkotike, sjellja jo e mirë ndaj mësimdhënësit, mosrespektimi i rendit shkollor, përdorimi i armëve apo mjeteve të tjera sulmuese janë shqetësuese për shoqërinë kosovare. Një gjendje e tillë duhet të jenë alarmante për institucionin familjar, institucionet edukativo-arsimore, institucionet e tjera politike, që janë përgjegjëse për ruajtjen e rendit dhe sigurisë, si dhe për shoqërinë tonë në përgjithësi.

Sistemi edukativo arsimor në Kosovë a ka për qëllim edhe edukimin vleror të nxënësit?

Sipas Ligjit për Arsimin Parauniversitar të Republikës së Kosovës (Ligji Nr. 04/L032-), gjegjësisht nenit 2, qëllimet e arsimimit dhe aftësimit parauniversitar janë: zhvillimi i personalitetit, talentit dhe aftësisë mendore e fizike të nxënësit deri në potencialin e tij të plotë; avancimi i krijimit



të njohurive themelore shkencore, shkathtësive të komunikimit, vrojtimit dhe shkathtësive analitike, kreativitetit, mëvetësisë dhe aftësive të ndërlidhura të mësimnxënies; zhvillimi i respektit të nxënësi për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, si dhe për parimet e përcaktuara me Kartën e Kombeve të Bashkuara, me konventat përkatëse dhe në Kushtetutën e Republikës së Kosovës; zhvillimi i *respektit* të nxënësit për prindërit dhe mësimdhënësit, për identitetin kulturor, gjuhën dhe *vlerat e komunitetit* të tij, për *vlerat* e Republikës së Kosovës, për shtetin nga i cili mund të ketë prejardhjen dhe për *respektimin e diversitetit*; përgatitja e nxënësit për *jetesë të përgjegjshme* në frymën e *mirëkuptimit*, të *paqes*, *tolerancës*, *barazisë gjinore* dhe në *miqësi* me pjesëtarët e të gjitha komuniteteve në Republikën e Kosovës, e më gjerë; të zhvillojë të nxënësi *respektin për mjedisin*.⁷ Ky ligj i përcakton qartë se edhe respekti, vlerat e komunitetit, respektimi i diversitetit, mirëkuptimi, paqja, toleranca, barazia gjinore, miqësia dhe kujdesi për mjedisin përfshihen në qëllimet e sistemit arsimor parauniversitar.

Pas një analize të planprogramit të librave të lëndës Edukatë Qytetare (klasat 9-6), është parë një përqendrim më i madh në njësitë mësimore që trajtojnë tema mbi normat, vendimmarrjen, kushtetutën, institucionet, ligjet, nxjerrjen e ligjeve, shtetin e së drejtës, shoqërinë civile, të drejtat e njeriut, tolerancën fetare, ekstremizmin fetar. Në rend të parë një përmbajtje e tillë nuk përkon me aftësitë kognitive të fëmijëve të kësaj grupmoshe (12-15 vjeç). Përveç kësaj, njësitë mësimore janë shumë të ngarkuara me njohuri teorike, teknike, akademike dhe të mbushura me përkufizime. Lënda e Edukatës Qytetare **është shndërruar në një version miniaturë të shkencave sociale**, të destinuara për studentë universitarë, jo për fëmijë. Në vija të trasha mund të thuhet që ndër qëllimet kryesore të lëndës Edukatë Qytetare duket të jetë krijimi i qytetarisë, por jo i edukimit vleror. Fokusi i mësimave nuk qëndron te përvoja, ndjenja, mësimi aktiv, praktik, bashkëpunues, dhe në instalimin e vlerave etike, morale dhe sociale. Vlerat si ndershmëria, përgjegjësia, bashkëpunimi, empatia, toleranca, respekti mësohen përmes praktikës dhe ndërveprimit, jo përmes përkufizimeve të thata. Përmes këtij planprogrami nuk mund të ndikohet në kultivimin e karakterit, integritetit dhe përgjegjësisë shoqërore të nxënësve. Do të thotë që kemi të bëjmë me një

Vendosja e edukimit mbi vlerat si prioritet në zhvillimin e kurrikulës hedh themelet për një shoqëri më të ndjeshme, më empatike, më të drejtë dhe më harmonike, ku individët lulëzojnë si liderë etikë dhe kontribuues aktivë për të mirën e përbashkët

mospërputhshmëri të madhe mes asaj çka kanë nevojë fëmijët dhe asaj çka iu ofrohet atyre.

Me zhvillimin e një kurrikule që ka bazë vlerat, institucionet arsimore mund të formojnë një brez qytetarësh moralisht të ndërgjegjshëm, të pajisur me aftësitë e nevojshme për përmbushje personale dhe përparim shoqëror. Nëpërmjet përpjekjeve të përbashkëta të prindërve, edukatorëve, politikëbërësve, përpiluesve të kurrikulave, mediave dhe aktorëve të tjerë, mund të identifikohet një grup vlerash me zbatim universal, të cilat integrohen në mënyrë të natyrshme në lëndë dhe nivele të ndryshme shkollore.⁸

Nxënësi është një person i tërë, i shtyrë nga impulse njohëse, emocionale dhe shoqërore – jo si veçori të ndara, por në një lidhje të pandashme me njëra-tjetrën. Një pedagogji që injoron këtë lidhje gjithëpërfshirëse është e destinuar të dështojë.⁹ Prandaj përmes qasjes holistike, institucionet edukativo-arsimore riafirmojnë përkushtimin e tyre për zhvillim tërësor, duke i përgatitur nxënësit jo vetëm për aftësim akademik, por edhe për qytetari të përgjegjshme dhe pjesëmarrje kuptimplotë në një shoqëri të globalizuar.¹⁰

Vendosja e edukimit mbi vlerat si prioritet në zhvillimin e kurrikulës hedh themelet për një shoqëri më të ndjeshme, më empatike, më të drejtë dhe më harmonike, ku individët lulëzojnë si liderë etikë dhe kontribuues aktivë për të mirën e përbashkët.

- 1 John Scott, Gordon Marshall, *Oxford Dictionary of Sociology*, (Oxford: University Press, 2005), 179.
- 2 Yusuf Cice, Hasib Özkan, Degerler Eğitimi Uygulamalarının Değerlendirilmesi ve Geliştirilmesine İlişkin Okul Çalışma Ekibinin Görüşleri [Mendimet e Ekipit të Punës së Shkollës mbi Vlerësimin dhe Zhvillimin e Praktikave të Edukimit Vleror], *Ekev Akademi Dergisi*, 21, Nr: 70, 2017, 102-103.
- 3 Rashmi Pandey, Integrating Value Education into Curriculum Development: A Comprehensive Approach, *OmniScience: A Multi-disciplinary Journal*, 14, Nr. 2, 2024, 14.
- 4 Wohabie Birhan, et. al., Exploring the Context of Teaching Character Education to Children in Preprimary and Primary Schools, *Social Sciences & Humanities Open*, 4, 2021, 2.
- 5 Rashmi Pandey, po aty, 14-15.
- 6 Wohabie Birhan, po aty, 2.
- 7 <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2770>
- 8 Pandey, po aty, 19.
- 9 Terence Lovat, et. al, The Impact of Values Education on School Ambience and Academic Diligence, *International Journal of Educational Research*, 50, Nr. 3, 2011, 166-170.
- 10 Pandey, po aty, 19.

Edukimi i fëmijëve në mes të familjes dhe shkollës – nevoja për një modelim të integruar

Prof. ass. dr. Ferdi Kamberi

Familja dhe shkolla janë dy shtyllat kryesore të socializimit. Familja është baza e parë e formimit, ndërsa shkolla hapësira ku fëmija ndërton dije, kulturë dhe marrëdhënie shoqërore. Në shekullin XXI edukimi është kthyer në një çështje globale, për shkak të ndryshimeve në rolët familjare dhe ndikimeve të shumta që formësojnë gjeneratat e reja.

P prej agjenseve kryesore të socializimit padyshim se janë familja dhe shkolla. Përderisa, familja është koncepti kryesor pa të cilin nuk mund të ekzistojë shoqëria, ajo njëkohësisht është edhe themeli dhe bazamenti i shoqërisë. Në anën tjetër, shkolla, konsiderohet si agjens i dytë i socializimit, pasi që fëmija aty i merr hapat e jetës menjëherë pas familjes, konkretisht përmes edukimit, ambientit social, botëkuptimit kulturor, zhvillimit dhe mendimit kritik, si dhe ngritjes së personalitetit. Edukimi i fëmijëve në shekullin XXI është bërë një ndër çështjet e diskutimit anëmbanë botës, për shkak edhe të ndikimit të një mori faktorëve, si dhe ndryshimeve dhe roleve në familje. Sido që të jetë, kur flitet për edukimin në përgjithësi, me të nënkuptohet si një proces që fillon që në lindje dhe vazhdon deri në fund të jetës. Faza e hershme e jetës “është shumë e rëndësishme pasi kjo periudhë ndikon në procesin pasues. Megjithatë, ne nuk jemi në gjendje ta kontrollojmë plotësisht fazën e hershme, sepse fëmijët mbeten nën kujdesin e familjeve të tyre derisa të fillojnë të ndjekin shkollën. Edhe nëse fëmijët studiojnë në shkolla, shumë faktorë, siç janë: miqtë brenda dhe jashtë shkollës, ndikojnë në procesin e tyre arsimor (edukues)”¹ Edukimi në fakt fillon në familje dhe vazhdon me shkollën. Familja për sociologët shihet “si një

institucion qendror shoqëror në shoqëri. Institucionet shoqërore janë sisteme të vogla të sjelljes shoqërore me një qëllim të njohur të rrënjësuar në një sistem vlerash relativisht të qëndrueshëm”.² Ndërsa, sipas ligjit për familjen “familja është bashkësi vitale e prindërve dhe fëmijëve të tyre si dhe personave tjerë në gjini. Familja është bërthamë natyrore dhe themelore e shoqërisë dhe si e tillë gëzon të drejtën në mbrojtje”.³ Kështu, funksionet e familjes mund të zbërthehen në: funksionin biologjik, social, kulturor, funksionin mbrojtës, funksionin e mirërritjes, funksionin argëtues, si dhe funksione të tjera, me të cilat shquhet familja. Sot, në përgjithësi familja ka evoluar dukshëm në raport me të kaluarën, përderisa familja shqiptare është shquar nga një model ‘patriarkal’ kryesisht i dominuar nga burri, pasi që burri është konsideruar si i ‘zoti i shtëpisë’ dhe gruaja e ‘zonja e shtëpisë’, sot si duket ky rol ka ndryshuar dhe familja shqiptare është duke u transformuar në modelin e një ‘familje egalitare’. Kjo nënkupton se me familjen egalitare, barazia në mes të burrit dhe gruaje është në një nivel të lartë, të dy kujdesen për mirërritjen e fëmijëve dhe plotësimin e nevojave që dalin nga familja. Krahas ndryshimeve në strukturën dhe llojin e familjes, ka ndryshuar edhe botëkuptimi i shkollës. Përderisa, në të kaluarën shkolla ka qenë simbol i dijes, shkencës dhe zgjimit nga

errësira në dritë, sot si duket botëkuptimi i shkollës është shndërruar në një mjedis jo edhe aq social dhe i dijes. Kjo pasi, shpërfaqja e një mori dukurive negative, në një ose tjetrën mënyrë ka humb atë sensin e dikurshëm të ‘tempullit të dijes’. Po ashtu, edukimi tani më nuk është sikurse më parë, një gjë e tillë vërehet dukshëm nga kurrikulat shkollore, të cilat shpeshherë janë të mbushura me stereotipa gjinore, po ashtu edhe përmes metodologjisë bashkëkohore, e cila si duket nuk po del se është instrumenti i duhur për gjeneratat e reja. Studimet tregojnë se dallimet në mes të gjeneratave janë të mëdha dhe sipas kohës kanë ndryshuar edhe botëkuptimet kulturore dhe sociale. Shumica e klasifikimeve gjeneracionale janë konstrukte sociale, megjithatë, Qendra Kërkimore Pew (konteksti i SHBA-së) ka dalë me disa grupe të gjeneratave, si vijon:

- Gjenerata e heshtur: Të lindur 1928-1945 (73-90 vjeç) të njohur si Tradicionalistë;
- Baby Boomers: Të lindur 1946-1964 (54-72 vjeç);

Mungesa e përgatitjes së prindërve, monitorimit në shkolla dhe komunikimit prind-fëmijë e bëjnë edukimin e fëmijëve sot më të vështirë dhe ndikojnë në zhvillimin e tyre.

- Gjenerata X: Të lindur 1965-1980 (38-53 vjeç);
- Mijëvjeçarët: Të lindur 1981-1996 (22-37 vjeç) – të njohur si Gjenerata Y;
- Post-Mijëvjeçarët: Të lindur 1997-tani (0-21 vjeç) – të njohur si Gjenerata Z”⁴

Këto grupime të gjeneratave tregojnë për dallimet në mes tyre si për nga aspekti i edukimit, po ashtu edhe për aspekte të tjera sociale. Ndoshta ka të drejt Orwell kur thotë se çdo brez e imagjnon veten më inteligjent se ai që i parapriu dhe më i mençur se ai që vjen pas tij...!

NDRYSHIMET E ZHVILLIMET SOCIALE DHE NDIKIMI I FAKTORËVE

Sot, edukimi i fëmijëve është bërë goxha i vështirë dhe kompleks, njashtu edhe ai në shkollë dhe kjo për disa arsye: së pari, edukimi i prindërve para se fëmijët të vijnë në këtë botë, kjo ka një kuptim të gjerë, pasi që edukimi i prindërve apriori nënkupton edhe marrjen e përgjegjësi dhe përmbushjen e detyrave në raport me fëmijët. Shembull, në shtetin e Malajzisë, të rinjtë para martesës





përfundojnë një kurs një vjeçar rreth obligimeve dhe detyrimeve në martesë, në mënyrë që familja të ketë qëndrueshmëri dhe mos të vije deri te divorci. Së dyti, mungon përgjegjësia dhe monitorimi i prindërve në raport me fëmijët e tyre në shkollë. Sot jemi dëshmitarë të asaj që prindërit shumë pak kohë kalojnë në monitorimin e fëmijëve në shkollë dhe shpeshherë nuk janë në dijeni edhe për aktivitetet e tyre në shkollë. Së treti, mungesa e komunikimit në raport prindër – fëmijë, sot vërehet dukshëm mungesa e një komunikimi brenda familjes, sidomos në raport në mes të prindërve dhe fëmijëve. Në fakt, “angazhimi familjar ka shumë ndikim te nxënësit dhe familjet e tyre. Ai është gjithashtu një faktor kritik në përmirësimin e performancës në shkollë. Notat dhe rezultatet më të larta të testeve, pjesëmarrja dhe qëndrimet ndaj shkollës ndikojnë ndjeshëm në standardet dhe suksesin e planeve të përmirësimit të rezultateve në shkollë”.⁵ Fëmijët kanë nevojë për edukimin në familje dhe në shkollë, pasi kjo ndikon në zhvillimin e tyre psikofizik, social dhe emocional. Studimet tregojnë se “zhvillimi i hershëm i fëmijës përfshin zhvillimin fizik, socio-emocional, kognitiv dhe motorik nga moshë 8-0 vjeç. Vitet e para të jetës janë kritike, sepse kjo është koha gjatë të cilës truri zhvillohet me një shpejtësi shumë të madhe duke pasur një kapacitet të lartë për ndryshim. Në këtë moshë vendosen themelet e krijimit të personalitetit, të personit/individit, pastaj krijimin e identitetit të vet personal, ngritjen e vetëbesimit, fillimin e zhvillimit të njohurive dhe shkathtësive. Duke iu referuar raportit të fundit të PISA-s, fëmijët e moshës 15 vjeçare, të cilët kanë pasur sukses në këtë test, kanë marrë pjesë në edukimin e hershëm të institucionalizuar”.⁶ Një çështje tjetër është edhe mungesa e modelit në edukim, në veçanti në shkollë, pasi që ndryshimi i modeleve kurrikulare

të shpeshta si duket ka shpërfaq jo qëndrueshmëri për një modelim unik. Shembull gjatë zhvillimit të bisedave/*oral history* me gjeneratat më të vjetra, kur janë pyetur rreth Abetares klasike dhe Abetares bashkëkohore, pjesa më e madhe e tyre kanë theksuar se: “Abetarja klasike ka qenë e thjeshtë, me një gjuhë standarde dhe të qartë, ku përmes figurave dhe rrokjeve në lexim, mësimi dhe kuptimi kanë qenë më të lehta, përderisa abetarja e re si duket është goxha e ngarkuar”.⁷

Po ashtu, një pjesë goxha e madhe e teksteve në ciklin e ulët janë të ngarkuara dhe abstrakte, një pjesë tjetër e mbushur me stereotipa gjinorë, madje në disa raste edhe mungesë e fakteve, gjë që krijon paqartësi të mëdha te nxënësit, sidomos në moshat e hershme. Një faktor tjetër po aq i rëndësishëm është edhe ndikimi i teknologjisë informative, sidomos i rrjeteve sociale, të cilat janë duke ndikuar dukshëm te fëmijët. Moshë minimale për hapjen e një llogarie në rrjetet sociale është 13 vjeç dhe në shoqërinë shqiptare ky standard nuk aplikohet fare, ku pasojat janë të mëdha si në aspektin e sjelljes sociale në familje dhe komunitet, po ashtu edhe në performancën akademike. Lidhur me këtë, në një studim të realizuar nga *Save the Children* del se “fëmijët në Kosovë kanë thënë se bullizimi kryesisht ndodh në rrjetet sociale dhe në shkollë, sipas një ankete të realizuar nga organizata për të drejtat e fëmijëve, *Save the Children* Kosova. Sipas anketës, Zërat e Rinj, 78% e fëmijëve thanë se bullizimi është shumë ose mesatarisht i pranishëm në shkollën e tyre. E njëjta përqindje vlen edhe për TikTok-un, pasuar nga rrjeti tjetër social Snapchat me 57%. Të anketuarit po ashtu kanë thënë se bullizim ndodh edhe në Instagram (45%) dhe Facebook (28%) si hapësira ku bullizimi ndodh shpesh apo gjithmonë. Anketa është realizuar në periudhën maj-qershor 2024 dhe në të kanë marrë pjesë 1.071 fëmijë në 16 komuna të Kosovës”.⁸ Prandaj, ky studim pasqyron më së miri realitetin tonë.

EDUKIMI I FËMIJËVE NË MES TË SHKOLLËS DHE FAMILJES – NEVOJA PËR NJË MODELIM TË INTEGRUAR

Në një kohë kur fëmijët tanë jetojnë në dy botë të ndara – botën formale të shkollës dhe botën intime të familjes – ne po krijojmë pa dashje një lloj “*skizofrenie edukative*”, të cilët sociologët po e analizojnë me kujdes. Kjo pasi që, mëngjesi fillon me rregullat e shtëpisë, dita vazhdon me protokollet e shkollës, dhe pasdite fëmijët kthehen sërish në një realitet krejtësisht tjetër. Ky fragmentim po ndikon thellësisht në zhvillimin e fëmijëve tanë. Sot, jemi dëshmitarë të asaj që shkollë sot funksionon si një ‘ishull’ i izoluar nga jeta familjare. Prindërit dinë pak për metodat që përdoren në klasë, ndërsa pedagogët kanë njohuri të limituara për dinamikën familjare të secilit fëmijë. Kjo shpesh krijon

tensione që fëmija i përjeton çdo ditë: vlerat që mësohen në shtëpi mund të jenë në konflikt me ato që promovohen në shkollë dhe anashjelltas. Mungesa e psikologëve, sociologëve dhe punëtorëve social në shkolla, pastaj mungesa e komunikimit pedagogë – prindër janë ndoshta prej faktorëve të shpërfaqjes së konflikteve apo tensioneve të cilat sot i përjetojnë fëmijët. Në fakt, “familja dhe shkolla janë fusha trajnimi, vende të socializimit të zakonshëm dhe parimeve shoqërore që lehtësojnë integrimin aktiv të anëtarëve më të rinj të shoqërisë. Në këtë rast, të dy institucionet përmbushin një rol jetësor. Historikisht, shkolla shfaqet si një institucion që punon së bashku me familjen, pasi plotëson detyrën e edukimit të nxënësve të saj për jetën. Familja dhe shkolla ndajnë përgjegjësinë e edukimit, por të kesh një detyrë të tillë të përbashkët sjell edhe implikime që ndikojnë, dhe ndonjëherë, përfitojnë, në një marrëdhënie të tillë”.⁹ Në këtë segment, sociologët sugjerojnë modelin e ‘Edukimit të Vazhdueshëm të Integruar’ – një model ku shkolla dhe familja funksionojnë si një ekosistem i vetëm edukativ. Ky model fokusohet në modelin e ‘Shtëpisë së Të Mësuarit’ – ku në vend që të mendojmë për shkollën dhe shtëpinë si hapësira të ndara, le t’i konceptojmë të dyja këto si dhoma të ndryshme të së njëjtës shtëpie të madhe të të mësuarit. Ky model ka dy çështje kryesore:

- Dhomen e reflektimit (shtëpia) - ku njohuritë e fituara gjatë ditës përpunohen, diskutohen dhe lidhen me përvojat personale dhe vlerat familjare.
- Dhoma e zbulimit (shkolla) - është vendi ku fëmijët eksplorojnë ide të reja, eksperimentojnë, ndërtojnë njohuri formale dhe përgatiten për jetë.

Të dy këto dhoma janë të ndërlidhura me njëra – tjetrën dhe si model janë model i integruar për edukimin e fëmijëve nga perspektiva e dy agjenseve të socializimit. Në një perspektivë bashkëpunuese të marrëdhënies shkollë-familje, Christenson & Sheridan (2001) rekomandojnë përqendrimin në katër aspekte: 1) një qasje që i jep rëndësi roleve të aktorëve kryesorë dhe 2) qëndrimeve pozitive ndaj ndryshimit. 3) një atmosferë mikpritëse dhe respektuese dhe 4) veprimeve që realizohen duke lehtësuar aktivitetet (Deslandes, 2010). Në mënyrë që marrëdhëniet shkollë-familje të jenë bashkëpunuese, ato duhet t’u përgjigjen nevojave të familjeve për informacion, mbështetje dhe trajnim, si dhe të marrin në konsideratë ndryshimet e tyre socio-ekonomike, sociale dhe ndryshimet rreth diversitetit të tyre”.¹⁰

Kur shkolla dhe familja funksionojnë si një sistem i vetëm, fëmijët zhvillojnë një identitet më të qëndrueshëm dhe të integruar. Ata nuk ndjejnë më se duhet të ‘ndryshojnë maska’ kur kalojnë nga një mjedis në tjetrin.

ORIENTIMET DREJT MODELIT TË INTEGRUAR – ÇFARË DUHET BËRË DHE SI?

Duhet theksuar se kur shkolla dhe familja funksionojnë si një sistem i vetëm, fëmijët zhvillojnë një identitet më të qëndrueshëm dhe të integruar. Ata nuk ndjejnë më se duhet të ‘ndryshojnë maska’ kur kalojnë nga një mjedis në tjetrin. Kjo sjell: a) sigurinë emocionale, b) mësimin më të thellë, c) zhvillimin e vlerave të qëndrueshme. Vlerat familjare dhe shkollore nuk janë më në konflikt, por përforcojnë njëra-tjetrën. Implementimi i këtij modeli kërkon një ndryshim paradigme. Mësuesit duhet të trajnohen jo vetëm si ekspertë të lëndës, por si pjesë të një ekipi më të gjerë edukativ që përfshin edhe prindërit. Nga ana tjetër, prindërit duhet të kuptojnë se roli i tyre nuk është thjesht ‘mbështetës i detyrës së shtëpisë’, por bashkëpunëtor aktiv

në procesin edukativ. Në fakt, ekzistojnë një mori të modeleve të integruara, të cilat luajnë rol me rëndësi në bashkëpunimin në mes të prindërve dhe shkollës, respektivisht pedagogëve në shkolla. Në figurën 1, që vijon më poshtë, është paraqitur një model i tillë, si vijon:

Në këtë proces modelimi, nuk bëhet fjalë për një listë të plotë faktorësh dhe procesesh. Po ashtu, modeli nuk duhet të shihet si përfundimtar, por si një model në zhvillim e sipër, që nëse dëshirohet, mund të ofrojë një sfond për bashkëpunimin shkollë-familje. Figura paraqet ndërveprimin ndërmjet faktorëve të familjes dhe shkollës me qëllim të modelit të integruar. Në anën e majtë janë kategoritë e faktorëve, përkatësisht ata që lidhen me familjet dhe shkollën dhe faktorët personalë që lidhen me të rinjtë. Në anën e djathtë të modelit janë dy grupet e procesit për përfshirjen e prindërve në shtëpi dhe në shkollë dhe promovimin e përfshirjes së prindërve nga mësuesi dhe shkolla. Në varësi të natyrës së tyre, faktorët e treguar në të majtë të diagramit do të lehtësojnë ose pengojnë përfshirjen e prindërve dhe të mësuesve në zhvillimin e bashkëpunimit shkollë-familje.¹² Për të siguruar që përfshirja e familjes të jetë e integruar në të gjitha sistemet dhe programet e arsimit të hershëm të fëmijërisë, ofruesit e arsimit joformal dhe shkollat mund të përfshijnë familjet si partnerë thelbësorë, ndërkohë që ofrojnë shërbime që inkurajojnë të nxënëit e fëmijëve dhe ushqejnë marrëdhënie pozitive midis familjeve dhe shkollave. Shpjegimi i prindërve për procesin nëpër të cilin kalojnë fëmijët kur mësojnë koncepte të reja dhe zhvillojnë aftësi, si dhe përfaqësimi i procesit të vlerësimit, krijojnë një themel transparent dhe të sigurt.¹³ Po ashtu, “përmbledhjet kryesore të hulumtimeve na tregojnë se: fëmijët, prindërit e të cilëve




Figura 1. Modeli integrativ i faktorëve dhe proceseve të lidhura me përfshirjen e prindërve dhe bashkëpunimin shkollë-familje.¹¹

janë aktivë dhe të interesuar në procesin arsimor që po kalojnë, bëjnë përparim të dukshëm që nga vitet e tyre të para në shkollë. Në të njëjtën kohë, fëmijët, prindërit e të cilëve janë të përfshirë në partneritet me shkollën, kanë tendencë të arrijnë rezultatet më të mira në të nxënë dhe gjithashtu kanë më pak probleme sjelljeje”.¹⁴ Kësisoj, studimet nënvizojnë se marrë parasysh erërat e globalizmit, të cilat kanë ndikuar në ndryshime dhe zhvillimet sociale, parnteriteti duhet fokusuar në: marrjen e informacionit të saktë dhe të përditësuar të kontaktit nga ana e prindërve, gjetjen e kanaleve të komunikimit që funksionojnë, shembull përmes komunikimit në telefon apo edhe me sms, pastaj krijimin e një plani të veprimi nga shkolla, në të cilin angazhohet familja, shfrytëzimi i teknologjisë informative për të mirën kolektive, përvojat e nxënësve në qendër, ndërtimi i besimit, komunikimi pozitiv dhe inkurajimi, vendosja e komunikimeve të barabarta në mes të prindërve dhe shkollës, dhe thjeshtësimi i qasjes së familjes në informacion për fëmijët e tyre.¹⁵ Fëmijët tanë meritojnë një botë ku edukimi nuk është i fragmentuar, por i integruar – ku çdo hap që hedhin është i mbështetur nga një rrjet i fuqishëm bashkëpunimi mes të gjitha forcave që duan t’i ndihmojnë që ata/ato të rriten. Në përgjithësi duhet nënvizuar se koha është që të hapim dyert

mes këtyre botëve dhe të krijojmë një shtëpi të vetme, të madhe të të mësuarit – për të mirën e fëmijëve tanë dhe të ardhmes së tyre.

1 Arslan, Hasan: “*Fundamental concepts of education - An Introduction to Education*”, Cambridge Scholars Publishing, London, 2018, fq. 9.

2 Amy E. Traver: “*Sociology of the Family*”, City University of New York (CUNY), 2022, fq. 2-3.

3 Ligji Nr. 2004/32 Ligji për Familjen i Kosovës, neni 2.

4 Actuarial society shih: <https://www.actuarialsociety.org.za/wp-content/uploads/2018/11/DIVERSITY-AND-INCLUSION-MULTI-GENERATIONAL-Nene-Molefi.pdf>

5 Powerschool: “*Guide to Family-School Partnerships*”, Powerschool, Parkshore, 2025, fq. 11.

6 FES: “*Pse edukimi i hershëm është zgjidhja?*”, FES, Prishtinë, 2020, fq. 12.

7 Intervistë (oral history) me z. Sh. G (ish arsimtar). Intervista është realizuar enkas për këtë artikull me datë 19 Korrik, 2025

8 REL: “*Save the Children: TikTok-u hapësira ku bullizohen më së shumti fëmijët në Kosovë*”, REL, 20 nëntor 2024, shih: <https://www.evropaelire.org/a/save-the-children-rrjetet-sociale-bullizim-femijet-kosove-/33209542.html>

9 Iván Acero Moreno, at al. “*Integrating family and school, a challenge to accomplish*”, RICS Revista Iberoamericana de las Ciencias Sociales y Humanísticas 4(8), fq. 396.

10 Deslandes, Rollande: “*A framework for school-family collaboration integrating some relevant factors and processes*”, Université du Québec à Trois-Rivières – Canadà, Volumen 48, número 1, enero-marzo, 2019, fq. 11-18.

11 Deslandes, Rollande: “*A framework for school-family collaboration integrating some relevant factors and processes*”, Université du Québec à Trois-Rivières – Canadà, Volumen 48, número 1, enero-marzo, 2019, fq. 11-18.

12 Po aty.

13 Shih: Kinderpedia: <https://www.kinderpedia.co/en/school-and-nurseries-resources/blog/family-engagement-in-education/family-role-in-child-education>

14 Po aty.

15 Powerschool: “*Guide to Family-School Partnerships*”, Powerschool, Parkshore, 2025, fq. 11.

Shkolla, dija dhe vlerat e tyre

Imer Topanica

Grekët e hershëm, por edhe romakët, dijen e cilësonin si privilegj të filozofëve. Këtë standard e trashëgoi mesjeta e udhëhequr nga paria kishtare, por qytetërimi islam, kërkimin e dijes e ngriti në një nivel sakral për çdonjërin. Kjo qasje krejt e ndryshme me oksidentin, e ndihmoi këtë të fundit t'i nxirrte këmbët nga errësira. Që atëherë, dija mbeti një forcë udhëheqëse e shoqërive në zhvillim.


Prej antikës e deri më sot, relacioni i shkollës me dijen, ka mbetur i thjeshtë: ajo është institucioni që e formalizon kërkimin e saj, për të gjithë, pa dallim. Ndonëse ndodhet në krizë, për arsye të hovit të madh teknologjik, përkatësisht rrugëve joformale që i ofron ky kontekst, në shumë vende të

zhvilluara, në sistemet e tyre arsimore, zë vend qendror. Vetëm nëpërmjet ekzistencës së këtij zinxhiri institucional, masat mund ta kuptojnë se çka janë vlerat dhe pse duhet t'i kultivojnë ato.

VLERA E DIJES NË MENDIMIN FILOZOFIK GREKO-ROMAK

Rrëfimi i hershëm i Platonit për shpellën (427 - 347 p.e.s.), na mëson se edhe në antikë, dija cilësohej si një instrument që ta siguron shtegun drejt dritës, dijes, pra, shpëtimit. Te "Republika", Platoni e ilustron në mënyrë alegorike se si njerëzit mund të çlirohen nga "tiranja" e errësirës, përkatësisht paditurisë, vetëm nëpërmjet kësaj rruge. Ai dhe shumë filozofë të tjerë të antikitetit e konceptuan atë

“Qëllimi i edukimit është të krijojë njerëz që janë të aftë të gjykojnë drejt dhe të veprojnë me ndershmëri.”



si mjet të emancipimit personal dhe qytetar. Për këtë ai thoshte se: “Qëllimi i edukimit është të krijojë njerëz që janë të aftë të gjykojnë drejt dhe të veprojnë me ndershmëri.”

Së këndejmi, sintagma se “vetëm njeriu i ditur, është i lirë”, u ngulit thellë në këtë shoqëri, duke i vënë themelet e atij që sot njihet si Qytetërimi Perëndimor. Duke u përvijuar nëpër kohë e epoka që shënjuan shekujt e hershëm, ndërsa hasim në referenca që e argumentojnë atë që sapo e thamë, kuptojmë ndër të tjera se sa rëndësi i jepnin popujt e hershëm kërkimit të dijes.

Një takim që ka mbetur në kujtesën e njerëzimit, e që prej të cilit mësojmë se dija konceptohej si parakusht për të qenë i lirë, është edhe ai ndërmjet Aleksandrit të Madh dhe Diogjenit të Sopës. Një herë thuhet se Aleksandri shkoi ta takonte filozofin endacak që shquhej për mprehtësinë dhe cinizmin e tij, dhe e gjeti duke u ngrohur në diell. Aleksandri e pyeti nëse mund të bënte diçka për të, dhe ai, siç rrëfëhet iu përgjigj ashtu me mospërfillje: “Po! Largohu se m’i ke zënë rrezet e diellit!” Kjo përgjigje antologjike është interpretuar përherë si një qëndrim i njeriut të ditur që në vetvete është i lirë.

INDUSTRIA E SHKOLLIMI NË QYTETËRIMIN ISLAM

Besojmë se të drejtat dhe liritë fundamentale, si ajo për të jetuar i lirë, për t’u shprehur, lëvizur, arsimuar etj., burojnë nga vetë gjiri i qytetërimit islam. Kjo sepse, fjala e parë e shpalljes hyjnore ishte “Lexo!”, thirrje universale për ngritje intelektuale, reflektim dhe zhvillim mendor, që iu adresua mbarë njerëzimit nga Zoti i Madhërishëm, pa dallim gjinie, race e moshe.

Pikërisht kjo premisë motivuese që nxiste dhe ngjallte kërsëri te çdo mendje e shëndosh në shoqëritë e hershme islame, i fali historisë së njerëzimit shembuj të papërsëritshëm. Gjatë “Epokës së Artë” të Islamit (shekujt VIII – XIII), qytetet si: Bagdadi, Kordoba dhe Kajro, u bënë qendra botërore të dijes. Në këto vende lulëzoi jo vetëm shkenca fetare, por edhe ajo natyrore dhe humane. Por si u arrit deri këtu? Kësaj pyetje i përgjigjemi sapo ta mësojmë se çfarë peshe dhe kuptimi i epn in këto shoqëri arsimimit.

Për Al Ghazalin, dija ishte “dritë që ndriçon shpirtin”, duke shkuar më tej në shtjellimin e konceptit dhe duke e bërë ndarjen ndërmjet asaj që ishte e dobishme dhe asaj të padobishme. Kësisoj ai i dha dijes një dimension moral. Ibën

Glorifikimi i shkollave fetare katolike është bërë duke i veshur ato me petkun kombëtar, ndërsa fshirja e dëshmimeve për mesxhidet, mejtepet dhe medresetë ku u rritën dhe u edukuan patriotët shqiptarë myslimanë, vijojnë të frymëzohen nga qarqe thellësisht antikombëtare.

Halduni në veprën e tij kapitale “Muqaddimah” analizon rolin e arsimit në ngritjen dhe rënien e qytetërimeve. Ai e shihte dijen si themel të zhvillimit kolektiv.

E thamë edhe më sipër, në shoqëritë e hershme islamike, ky nuk ishte privilegj vetëm i burrave, por edhe i grave, diçka që shoqëritë perëndimore nuk arritën ta artikulonin deri në shekujt e vonë. Nxënia e dijes niste në moshë të hershme. Teologjia, mjekësia, astronomia, logjika, letërsia dhe filozofia, filluan të mësoheshin në mënyrë metodologjike dhe sistematike nëpër xhami, mejtepe e medrese.

Dija mori përmasa të trashëgimisë ndërmjet brezash. Komentimi i veprave dhe të arriturave shkencore, kapërceu arealin islamik, duke u shtrirë edhe në arritjet e civilizimeve të tjera. Figura markante të asaj që njihet si epoka e artë islamike, kërkuan dhe analizuan edhe veprat kapitale të popujve dhe civilizimeve të tjera. Herë-herë u nxitën debate, interpretime të ndryshme, e shpesh përjashtime e denoncime ndërmjet individëve dhe grupeve të ndryshme, por kjo e pasuroi për një kohë të gjatë diskursin për dijen. Në fund të fundit, atij që i vishej epiteti i ditur, kjo nënkuptonte që ai ishte më pranë njohjes së Vërtetës Përfundimtare, pra Zotit.

Të tillët, linin gjurmë, komentoheshin dhe dija dhe përvoja e tyre bartej brez pas brezi. Kujtojmë se si Ibën Sina (Avicena), arriti ta zbërthej një enigmë aristoteliane tek kur u mbështet në një koment të paraardhësit të tij. Ai e kuptoi logjikën e Aristotelit vetëm pasi lexoi një koment të shkurtër nga Al Farabi. Ky moment tregon se dija është një zinxhir i ndërtuar nga breza dijetarësh, burim i ndriçimit të vazhdueshëm.

KONTEKSTI ISLAMIK SHQIPTAR

Në historiografinë shqipe ende mbizotëron narracioni se Perandoria Osmane ishte fajtorja kryesore për ngecjen e shqiptarëve në shumë drejtime. Periudha komuniste ka prodhuar një “seri historianësh”, që të gjitha fajet ia veshin kësaj periudhe, veçmas në aspektin e arsimimit. Por Noel Malcom, Oliver Shchmit, Hasan Kaleshi, Nathalie Clayer e plot studiues të tjerë të respektuar, prej kohësh e kanë dekonstruktuar propagandën e shtresuar nëpër tekstet e historisë. Përkundër kësaj, edhe sot e kësaj dite trumbetojnë idenë se, fjala vjen, në vitin 1584 (shekulli XVI), 29 vjet pas atij që pretendohet të jetë libri i parë në shqip – Meshari i

Gjon Buzukut, u themelua shkolla e parë shqipe.¹ Në të vërtetë, me këtë zhvleftësojnë hiç më pak se sa një shekull trashëgimi shkollorë në hapësirat shqiptare.

Glorifikimi i shkollave fetare katolike është bërë duke i veshur ato me petkun kombëtar, ndërsa fshirja e dëshmimeve për mesxhidet, mejtepet dhe medresetë ku u rritën dhe u edukuan patriotët shqiptarë myslimanë, vijojnë të frymëzohen nga qarqe thellësisht antikombëtare.

Te artikulli “Ardhja e turqve në Ballkan dhe përhapja e Islamit (shkaqet themelore të vazhdimësisë etnike të shqiptarëve)”, Hasan Kaleshi,² vë në dukje ndikimin e madh të sistemit shkollor të kësaj periudhe, në formësimin e elitave intelektuale të kohës. Poetët si Suzi Prizrenasi (1455-1465), Mesihi Prishtinasi (1470-1512), pastaj vezirët e shumtë, duke filluar nga Koxha Davut Pasha (1446-1498), e deri te diplomati dhe patrioti Hasan Prishtina (1873-1933), nuk mund t’i kenë marrë mësimet e para në kisha, manastire e lice katolike.

SHKOLLIMI NË EPOKËN E TEKNOLOGJISË DHE INTELIGJENCËS ARTIFICIALE

Sot jetojmë në një epokë të ngulatur me informacione. Teknologjia, rrjetet sociale dhe inteligjenca artificiale po e ndryshojnë edhe mënyrën si kemi mësuar dhe si i kemi ndërtuar njohuritë. Por, informacioni nuk është automatikisht dije, kjo është e vetëkuptueshme. Zëra profesionistësh theksojnë se sistemet arsimore duhet të përqendrohen jo vetëm në përvetësimin e njohurive teknike, por në zhvillimin e mendimit kritik, etikës dhe pavarësisë intelektuale.

Intenca duhet të mbetet që sistemi të mos prodhojë turmë të nënshtruar ndaj elitave sunduese, por shoqëri të emancipuar, e vetëdijshme dhe e aftë ta orientojë fatin e vetë. Noam Chomsky thotë: “Qëllimi i arsimit është të ndihmojë njeriun të zbulojë se çfarë do të bëjë në vend se të bindet në heshtje!”

Kjo na kthen te pavarësia që gëzon njeriu i ditur, për të cilën na flisnin të urtit që i cituam më sipër. E rendi global, në vend që të thellonte kanalet e kërkimit të dijes dhe fitimit të pavarësisë intelektuale, brezat e rinj, nëpërmjet teknologjisë, i ka kthyer në përthithës të paarsyeshëm të produkteve që plasohen në internet. Video, lojëra, fotografi për mosha të rritura, janë të ekspozuara shpesh, e pa pengesa, edhe për fëmijët e vegjël. Si rrjedhojë, më shumë kemi turma të nënshtruar ndaj “modave” të reja, se sa mendje të kthjellëta që dinë t’i dallojnë vlerat nga antivlerat.

“Rrjetet sociale ua dhanë të drejtën e fjalës edhe budallenjve që dikur i strehonte kafeneja e lagjes!”

Umberto Eco

Kishte të drejtë Umberto Eco kur kritikonte përdorimin sipërfaqësor të teknologjisë tek thoshte: “Rrjetet sociale ua dhanë të drejtën e fjalës edhe budallenjve që dikur i strehonte kafeneja e lagjes!”

Ky pozicionim, nuk është mohimi i teknologjisë, por një thirrje për përgjegjësi dhe etikë në përdorimin e saj. Në pajtim me këndvështrimin e Ecos, por edhe të Chomsky-t, sot, shkolla do të duhej t’i mësonte fëmijët si t’i dallojnë lajmet e rreme, si të kuptojnë botën përtej ekranit dhe si të ndërtojnë vlera njerëzore në një realitet gjithnjë më kompleks.

Për fat të keq, në mjediset tona shkollorë operojnë lirshëm ideologji, agenda e propaganda që godasin në mënyrë sistematike atë që në traditën fetare e kombëtare është parë si vlerë. Nëse dikur vetëm njëri prind ishte konsumatori i vetëm i drejtpërdrejtë i sistemit, ndërsa anëtarët e tjerë ushqeheshin nga veprimtaria e tij, tash edhe fëmijët janë shndërruar në konsumatorë. Për ta arritur këtë stad të kthimit të çdo pjesëtari të familjes në qenie konsumuese, është dashur të sulmohen vlerat që e kanë karakterizuar institucionin e familjes, sepse ndryshe nuk do t’ia kishin dalë mbanë.

PËRFUNDIM

Nga Platoni, te Chomsky, nga Ibën Sina tek Umberto Eco, rrugëtimi i dijes ka qenë dhe mbetet thelbi i emancipimit njerëzor. Shkolla nuk është thjesht një vend për informim, por një tempull i vlerave, arsyes dhe ndërgjegjes. Në një kohë kur inteligjenca artificiale po fiton terren, njeriu ka nevojë më shumë se kurrë për inteligjencë morale dhe shpirtërore. Këtë ia ofron vetëm dija e mirëfilltë e rrënjësuar në virtut dhe reflektim.

Mjafton t’ia hedhim një sy listës së vendeve me sistemet më të avancuara arsimore, për ta kuptuar që arsimimi është një parakusht i rëndësishëm për zhvillim.

Quality Index dhe Opportunity Index të CEOWORLD,³ ose PISA, rendisin përherë shtetet më të zhvilluara në botë në krye të këtyre listave. Ndaj në këto vende, jo vetëm në kampuset universitare, por edhe nëpër parqe, në stacionesh, në trena, tramvaje e autobusë, është më se e zakonshme të shohësh njerëz me libra në duar. E ardhmja përherë iu ka takuar shoqërive të arsimuara.

1 https://sq.wikipedia.org/wiki/Kisha_dhe_shkolla_filllore_n%C3%AB_gjuh%C3%ABn_shqipe

2 https://sq.wikipedia.org/wiki/Hasan_Kaleshi

3 <https://ceoworld.biz/best/>

Intoleranca në ushqim

Agron M. Rexhepi, MD, PhD, MSc, Urata Rexhepi, Nderim Rexhepi

Çdo herë e më shumë po lajmërohen – diagnostikohen sëmundje të reja dhe të panjohura deri më tani. Ndoshta shumë prej tyre kanë rënduar shëndetin e njeriut edhe më parë, por nuk ka pasur mundësi diagnostikimi çfarë ka sot. Por, me siguri të plotë mund të konkludojmë se dita më ditë po lajmërohen edhe shumë gjendje të reja patologjike që mund të vijnë si pasojë e shprehive të këqija, ndotjes së ambientit, mosaktivitetit fizik dhe kequshqyeshmërisë. Kur është fjala te kequshqyeshmëria, kurrë dhe në asnjë drejtim tjetër jetësor nuk janë bërë gabime më të mëdha se sa që janë bërë dhe fatkeqësisht po vazhdon të bëhen në lëmin e të ushqyerit.

Çdo ditë e më shumë, qoftë për shkak të moskujdesit tonë apo faktorit imponues, ne po helmohemi në vazhdimësi me konsumimin e ushqimeve gjenetiksht të modifikuara dhe të intoksikuara me pesticide, herbicide, hormone apo antibiotkë. Me qëllim të përfitimeve material (komercializmit), njeriu po vazhdon, me vetëdije apo pa vetëdije, të kontaminon pothuajse të gjitha llojet e ushqimeve që ne i konsumojmë. Nëse këtij fakti ia shtojmë edhe faktin tjetër se ne për gjithçka mund të gjejmë kohë, por jo edhe për një ushqyeshmëri të shëndetshme, atëherë me plotë të drejtë mund të konstatojmë se problemi i kequshqyeshmërisë dita më ditë po bëhet faktor-lider i prishjes (rrënimit) të mirëqenies sonë bio-psiko-sociale.

Si dhe me çka ushqehemi (në kuptimin cilësor, sasior dhe kohor) pa dyshim se ashtu edhe shëndetin do ta kemi.



Si dhe me çka ushqehemi (në kuptimin cilësor, sasior dhe kohor) pa dyshim se ashtu edhe shëndetin do ta kemi.

Çrregullimet më të shpeshta shëndetësore të traktit (sistemit) tretës të njeriut, pa marrë parasysh moshën dhe gjininë e tij, janë:

- Alergjia në ushqim;
- Intoleranca në ushqim.

Këto dy kuptime (nocione) për shkak të simptomatologjisë (shenjave klinike) të ngjashme mund të ngatërrohen, e që në realitet diametralisht dallohen njëra nga tjetra. Diagnostikimi diferencial (dallimi ndërmjet alergjisë dhe intolerancës në ushqim) bëhet përmes disa procedurave:

- Dieta eliminuese: formë joinvazive diagnostikuese ku nga menyuja ditore në mënyrë selektive largohen ushqimet e dyshimta për të vërtetuar se cili ushqim është shkaktari i problemit. Sipas rezultatit hartohen këshillat adekuate nutritive;

- Analiza e ajrit gjatë ekspiriumit (frymënxjerrjes) bëhet me qëllim të diagnostikimit të ndjeshmërisë (intolerancës) në karbohidrate (laktozë, fruktozë);

- Analizat biokimike: vlerësohet se cili lloj i antitropave (imunoglobulinave) është i rritur (tek alergjia rritet numri i Imunoglobulinave

Personat me alergji duhet gjithmonë të kenë kujdes në ushqim, ndërsa ata me intolerancë – varësisht nga shkalla – mund ta tejkalojnë duke e shmangur përkohësisht ushqimin “problematic” dhe më pas duke e rifutur me kujdes në sasi të vogla.

E, për dallim nga intoleranca në ushqim ku rritet numri i Imunoglobulinave G);

- Koha e lajmërimit të shenjave të para patologjike: tek alergjia mund të lajmërohen menjëherë apo pas një kohe të shkurtër, ndërkaq tek intoleranca shenjat e para mund të lajmërohen pas një kohe të shkurtër deri në disa orë (deri në 72) orë pas marrjes së ushqimit ndaj të cilit organizmi reagon me ndjeshmëri);

- Sasia e ushqimit që e shkakton problemin: tek alergjia sasia shumë e vogël (në gjurmë) e ushqimit mund të provokon reaksione të shumta në organizëm, për dallim nga intoleranca që në sasi të vogël mund të mos lajmërohen shenjat patologjike;

- Reaksionet e organizmit si kundërpërgjigje në rastet e alergjisë në ushqim mund të jenë shumë shqetësuese dhe të rrezikshme për jetë. Ndërkaq, tek intoleranca në ushqim reaksionet e organizmit janë më pak shqetësuese dhe shumë më pak të rrezikshme për jetë krahasuar me rastet e alergjisë në ushqim.

SHENJAT KLINIKE TË INTOLERANCËS NË USHQIM

- Problemet digjестive (ulçera në gojë, fryrje, dhimbje spazmike në formë të therjes



së barkut, sindroma irrituese e zorrëve, thartia, diarreja, kapsllëku);

- Probleme respiratore (rinit, sinusit, faringit, astma, kolli i vazhdueshëm i thatë);

- Probleme të sistemit nervor (anksiozitet, depresion, kokëdhimbje, migrenë, stres i vazhdueshëm);

- Probleme të lëkurës (dermatit, acne, egzemë, urtikari);

- Aritmi kardiake;

- Infeksione renale;

- Lodhje e përgjithshme;

- Dhimbje e nyjetimeve, etj..

USHQIMET QË KONSIDEROHEN SI SHKAKTARË POTENCIAL TË INTOLERANCËS NË USHQIM

Gruri, elbi, thekra, dhe të gjitha derivatet e tyre (mielli, makaronat – pastat, pica, ëmbëlsirat, biskotat, si dhe të gjithë artikujt ushqimor që e kanë të shtuar glutenin), kuskus, niseshte gruri, salcë soje, qumështi i lopës, mishi i procesuar, ushqimet e konservuara, frutat agrume (limoni, portokalli, mandarina) dredhëzat, domatet, qershiat, frutat arnore, perimet, lëngjet e pemëve, çaji, kafeja, vena, disa erëza, brokollit, lakra, vaj liri, kërpudha, shafrani, boronicat, brusnica, alkooli, kafeina, ëmbëltuesit artificial, histamina natyrale, benzoati, acidi salicilik, ushqimet e kontaminuara, konzervansët dhe shtesat artificiale (aditivët) në ushqim;

Përderisa alergjia në ushqim mund të vije si pasojë e provokimit dhe përgjigjes imunologjike, intoleranca mund të vije si pasojë e:

- Deficiencës së enzimave që bëjnë tretjen e plotë të ushqimeve. Absorbimi dhe kalimi në gjak i materieve ushqyese jo të tretura si duhet bënë që të aktivizohen antitrupe mbrojtëse të organizmit (Imunoglobulat G), të cilat, duke dashur të mbrojnë organizmin nga këta “agjentë” shkaktojnë rëndim të shëndetit në forma të ndryshme. Në kushte normale materiet ushqyese të patretura si duhet nuk absorbohen në organizëm por duke dhënë probleme të zorrëve (enterit, colit) nxirren jashtë. Absorbimin e këtyre materieve ushqyese jo të tretura sa duhet e mundëson rritja e lëshueshmërisë absorbuese të organeleve të zorrëve që janë përgjegjëse për absorbimin e materieve ushqyese (villi intestinalis). Ky keqabsorbim mund të bëhet si pasojë e rrezatimit të shtuar, infeksionit të zorrëve, apo përdorimit të “tepruar dhe të pakontrolluar” të antibiotikëve.

Dallimi mes
alergjisë dhe
intolerancës
është thelbësor
për një
ushqyerje të
sigurt dhe
shëndet të
mirë.



- Veprimet farmakokimik: disa substanca si p.sh. histamina, benzoati dhe acidi salicilik gjinden në formë natyrale në disa ushqime (frutat agrume, dredhëza, domate, qershia, frutat arnore, perimet, lëngje të pemëve, çaj, kafe, venë, erëza, etj.), ndjeshmëria ndaj këtyre substancave farmakologjike bënë që të lajmërohen shenjat e intolerancës (tejdjeshmërisë) ndaj frutave që e përmbajnë këtë substancë.

Përderisa personat me allergji duhet që pothuajse gjatë tërë jetës së tyre të kenë kujdes në zgjedhjen e ushqimit, personat me intolerancë në ushqim varësisht nga shkalla e intolerancës, me një abstenim të përkohshëm (disa javë, apo muaj) të ushqimit “problematic” dhe me fillimin e ri-marrjes së tij me kujdes dhe sasi të paktë mund ta tejkalojnë këtë problem.

Referenca:

- Difference in food allergy and intolerance. Qasja në: <https://www.healthnavigator.org.nz/health-a-z/f/food-allergy-or-intolerance/>
- Food problems: Is it an allergy or intolerance. Qasja në: <https://my.clevelandclinic.org/health/diseases/10009-food-problems-is-it-an-allergy-or-intolerance>
- Intoleranca në ushqim. 2016. Qasja në: <https://acibademsistina.mk/health/al/index.php/wellness/ishrana-nitricionizam/454-intoleranca-ne-ushqim.html>
- Introduction to food allergy and intolerance. Qasja në: <https://heas.health.vic.gov.au/early-childhood-services/allergy-and-intolerance>
- Nordqvist, Ch. What is a food intolerance, 2017. Qasja në: <https://www.medicalnewstoday.com/articles/263965.php>

Ndikimi i mendimit orientalist në Perëndim

Abdulvehab el Karesh

Orientalizmi është një rrymë shkencore, intelektuale, politike dhe ekonomike e zhvilluar në Perëndim, që merret me studimin e qytetërimeve të Lindjes, me fetë, kulturat, historinë, gjuhët, letërsinë, zakonet dhe traditat e saj (Lindjes).

Orientalizmi është një rrymë shkencore, intelektuale, politike dhe ekonomike e zhvilluar në Perëndim, që merret me studimin e qytetërimeve të Lindjes, me fetë, kulturat, historinë, gjuhët, letërsinë, zakonet dhe traditat e saj (Lindjes). Përpiqet të njihet me gjithçka që lidhet me Lindjen, veçanërisht me botën islame.

Lëvizja e orientalizmit pati efekte pozitive nga njëra anë dhe efekte negative nga ana tjetër. Dijetarët tanë kanë shtjelluar efektet negative të orientalizmit dhe i kanë përmbledhur në disa pika si: vënia në dyshim e shpalljes hyjnore, sfidimi i Sheriatit dhe vërtetësisë së jurisprudencës islame, me pretendimin e tyre se origjina e tij është

romake, si dhe ringjallja e grindjeve kombëtare me qëllim të shkatërrimit të ymetit.

Efektet pozitive të orientalizmit – për fat të keq – nuk janë studiuar dhe janë lënë pas dore nga prizmi islam. Ne kemi qenë të preokupuar me ndikimin e orientalizmit në mendimin islam, i cili paraqet një çështje të rëndësishme dhe të rrezikshme, dhe, ne nuk ishim të interesuar ta dinim efektin e tij në mendimin perëndimor, i cili është i dobishëm dhe pozitiv në disa aspekte.

Aspekti i parë: Orientalizmi është përgjegjës për transferimin e njohurive islamike dhe orientale në përgjithësi në Perëndim, i cili përfitoi nga këto njohuri. Orientalistët kanë punuar për përkthimin e teksteve themelore



të feve, si dhe, në përkthimin e teksteve shkencore dhe për njerëzit e Lindjes. Ato janë shkencat, të cilat kryesisht ishin bazë e rilindjes shkencore në Perëndim. Kjo do të thotë se orientalizmi është përgjegjës për rilindjen shkencore të Perëndimit. Ai e ka kontributin e tij për përparimin e shkencës në Perëndim përmes teksteve lindore dhe islame, të cilat ishin përkthyer në gjuhët evropiane para Renesancës. Njohuritë islame, të cilat orientalizmi ia transferoi Perëndimit patën rol të madh në zhvillimin e mendimit perëndimor, dhe madje, edhe në modifikimin e rrugës së tij herë pas here. Veprat shkencore islame, të cilat orientalistët i përkthyen para Renesancës Evropiane, çuan në zhvillimin e shkencës perëndimore dhe futjen e Perëndimit në fazën e rilindjes shkencore dhe përparimit industrial dhe teknologjik, të cilin Perëndimi po e përjeton aktualisht. Këto vepra dëshmojnë më së miri për meritat e myslimanëve mbi Evropën, qytetërimin dhe rilindjen e saj.

Aspekti i dytë: Përkthimet e bëra nga orientalistët ishin për mendimin fetar islam, veçanërisht përkthimi i teksteve të kelamit dhe filozofisë, e sidomos i teksteve me drejtim racional, siç janë: tekstet e mutezilëve, veprat e filozofëve si El Farabi, El Kindi dhe Ibën Sina. Disa nga këto mendime ndikuan në mendimin perëndimor me ndikim të drejtpërdrejtë, siç është Ibën Ruzhdi, për të cilin u themelua një shkollë perëndimore quajtur: *'Shkolla Rashidije'*, dhe pasuesit e saj nga filozofët perëndimorë i përkasin filozofisë dhe metodologjisë së Ibën Ruzhdit. Përveç përfitimit ideologjik në ndërtimin e besimit, në organizimin dhe reformimin e tij, Perëndimi përfitoi nga myslimanët edhe në fushën e kritikës fetare. Kështu, Judaizmi dhe Krishterimi rishqyrton bindjet e tyre në dritën e kritikës islamike ndaj tyre. Reformat fetare ishin refleksione të vërteta ndaj kësaj kritike islamike. Kështu, në judaizëm gjejmë reforma kuranore dhe interaktive, ku reaksionet ortodokse hebraike pasqyrojnë një ndikim të vërtetë islamik. Në krishterim, shfaqja e protestantizmit kundër katolicizmit reflektoi implikime të qarta islamike në klauzolat themelore të reformës.

Përveç gjithë kësaj, lëvizja e kritikës *'Kritika Biblike'* u ngrit nga shumë teori të saj në libra hebrej dhe të krishterë nga kritika kuranore dhe kritika islamike e këtyre librave në veprat e myslimanëve, të cilat i përkthyen orientalistët që nga fillimi në latinisht, e pastaj edhe në gjuhë moderne evropiane. Me theks të veçantë përmendet shkolla e orientalistit gjerman

Orientalistët kanë punuar për përkthimin e teksteve themelore të feve, si dhe, në përkthimin e teksteve shkencore dhe për njerëzit e Lindjes.



Julius Fillhusen, një orientalist i shkëlqyeshëm dhe themelues i lëvizjes *kritika biblike*.

Aspekti i tretë: Orientalizmi është përgjegjës për futjen e temës orientale në letërsinë perëndimore dhe në artet perëndimore. Veprat letrare dhe artistike islamike të përkthyer nga orientalistët në gjuhët evropiane kanë lënë ndikim të qartë te shkrimtarët dhe artistët, të cilët ishin të magjepsur me temat letrare, artistike dhe orientale. Kështu, lëvizja letrare dhe artistike në Perëndim u ngjyrosë me një ngjyrosje orientale, në letërsi dhe art me aspektin e temave dhe me aspektin e formave artistike dhe letrare. Ata bënë sintetizimin e tyre me temat perëndimore në veprat e tyre. Veprat si *"1001 net"* dhe format e tjera të tregimeve popullore orientale, bashkë me tregimet e kafshëve në veprën *"Kelila dhe Dimna"*, patën një efekt të dukshëm në zhvillimin e artit imagjinar dhe narrativ në Perëndim.

Thënë të vërtetën, të gjitha këto efekte që i përmendëm janë të shkurtra. Ato janë rezultat i angazhimit të orientalistëve në përkthimin e veprave të ndryshme islamike, në hulumtimin e tyre dhe përhapjen në mjedisin e tyre. Kjo çështje ju ndihmoi shumë për njohjen e Islamit dhe civilizimit të tij nga njëra anë, si dhe për pasurimin e mendimit perëndimor me kritikën e tij, me reformimin dhe me pajisjen e tij me tema dhe forma të reja letrare dhe artistike, të cilat i kanë bërë të mundur Perëndimit që të zhvillojë dhe pasurojë letërsinë dhe artet e tij.

Përkthim nga arabishtja: Miftar Ajdini

Burimi: <https://islamonline.net/33262>

El Biruni - një studiues i gjithanshëm

Sead Ahmetaj

Në përputhje me natyrshmërinë e Islamit dhe besimit, El Biruni ka arritur një nivel të jashtëzakonshëm shkencor. Islami i jep rëndësi të madhe njeriut dhe shpirtit të tij në të gjitha aspektet, prandaj padyshim se një nga shkencëtarët më të rëndësishëm në historinë islame, në qytetërimin islam dhe botërore është El Biruni. Emri i plotë i të cilit është Ebu Rejhan Muhamed ibën Ahmed el Biruni.

Ebu Rejhan Muhamed ibën Ahmed el Biruni ishte një shkencëtar që dha kontribute të rëndësishme në shumë fusha, duke përfshirë astronominë, matematikën, gjeografinë, fizikën, mjekësinë, farmakologjinë, historinë, gjuhësinë dhe teologjinë. Ai është autor i një totali prej 113 veprash. El Biruni bëri histori si shkencëtari i parë që llogariti perimetrin e Tokës dhe gjithashtu hodhi themelet e farmacisë moderne. Biruni lindi më 4 shtator 973, në Qas (Uzbekistani i sotëm), kryeqyteti i rajonit Khwarezm. Që në moshë të re, ai ishte i interesuar për shkencën, prandaj edhe studioi pranë dijetarëve kryesorë të kohës. Ai mori arsimimin e tij të hershëm nga një dijetar grek. Më vonë, mësuesi i tij i parë ishte matematikani dhe astronomi Khwarezmian, Ebu Nasër Mansur. Mansuri i mësoi Biruniut gjeometrinë euklidiane dhe astronominë ptolemaike. Më vonë ai mori mësim nga figura të tilla si Ibën el Iraku dhe Abdusamed ibën Hakimi. Në moshën 17 vjeçare, ai filloi studimet e tij të para shkencore, duke llogaritur gjatësinë gjeografike të qytetit duke përdorur lartësinë e diellit. Gjatë gjithë jetës së tij, ai udhëtoi në shumë rajone të ndryshme dhe ndërveproi me kultura të ndryshme. Udhëtimi i tij shkencor, i cili filloi në Khwarezm, u shtri në Iran dhe më pas në Xhurxhan për shkak të trazirave politike. Në vitin 1017, kur Mahmud Gazni pushtoi Khwarezmin, ai shkoi në Gazni. Gazni ndodhet brenda kufijve të Afganistanit të sotëm.



STUDIMET DHE ZBULIMET SHKENCORE TË EL BIRUNIT

Si një shkencëtar i gjithanshëm, El Biruni kreu studime të rëndësishme në shumë fusha, duke përfshirë astronominë, matematikën, gjeografinë, fizikën, mjekësinë, historinë dhe filozofinë. Një nga karakteristikat e tij më të rëndësishme ishte rëndësia që ai i kushtonte vëzhgimit dhe metodave eksperimentale në shkencë. Ai jo vetëm që iu afrua njohurive teorikisht, por gjithashtu kërkoi t'i verifikonte ato përmes eksperimenteve dhe vëzhgimeve.

Astronomia

El Biruni arriti famë të madhe me vëzhgimet dhe llogaritjet e tij në astronomi. Ai ishte një nga shkencëtarët e parë që propozoi idenë se Toka rrotullohet rreth boshtit të saj. Ai

llogariti rrezen e Tokës me saktësi të pabesueshme dhe ishte një nga shkencëtarët e parë që sugjeroi mundësinë e rrotullimit të Tokës. Ai gjithashtu mati pjerrësinë e ekliptikës (këndi midis planit të ekliptikës dhe planit të ekuatorit qiellor) me saktësi të jashtëzakonshme. Ai studioi eklipset diellore dhe hënore dhe përcaktoi se baticat detare lidhen me pozicionin e Hënës.

Matematika

Ai kreu punë të rëndësishme në trigonometri dhe propozoi përdorimin e rrezes si njësi në funksionet trigonometrike. Ai shtoi funksionet sekante, kosekante dhe kotangjente në funksione të tilla si sinusi dhe kosinusi. Ai gjithashtu studioi problemin e trisektimit të një këndi duke përdorur vetëm një vizore dhe busull dhe prezantoi qasje të reja për këtë problem.

Gjeografi

El Biruni gjithashtu kreu punë të rëndësishme në gjeografi dhe llogariti dimensionet e Tokës. Ai përcaktoi gjerësitë dhe gjatësitë gjeografike të shumë vendeve gjeografike dhe vizatoi harta. Ai sugjeroi që detet përfundimisht mund të bëheshin tokë dhe se kontinentet ishin të lëvizshme. Gjatë vizitave të tij në Indi, ai studioi gjeografinë dhe kulturën e rajonit në detaje. Sot, Biruni konsiderohet themeluesi i shkencës së gjeodezisë.

Fizikë

Biruni gjithashtu kreu kërkime në fushën e fizikës, veçanërisht mbi gravitetin specifik të substancave. Ai përcaktoi gravitetin specifik të 23 trupave të ngurtë dhe 6 lëngjeve që të ishte shumë afër vlerave të tyre aktuale. Ai propozoi ide mbi teorinë e gravitetit 700 vjet para Njutonit.

Mjekësia dhe Farmakologjia

Biruni gjithashtu shkroi vepra në fushën e mjekësisë, duke kryer kërkime mbi bimët medicinale dhe ilaçet, dhe duke dhënë kontribute të rëndësishme në shkencën e farmacisë. Në veprën e tij “Kitabu’s Saydane”, ai përshkroi vetitë e më shumë se 3,000 bimëve dhe shërimet e tyre të mundshme për sëmundje të ndryshme.

Studime kulturore

Biruni studioi gjithashtu histori, filozofi, fe dhe gjuhësi, dhe eksploroji kultura të ndryshme. Në angazhimin e tij rreth Indisë, ai u thellua në kulturën, gjuhën dhe filozofinë indiane. Ai gjithashtu lehtësoi përkthimin e terminologjisë shkencore midis gjuhëve të ndryshme.

PARIMET E PUNËS SË EL BIRUNIT

Biruni iu përmbajt parimeve të objektivitetit, saktësisë dhe përpikërisë. Në punën e tij, El Biruni mbante komunikim të vazhdueshëm me shkencëtarë të tjerë dhe shkëmbente ide me ta. Ai korrespondonte me shkencëtarë kryesorë të kohës,

“Dituria është thesari më i çmuar i njeriut.”

El Biruni

si Ibën Sina, dhe merrej me diskutime mbi tema shkencore, veçanërisht nxehtësinë dhe dritën. Puna e tij shkencore motivohej nga etja për dije dhe dëshira për t'i sjellë dobi njerëzimit. Synimet e tij shkencore përfshinin kuptimin e universit, zbulimin e mistereve të natyrës dhe kontributin në njohuritë njerëzore. Ai miratoi parimet e mëposhtme në punën e tij shkencore:

Mosdiskriminimi midis degëve të shkencës dhe dhënia e meritës secilës.

Respektimi dhe përfitimi nga veprat e shkencëtarëve të mëparshëm.

Sigurimi i lirisë për mendimin shkencor.

Bazimi i studimeve shkencore në metoda të qarta dhe të shëndosha.

Të pastrojë shkencën nga supersticionet, magjia dhe besëtytnitë.

Të inkurajojë shkencëtarët dhe t'u ofrojë atyre mundësitë e nevojshme financiare dhe sociale.


Të respektojë shkencën, veprat shkencore dhe shkencëtarët.

MËSIMET E TIJ

Biruni zotëronte një pasion të pangopur për kërkimin dhe fliste rrjedhshëm shumë gjuhë, duke përfshirë gjuhët: khwarezmiane, sogdiane, arabe, perse, turke dhe sanskritishte. Ajo që e dallon Birunin në historinë e shkencës islame është suksesi i tij në shkencat natyrore dhe matematikore, si dhe theksi i tij në vëzhgim dhe eksperimentim.

Biruni, i cili shkroi shumë vepra gjatë gjithë jetës së tij, u përqendrua kryesisht në astronomi dhe matematikë.


Një nga kontributet më të mëdha të Birunit në matematikë ishte në fushën e trigonometrisë. Duke pranuar rrezen si njësi në funksionet trigonometrike, ai shtoi funksionet sekante, kosekante dhe kotangjente në funksionet e njohura sinusale dhe kosinusale. Një nga veprat e tij më të famshme, duke përdorur gjithashtu trigonometrinë, ishte llogaritja me





shumë saktësi e rrezes së Tokës. Për ta bërë këtë, ai duhej të ngjitej në një mal pranë qytetit të tij të lindjes. Biruni, i cili ishte i interesuar në gjeologji, gjeografi dhe fizikë, si dhe në astronomi, zbuloi shumë kohë para Njutonit se Toka ishte e rrumbullakët, rrotullohej dhe për këtë arsye duhet të kishte një forcë gravitacionale. Shtatëqind vjet para Njutonit, El Biruni propozoi idetë e para mbi teorinë e gravitetit, të provuara matematikisht nga Netwon. Gjashtëqind vjet para Galileos, i cili konfirmoi se planetët rrotullohen rreth Diellit përmes vëzhgimeve që zhvilloi me teleskopë, El Biruni mbështeti idenë se Toka rrotullohet. Kur u pyet pse pemët dhe shkëmbinjtë nuk fluturojnë nëse toka rrotullohet, ai u përgjigj se ekziston një tërheqje qendrore dhe se gjithçka bie në qendër të tokës. Ai parashikoi se Veriu, Jugu, Lindja dhe Perëndimi takohen në pika të ndryshme dhe se ekziston një masë tokësore përtej deteve (Amerika e sotme).

El Biruni ndërroi jetë në moshën 75 vjeçare. Ai frymëzoi shkencëtarë të tillë si Njutoni, Torriçeli, Koperniku dhe Galileo shumë kohë pas tij. Revista UNESCO Courier, e botuar në 15 gjuhë, përfshirë turqishten, ia kushtoi numrin e saj të vitit 1974 El Birunit. Ajo e prezantoi El Birunin si “gjenium universal që jetoi një mijë vjet më parë në Azinë Qendrore”.



VEPRAT E STUDIUESIT TË GJITHANSHËM EL BIRUNIT:

- *El Âsârü'l-Bâkiye 'ani'l-Kurûni'l-Hâliye*: nshr. E. Sachau, Chronologie Orientalischer Völker von Alberuni, Leipzig 1878, 1923.
- *Tahdidü Nihâyâtî'l-Emâkin li-Tashîhi Mesâfâtî'l-Mesâkin*: Süleymaniye Ktp., Fâtih, nr. 3386.
- *Et-Tefhîm fî Evâ'ili Sînâ'ati't-Tencîm*: nshr. Ramsay Wright, The Book of Instruction in the Art of

Astrology, London 1934; nshr. Celâleddin Hümâi, Tahran 1362/1983-84.

- *Tahkîku mâ li'l-Hind min Makûletin Makbûletin fi'l-Akl ev Merzûle*: nshr. E. Sachau, London 1887.
- *El Kanûnü'l-Mes'ûdî*: Haydarâbâd-Dekken 1954-1956.
- *El Cemâhir fi'l-Cevâhir*: nshr. F. Krenkow, Haydarâbâd-Dekken 1936.
- *Es Saydele fi't-Tib*: Karaçi 1973.
- *Risâle fî Fihristi Kütübi Muhammed b. Zekerîyyâ er-Râzî*: nshr. Paul Kraus, Épître de Beruni Contenant le Répertoire des Ouvrages de Muhamad b. Zakariya al-Razia, Paris 1936.

1. M. Hüseyin-i Tebrizî, *Burhân-ı Kâfî* (nshr. M. Muîn), Tahran 1330 hş./1951, nâşirin notu, I, 336.
2. *The Determination of the Coordinates of Cities* (trc. Jamil Ali), Beirut 1967.
3. *Kitâbü't-Tefhîm li-evâ'ili şînâ'ati't-tencîm: The Book of Instruction in the Elements of the Art of Astrology* (trc. ve nshr. R. Ramsay Wright), London 1352/1934.
4. *Épître de Bêrûnî contenant le répertoire des Ouvrages de Muhammad b. Zakariyyâ al-Râzî* (ed. P. Kraus), Paris 1936.
5. B. Carra de Vaux, *Les penseurs de l'Islam*, Paris 1921, II, 75-87, 215-217.
6. Barthold, *İslâm Medeniyeti*, s. 52.
7. *An Annotated Bibliography of Islamic Science*, Tahran 1975, I, 198-208; II, 178-184.
8. “Bağımsız Bir Filozof”, a.e., s. 38-41.
9. “Abū Raihān al-Bīrūnī”, *HI*, II/2 (1979), s. 91-97.
10. H. Corbin, *Histoire de la philosophie islamique*, Paris 1964, s. 208-210.
11. M. Salim Atchekzai, “Bilimsel Gözlemin Öncüsü”, a.e., s. 16-19.
12. Hakim M. Said, “Ortaçağ İslâm Dünyasında Eczacılığın Babası”, a.e., s. 32-37.
13. “Bīrūnī”, *Encyclopaedia of Asian History*, New York 1988, I, 164-165.

Fakulteti i Studimeve Islame në Prishtinë – ombrellë e dijes islame

Dr. Azmir Jusufi

Fakulteti i Studimeve Islame në Prishtinë, është institucioni më i lartë edukativo-arsimor i Bashkësisë Islame të Kosovës, i cili filloi punën e tij nga fundi i vitit 1992.¹

Në mbledhjen e 7 qershorit 1992 të Kuvendit të Bashkësisë Islamike të Kosovës, dr. Rexhep Boja, në emër të Komisionit Amë, të formuar nga dr. Pajazit Nushi, mr. Ismail Ahmeti, mr. Qemajl Morina, Isa Bajqinca, Jashar Jashari, Miftar Ajdini dhe Naim Tërnavë, paraqiti synimet lidhur me ngritjen e Fakultetit të Studimeve Islame. Njëkohësisht ishin hartuar Statuti dhe plan-programet e tij. Në bazë të plan-programit përfshiheshin 23 disiplina, nga të cilat 2/3 e zinin lëndët fetare, kurse pjesa tjetër përbëhej nga lëndët e kulturës së përgjithshme. Ky fakultet gjeti miratimin edhe të rektorit të Universitetit të Prishtinës, dr. Ejup Statovcit. Mbi këtë bazë, me 7 dhjetor 1992, Fakulteti i Studimeve Islame hapi dyert e tij. Dekan i këtij Fakulteti u zgjodh nga Meshihati i Kosovës dr. Rexhep Boja, ndërsa zëvendës dekan u zgjodh mr. Qemajl Morina.²

Misioni i Fakultetit të Studimeve Islame në Prishtinë është edukimi dhe përgatitja e kadrove profesionale e shkencore për nevojat e Bashkësisë Islame, të institucioneve dhe organeve të saj edukativo-arsimore, në frymën e parimeve shkencore dhe të vlerave bashkëkohore nga fusha e studimeve islame.³

Është fakulteti i vetëm në Kosovë që ofron studime në fushën e Teologjisë Islame, dhe i gjithë procesi bazohet mbi kriteret dhe standardet e procesit të Bolonjës. Vlen të

cekset se Fakulteti ka filluar të zbatojë procesin e Bolonjës qysh nga viti 2001, atëherë kur edhe ka filluar të zbatohet ky proces në Kosovë. Po ashtu, menaxhmenti i fakultetit është i përkushtuar të vazhdojë dhe të avancojë me implementimin e procesit të Bolonjës, duke qenë të përkushtuar në avancimin e cilësisë duke respektuar Ligjin mbi Arsimin e Lartë të Kosovës, objektivat që dalin nga deklarata e Bolonjës, Standardet Evropiane për Siguri të Cilësisë, standardet të Agjencisë së Kosovës për Akreditim dhe gjithmonë duke synuar hapësirën evropiane të arsimit të lartë.⁴

Fakulteti ka për qëllim që të sigurojë kushte për arsimimin e kadrove shkencore-mësimore; të zhvillojë kushtet për hartimin e literaturës shkencore mësimore për nevojat e mësimin, të zhvillojë kushte për mësimdhënie dhe mësimnxënie cilësore, t'u ofrojë shërbime profesionale e shkencore organeve dhe institucioneve të Bashkësisë Islame dhe institucioneve të tjera, të zhvillojë bashkëpunim me fakultetet simotra teologjike dhe me institucione e asociacione të tjera shkencore-arsimore në vend dhe jashtë.⁵

Avancimi i cilësisë, ndërkombëtarizimi, zhvillimi i punës shkencore, mësimdhënia dhe nxënia kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë për Fakultetin e Studimeve Islame në Prishtinë aspekte kyçe të zhvillimit të fakultetit, komunitetit dhe shoqërisë.⁶

Në kuadër të Fakultetit të Studimeve Islame në Prishtinë funksionojnë dy programe të

Është fakulteti i vetëm në Kosovë që ofron studime në fushën e Teologjisë Islame, dhe i gjithë procesi bazohet mbi kriteret dhe standardet e procesit të Bolonjës.

Fokusi i fakultetit është orientuar edhe në zhvillimin e hulumtimeve, posaçërisht, në studimet Master, ku kandidatët e studimeve Master do të inkurajohen që punën e tyre ta prezantojnë në forumet shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare.



studimit: programi në nivelin Bachelor⁷ dhe programi në nivelin Master.⁸

Fakulteti i Studimeve Islame në Prishtinë, më 06 korrik 2012 është akredituar për tri vjet, dhe kjo është puna dhe arritja më e madhe që është realizuar por, hiq më pak e vlefshme për kah pesha dhe rëndësia që ka, nuk mbetet as çështja e inkorporimit të Fakultetit të Studimeve Islame në Prishtinë si njësi e veçantë në kuadër të Universitetit publik të Prishtinës. Realiteti është se më 28 shtator 2012,

Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës ka marrë vendim për inkorporimin e Fakultetit të Studimeve Islame në Prishtinë si njësi e barabartë akademike në kuadër të Universitetit publik të Prishtinës.⁹

Përmes marrëveshjeve të ndryshme të bashkëpunimit janë arritur bashkëpunime në fushat e shkëmbimit dhe komunikimit të fakultetit, stafit akademike dhe studentëve me institucione të tjera. Kjo me qëllim të arritjes së standardeve më të larta në fushën e mësimdhënies, nxënies, hulumtimeve, por edhe të shërbimeve administrative. Është krijuar edhe zyra/zyrtari për marrëdhënie me jashtë, i cili funksionon tanimë krahas zyrës për sigurim të cilësisë.¹⁰

Në aspektin e zhvillimit të cilësisë në Fakultetin e Studimeve Islame në Prishtinë është fokusuar në avancimin e proceseve dhe mekanizmave të vlerësimit si të stafit akademik ashtu edhe të studentëve dhe cilësisë në përgjithësi. Involvim më gjithëpërfshirës i stafit akademik, studentëve, administratës por edhe tregut të punës në proceset e zhvillimi të cilësisë. Rishqyrtimi dhe zhvillimi i mekanizmave adekuate për

zhvillimin dhe vlerësimin e programeve të studimit përfshirë këtu edhe mekanizmat e monitorimit.

Fakulteti i Studimeve Islame në Prishtinë përveç synimit që ka të avancojë punën kërkimore shkencore të stafi akademik, gjithashtu është i përkushtuar që të avancojë në përfshirjen e studentëve në punën kërkimore shkencore dhe atë duke i stimuluar studentët përmes punimeve që ndërliken ngushtë me nevojat dhe interesin publik.

Fokusi i fakultetit është orientuar edhe në zhvillimin e hulumtimeve, posaçërisht, në studimet Master, ku kandidatët e studimeve Master do të inkurajohen që punën e tyre ta prezantojnë në forumet shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare dhe atë në bashkëpunim të ngushtë me mentorin apo profesorin përkatës.

Në zhvillimin dhe reformimin e kurikulave, procesit të mësimdhënies dhe mësim-nxënies si dhe procesin e vlerësimit në konsulta, debate dhe analiza do të përfshihen përveç stafit akademik, administrative, menaxhmentit dhe studentët, edhe anëtarët e tregut të punës.¹¹

1 Fakulteti i Studimeve Islame i Prishtinës, *Buletini 1*, (Prishtinë: 2010) 5.

2 Ramiz Zekaj, *Zhvillimi i kulturës islame te shqiptarët gjatë shekullit XX*, AIITC-Tiranë, (Tiranë: 1997), 66.

3 Vedat Shabani & Besnik Fetahu (PhD), “Procesi i Bolonjës: Sfidat e Fakultetit të studimeve islame rreth sigurimit të cilësisë”, *Buletini 4*, Fakulteti i Studimeve Islame i Prishtinës, (Prishtinë: 2016) 217.

4 Fakulteti i Studimeve Islame në Prishtinë, *Plani strategjik i Fakultetit të Studimeve Islame 2021–2025*, shkarkuar nga ueb-faqja: <https://fsi-edu.net/wp-content/uploads/2024/11/Plani-Strategjik-2021-2025.docx>, më: 18.04.2025.

5 Fakulteti i Studimeve Islame i Prishtinës, *Buletini 2*, (Prishtinë: 2012) 6.

6 Fakulteti i Studimeve Islame në Prishtinë, *Plani strategjik i Fakultetit të Studimeve Islame 2021–2025*, op. cit.

7 <https://fsi-edu.net/planprogramet-ba/>.

8 <https://fsi-edu.net/planprogramet-ma/>.

9 Qazim Qazimi, “Akreditohet Fakulteti i studimeve islame dhe inkorporohet në kuadër të Universitetit të Prishtinës”, *Buletini 2*, Fakulteti i Studimeve Islame i Prishtinës, (Prishtinë: 2012) 5.

10 Fakulteti i Studimeve Islame në Prishtinë, *Plani strategjik i Fakultetit të Studimeve Islame 2021–2025*, op. cit.

11 Po aty.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM TË NGARKUARIN ME PUNË NË AMBASADËN E JAPONISË NË KOSOVË, Z. HIROYASU TANIGAKI



Më 26 gusht 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në një takim kurtuazie të ngarkuarin me punë në Ambasadën e Japonisë në Kosovë, z. Hiroyasu Tanigaki.

Gjatë këtij takimi, Myftiu Tërnavë e njohu mysafirin japonez me historikun, organizimin dhe aktivitetet e Bashkësisë Islame të Kosovës, si dhe me rolin e saj në avancimin e vlerave fetare, morale

dhe shoqërore në vend. Ai theksoi se Bashkësia Islame e Kosovës është gjithmonë e angazhuar për të kontribuar në mirëqenien shpirtërore dhe sociale të qytetarëve, si dhe për ruajtjen e harmonisë ndërfetare, e cila është një prej vlerave më të çmuara të shoqërisë kosovare.

Myftiu Tërnavë me këtë rast e falënderoi z. Tanigaki dhe përmes tij tërë shtetin e Japonisë për mbështetjen

e vazhdueshme që i ka dhënë Kosovës në fusha të ndryshme, duke e vlerësuar këtë ndihmë si një kontribut të çmuar për zhvillimin dhe konsolidimin e vendit.

Nga ana e tij, z. Tanigaki shprehu mirënjohjen për mikpritjen, si dhe vlerësoi rolin pozitiv të Bashkësisë Islame të Kosovës në shoqëri, duke shprehur gatishmërinë për vazhdimin e bashkëpunimit në të ardhmen.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM DREJTORIN E PËRGJITHSHËM TË FONDACIONIT TË DIJANETIT, Z. IZANI TURAN



Më 26 gusht 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim drejtorin e Përgjithshëm të Fondacionit të Dijanetit, z. Izani Turan, i cili shoqërohej edhe nga anëtari i Bordit Drejtues të Fondacionit, doc. dr. Fatih Kurt.

Myftiu Tërnavë e falënderoi z. Turan dhe Fondacionin e Dijanetit për ndihmat e vazhdueshme që kanë dhënë për Kosovën, si dhe për bashkëpunimin e ngushtë që kanë zhvilluar me Bashkësinë Islame të Kosovës. Ai veçoi bashkëpunimin e theksuar me Shoqatën Humanitare “Bereqeti”, përmes së cilës janë realizuar projekte të

shumta me rëndësi për qytetarët dhe besimtarët tanë.

Nga ana e tyre, përfaqësuesit e Fondacionit të Dijanetit shprehën mirënjohjen për pritjen dhe vlerësuan angazhimin e Bashkësisë Islame të Kosovës në shërbim të besimtarëve dhe shoqërisë në përgjithësi.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM LAMTUMIRËS SHEFEN E UNMIK-UT, ZNJ. CAROLINE ZIADEH

Më 5 gusht 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim lamtumirës shefen e Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), znj. Caroline Ziadeh.

Gjatë takimit, Myftiu Tërnavë falënderoi znj. Ziadeh për bashkëpunimin

korrekt dhe kontributin e saj gjatë mandatit në Kosovë, duke theksuar rëndësinë e mbështetjes ndërkombëtare për paqen, stabilitetin dhe zhvillimin demokratik të vendit.

Nga ana e saj, znj. Ziadeh vlerësoi rolin e Bashkësisë Islame të Kosovës në promovimin e tolerancës ndërfetare

dhe bashkëjetesës, duke e konsideruar BIK-un si një partner të rëndësishëm në proceset paqësore dhe ndërtimin e një shoqërie gjithëpërfshirëse.

Në fund të takimit, Myftiu Tërnavë i uroi znj. Ziadeh suksese në angazhimet e saj të ardhshme.



MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM KRYETARIN E KMSHZ-SË, Z. MEHAS ALIJA



Më 1 gusht 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim kryetarin e Komunitetit Mysliman Shqiptar në Zvicër, z. Mehas Alija, i cili shoqërohej edhe nga zëvendësit e tij, Fehim Abazi dhe Besim Nuzi, si dhe nga anëtarët e tjerë të Kryesisë.

Gjatë këtij takimi të përzemërt dhe vëllazëror, të dy palët diskutuan për intensifikimin e bashkëpunimit ndër-institucional, për organizimin e aktiviteteve të përbashkëta në të

ardhmen, si dhe për forcimin e lidhjeve mes mërgatës shqiptare në Zvicër dhe institucioneve fetare në atdhe.

Myftiu Tërnavë shprehu mirënjohjen e tij për përkushtimin e Komunitetit Mysliman Shqiptar në Zvicër në ruajtjen e identitetit fetar dhe kombëtar në diasporë, si dhe në promovimin e vlerave islame ndër shqiptarët jashtë vendit. Ai theksoi rëndësinë e unitetit dhe bashkëpunimit në përballimin e sfidave të përbashkëta.

Nga ana e tij, z. Alija falënderoi Myftiun për pritjen dhe vlerësoi rolin udhëheqës të Bashkësisë Islame të Kosovës në çështjet fetare dhe kombëtare. Ai shprehu gatishmërinë për thellimin e mëtejshëm të bashkëpunimit në fusha të ndryshme, përfshirë edukimin fetar, shkëmbimet e përvojave dhe përkrahjen e aktiviteteve që forcojnë komunitetin mysliman shqiptar kudo që ndodhet.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM KRYETARIN E OVL-SË SË UÇK-SË Z.HYSNI GUCATI



Më 4 gusht 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim e. Tërnavë, ka pritur në takim kryetarin e OVL-së së UÇK-së z.Hysni Gucati.

Myftiu Tërnavë falënderoi z.Gucati për vizitën dhe vlerësoi lart punën dhe angazhimin e OVL-së së UÇK-së në ruajtjen e vlerave të luftës së ushtrisë tonë të lavdishme dhe kultivimin e këtyre vlerave te brezat që vijnë për të

mbrojtur këtë trashëgimi të shtrenjtë të kombit.

Nga ana e tij, z.Hysni Gucati falënderoi Myftiun për mikpritjen e ngrohtë dhe vlerësoi kontributin e Bashkësisë Islame të Kosovës gjatë luftës së fundit dhe sakrificën e imamëve dëshmorë në rradhët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në mbrojtje të lirisë dhe atdheut.

Gjatë takimit u diskutua edhe për protestën paqësore të organizuar nga OVL e UÇK-së, të cilën Myftiu Tërnavë e mbështeti dhe e përkrahu dhe me këtë rast ftoi besimtarët dhe bëri thirrje për pjesëmarrje masive në këtë protestë paqësore, për t'i dalë zot vlerave të Ushtrisë së lavdishme çlirimtare të Kosovës dhe në mbrojtje e përkrahje të dhe krerëve të saj, të cilët po gjykohen padrejtësisht nga Gjykata Speciale në Hagë.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM DREJTORIN E INSTITUTIT TË KRIMEVE TË LUFTËS, Z. ATDHE HETEMI



Më 4 gusht 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim drejtorin ekzekutiv të Institutit për Krimet e Kryera Gjatë Luftës në Kosovë, z. Atdhe Hetemin.

Me këtë rast, Myftiu Tërnavë dhe drejtori Hetemi, nënshkruan një protokoll bashkëpunimi, që synon

forcimin e partneritetit në procesin e dokumentimit të krimeve të luftës dhe ruajtjes së kujtesës kolektive.

Gjatë takimit, Myftiu Tërnavë vlerësoi lart punën dhe angazhimin e Institutit për Krimet e Kryera Gjatë Luftës në Kosovë në shërbim të së vërtetës dhe drejtësisë, duke theksuar se BIK-u

mbështet çdo përpjekje për zbardhjen dhe dokumentimin e së kaluarës.

Në anën tjetër, drejtori Atdhe Hetemi falënderoi Bashkësinë Islame të Kosovës për punën që është duke e kryer dhe mbështetjen e ofruar në çdo periudhë të rëndësishme që ka kaluar vendi.

MYFTIU TËRNAVA DHE KRYETARI RAMA VIZITUAN PUNISHTEN E XHAMISË QENDRORE

Më 12 gusht 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë me bashkëpunëtorë, i shoqëruar nga kryetari i Prishtinës, z. Përparim Rama vizituan punishten e Xhamisë Qendrore në Prishtinë, për të parë nga afër punimet e kryera deri më tani.

Xhamia Qendrore në Prishtinë është duke u financuar nga fondacioni i Dijanetit të Turqisë.



MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM LAMTUMIRËS KËSHILLTARIN PËR ÇËSHTJE FETARE TË TURQISË, Z. BUNJAMIN ALBAYRAK

Më 26 gusht 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në një takim lamtumirës këshilltarin për Çështje Fetare pranë Ambasadës së Turqisë në Kosovë, z. Bunjamin Albayrak, me rastin e përfundimit të mandatit të tij në vendin tonë.

Myftiu Tërnavë e falënderoi z. Albayrak për bashkëpunimin e ngushtë dhe kontributin e çmuar gjatë tri vjetëve të shërbimit të tij në Kosovë. Ai i uroi shëndet dhe suksese në misionin e ri, duke e falënderuar njëkohësisht edhe shtetin dhe popullin turk për ndihmën dhe mbështetjen e vazhdueshme që i kanë dhënë Kosovës dhe institucioneve të saj fetare.

Nga ana e tij, z. Bunjamin Albayrak shprehu mirënjohjen e tij për pritjen dhe bashkëpunimin e treguar nga Myftiu Tërnavë dhe Bashkësia Islame e Kosovës gjatë qëndrimit të tij. Ai theksoi se për tri vjet sa qëndroi në Kosovë është ndier si në shtëpinë e vet, duke vlerësuar lart mikpritjen e popullit



kosovar dhe lidhjet e forta vëllazërore ndërmjet dy vendeve.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM NJË DELEGACION NG ORGANIZATA HUMANITARE “DENIZ FENERI” NGA TURQIA

Më 28 gusht 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, priti në takim një delegacion nga organizata humanitare “Deniz Feneri” nga Turqia, të kryesuar nga z. Ismail Selimi.

Myftiu Tërnavë, fillimisht iu uroi mirëseardhje mysafirëve, duke shprehur respekt dhe mirënjohje për vizitën e tyre, e më pas i falënderoi ata për ndihmat e vazhdueshme që kanë dhënë dhe që po japin për Shoqatën Humanitare Bamirëse “Bereqeti” dhe

për familjet nevojtare në Kosovë. Ai tha se tanimë organizata “Deniz Feneri” është një ndër mbështetësit kryesorë të shoqatës “Bereqeti”, duke e cilësuar këtë partneritet si një model frymëzues të solidaritetit dhe bashkëpunimit të ndërsjellë. Më pas, Myftiu Tërnavë i

njohu mysafirët edhe me aktivitetin e shoqatës “Bereqeti” anekënd Kosovës, duke përmendur shembuj konkretë të projekteve që janë realizuar për të ndihmuar shtresat në nevojë.

Është me rëndësi të theksohet se “Deniz Feneri” prej vitesh është ndër mbështetësit kryesorë të shoqatës “Bereqeti”, duke kontribuar jo vetëm me ndihma materiale, por edhe me përvoja dhe praktika të mira të organizimit humanitar. Edhe gjatë kësaj vizite, delegacioni solli në Kosovë dy kontingjente të reja me pajisje elektrike, të cilat do t’u shpërndahen familjeve



nevojtare, si dhe organizatave dhe OJQ-ve të ndryshme në vend, duke e bërë këtë ndihmë një dëshmi konkrete të

kujdesit dhe përkushtimit të tyre të vazhdueshëm.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM PRONARIN E KOMPANISË “ALTRADE”, Z. SOKOL GASHANI

Më 28 gusht 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim pronarin e kompanisë “Altrade”, biznesmenin e njohur, z. Sokol Gashani, i cili shoqërohej nga kryetari i Këshillit të BI-së së Drenasit, Valon ef. Bequku.

Me këtë rast, z. Gashani e ka njoftuar Myftiun Tërnavë për vendimin e tij fisnik që të dhurojë një parcelë toke në qendër të Drenasit, e cila do të shërbejë për ndërtimin e një xhamie.

Myftiu Tërnavë e falënderoi z. Gashani për këtë veprim bamirës dhe kontributin e tij të çmuar në përkrahje të jetës fetare dhe të mirëqenies së besimtarëve të Drenasit. Ai e vlerësoi këtë gjest si një shembull frymëzues të solidaritetit dhe përkushtimit ndaj komunitetit, duke theksuar se veprime të tilla e forcojnë edhe më shumë



lidhjen ndërmjet besimtarëve dhe institucioneve fetare. Në fjalën e tij, Myftiu u lut që Zoti i Madhëruar ta shpërblejë z. Gashanin dhe familjen e tij

me të mira e begati të shumta, si në këtë botë, ashtu edhe në botën tjetër, duke ua shtuar atyre shëndetin, bereqetin dhe respektin në mesin e njerëzve.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM NJË DELEGACION NGASHOQATA “Joud” E KUVAJTIT

Më 29 gusht 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim një delegacion nga Shoqata “Joud” e Kuvajtit, të kryesuar nga dr. Rashid el Axhmi.

Gjatë këtij takimi u diskutua për bashkëpunimin e deritanishëm dhe për mundësinë e intensifikimit të tij në të



ardhmen, në të mirë të qytetarëve dhe besimtarëve tanë.

Myftiu Tërnavë shprehu mirënjohjen e tij për ndihmat e vazhdueshme që kjo

shokatë ka dhënë ndër vite, duke theksuar sidomos kontributin e fundit me ndërtimin e xhamisë në fshatin Negroc të Drenasit.

Në fund të takimit, Myftiu e falënderoi delegacionin për përkrahjen e tyre të çmuar dhe luti Zotin që t'i shpërblejë me të mira për punët e tyre bamirëse.

SEKRETARI SADRIU PRITI NË TAKIM NJË DELEGACION NGA FAKULTETI I SHKENCAVE ISLAME TË SARAJEVËS

Më 16 gusht 2025, sekretari i Përgjithshëm i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, njëherësh zëvendësmyfti i Kosovës, Ahmet ef. Sadriu, ka pritur në takim një delegacion nga Fakulteti i Shkencave Islame të Sarajevës, të cilit i printe prodekani i këtij Fakulteti, prof. dr. Zuhdija Hasanović.

Fillimisht sekretari Sadriu iu uroi mirëseardhje mysafirëve, duke shprehur vlerësim për vizitën e tyre miqësore, e më pas i njohu ata me punët dhe aktivitetet e Bashkësisë Islame të Kosovës, me theks të veçantë për



institucionet arsimore, siç janë medresetë dhe Fakulteti i Studimeve Islame, duke përmendur rolin e tyre të

pazëvendësueshëm në ruajtjen dhe zhvillimin e identitetit fetar e kulturor në vend.

SEKRETARI SADRIU PRITI NË TAKIM IMAMIN DIDMAR EF. FAJA

Më 22 gusht 2025, sekretari i Përgjithshëm i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, njëherësh zëvendësmyfti i Kosovës, Ahmet ef. Sadriu, ka pritur në takim imamin e Qendrës Islame në Arizona, Didmar ef. Faja, i cili shoqërohej nga Ferid Lluja.

Gjatë këtij takimi sekretari Sadriu e njohu imamin Faja me punët, angazhimet dhe veprimtarinë e Bashkësisë Islame të Kosovës, me theks të veçantë për bashkëpunimin që kanë me qendrat islame shqiptare në diasporë. Ai shprehu gatishmërinë e institucionit të BIK-ut, që të ketë bashkëpunim edhe me Qendrën Islame në Arizona.



Nga ana e tij, imami Faja, falënderoi sekretarin Sadriu për pritjen, duke shprehur kështu përkushtimin e tij për

një bashkëpunim ndërmjet Qendrës ku ai vepron dhe Bashkësisë Islame të Kosovës.

FSHATI I RI I VITISË BËHET ME XHAMI TË RE

Më 1 gusht 2025, Fshati i Ri i Vitisë u bë me xhami të re. Ky përrurim u bë ditën e xhuma, me një solemnitë të organizuar nga Këshilli i Bashkësisë Islame të Vitisë.

Përveç besimtarëve të shumtë, në këtë hapje morën pjesë edhe kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, kryetari i



Vitisë, z. Sokol Haliti, përfaqësuesit e Këshillit të BI-së së Vitisë, si dhe donatori z. Ajet Doberjanca.

Programi filloi me leximin e disa pjesëve nga Kurani fisnik, të cilat sollën

një atmosferë të veçantë shpirtërore, e mëpas vazhdoi me fjalimet e mysafirëve, ku u theksua rëndësia e ndërtimit të xhamive si qendra jo vetëm të adhurimit, por edhe të edukimit dhe unitetit shoqëror. Pjesëmarrësit uruan

për hapjen e kësaj xhamie të re, duke e cilësuar atë si një vlerë të shtuar për jetën fetare dhe shoqërore të komunitetit lokal., kulturore dhe komunitare në këtë trevë.

NË FSHATIN KIJEVË U VENDOS GURTHEMELI I XHAMISË

Më 16 gusht 2025, në fshatin Kijevë të Komunës së Malishevës, me një ceremoni solemne, u vendos gurthemeli i xhamisë së re.

Në këtë ceremoni morën pjesë kryeimami i Bashkësisë Islame të

Kosovës, Vedat ef. Sahiti, përfaqësuesit e Këshillit të BI-së së Malishevës, përfaqësues të bashkësive lokale, imamë, si dhe banorë të fshatit.

Kryetari i Këshillit të BI-së së Malishevës, Sead ef. Paqarizi, falënderoi

të gjithë kontribuuesit dhe theksoi se ndërtimi i xhamisë është një amanet i përbashkët për komunitetin fetar në këtë trevë.

Në fjalën e tij, kryeimami i Republikës së Kosovës, Vedat ef. Sahiti, nënvizoi se xhamia është jo vetëm vend faljeje, por edhe shkollë edukimi dhe vatër e bashkimit për xhematin.

Toka për ndërtimin e xhamisë është dhuruar si vakëf nga z. Kastriot Gashi, ndërsa një pjesë e mjeteve janë siguruar nga mërgata shqiptare dhe xhemati i xhamisë “Masjid-u Sunnah” në Madison, ShBA.

Ceremonia u përmbyll me dua dhe lutje për mbarësi në realizimin e këtij projekti.



FSHATI NEGROC BËHET ME XHAMI TË RE

Më 29 gusht 2025, besimtarët e fshatit Negroc të Drenasit u bënë me xhami të re. Ata, nën këndimin e tekbiereve dhe me lexim Kurani, përruruan xhaminë e ndërtuar nga shoqata “Joud” e Kuvajtit, me donator Naser Ibrahim Naser el Hajri.

Në fjalën e tij përshëndetëse drejtuar të pranishmëve, kryeimami i Kosovës,

Vedat ef. Sahiti, pas urimeve për banorët për hapjen e kësaj xhamie, falënderoi mysafirët nga Kuvajti për donacionin, duke potencuar se aty ku ka minare zbret mirësia, zbresin mëshira dhe begatitë e pafundme. Ai tha se populli ynë, gjithmonë do të jetë mirënjohës ndaj shtetit dhe popullit të Kuvajtit.

Dr. Rashed el Axhmi nga shoqata “Joud”, tha se sot, një ëndërr të kahmotshme po e bëjmë realitet. Ai evokoi kujtime kur bashkë me përfaqësuesit e Bashkësisë Islame të Kosovës kishin biseduar për ndërtimin e kësaj xhamie në këtë fshat.

Ndërkohë kryetari i Këshillit të BI-së së Drenasit, Valon ef. Bequku, falënderoi donatorët, duke e cilësuar këtë si një vepër simbol të besimit.

Në fund të programit, besimtarët falën edhe namazin e parë të xhumasë, hytben e së cilit e mbajti kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti.

Ndërtimi i kësaj xhamie nuk simbolizon vetëm ndërtimin e një objekti kulti, por ringjalljen e jetës fetare dhe shpirtërore në këtë komunitet.



DREJTORI SIMNICA PRITI NË TAKIM NËNKRYETARIN E XHAMISË “MESXHIDI NUR”, Z. XHABIR SHALA

Më 1 gusht 2025, drejtori i Diasporës në Kryesinë e Bashkësisë Islame të Kosovës, Ekrem ef. Simnica, priti nënkryetarin e xhamisë “Mesxhid Nur” në Frauenfeld, z. Xhabir Shala, i shoqëruar nga anëtarë i xhamisë “Uniteti”, z. Esad Berisha.

Drejtori Simnica i falënderoi mysafirët dhe, përmes tyre, mërgatën shqiptare për kontributin në jetën fetare të shqiptarëve në diasporë, duke shprehur gatishmërinë që bashkëpunimi me BIK-un të vazhdojë. Mysafirët, nga ana e tyre, falënderuan për pritjen dhe përkushtimin e institucionit për ruajtjen e lidhjeve me

qendrat islame jashtë vendit. Me këtë rast, Simnica ndau një fletëfalënderim

për xhaminë “Mesxhid Nur” për mbështetjen me mjete për kurbane.



DREJTORI SIMNICA PRITI NË TAKIM IMAMIN MUHAMET EF. HAVOLLI



Më 11 gusht 2025, drejtori i Diasporës në Kryesinë e Bashkësisë Islame të

Kosovës, Ekrem ef. Simnica, priti imamin e Qendrës Islame Shqiptare në

Karlsruhe dhe kryetarin e Unionit të Qendrave Islame në Baden-Württemberg, Muhamet ef. Havollin.

Në takim u diskutua për forcimin e bashkëpunimit mes Kryesisë dhe Unionit të Qendrave Islame në Gjermani, me theks te projektet e përbashkëta, organizimi i haxhit dhe nisma të tjera me rëndësi. Drejtori Simnica falënderoi imamin Havolli dhe, përmes tij, besimtarët shqiptarë në diasporë për kontributin e tyre të vazhdueshëm ndaj vendlindjes dhe Bashkësisë Islame të Kosovës.

DREJTORI SIMNICA PRITI NË TAKIM IMAMIN BURHAN EF. KUKAJ



Më 25 gusht 2025, drejtori i Diasporës në Bashkësinë Islame të Kosovës, Ekrem ef. Simnica, priti në

një takim miqësor imamin Burhan ef. Kukaj nga Qendra Islame në New Jersey, SHBA.

Simnica shprehu mirënjohje për kontributin e diasporës në jetën fetare e shoqërore, ndërsa imami Kukaj vlerësoi rolin e BIK-ut si lidhje e mërgatës me vendlindjen. U bisedua për forcimin e bashkëpunimit dhe ruajtjen e identitetit fetar e kombëtar, si dhe për projekte të përbashkëta në shërbim të komunitetit shqiptar në SHBA. Në fund, Simnica ndau një fletëfalënderim për imamin Kukaj dhe Qendrën Islame për dhurimin e kurbaneve.

Vallëzim në skenën e shkrumbuar

Shtator përsëri. Çfarë fati!
Për ty një shansi i ri,
dështimi është një lloj arti.
Do ta perfeksionosh. Unë besoj në ty!

Suksese! Kështu vazhdo! Ti je me të vërtetë hero!
Një nxënës më të vogël se vetja bullizo.
Ne të mbështesim, fëmijët janë fëmijë.
Ndërkohë që kjo ndodh, ne si prindër bëjmë "Scroll" në qetësi.

Koha është e çmueshme, me studim të mos e harxhojmë.
Bëhu i zgjuar - në "ChatGpt" çdo gjë do të gjejsh.
Bashkërisht mësimdhënësit do t'i fajësojmë,
orët pa limit, ngjitur në ekran, të justifikuara nga ne do t'i kesh.

Me sy të zgurdulluar ç'të duash artikulo...
Mirësjellja është për "Losers", mos harro.
Që ne do ta quajmë thjesht një frazë, kurrë mos dysho.
Në mënyrë që të qetësohesh: Çfarë të të blejmë? - vetëm urdhëro.

Mallko, shaj si të të teket,
ngritja e zërit fuqi tregon.
Duke qeshur nervoz prindi do të meket:
Lëreni fëmijën të shprehet! - publikisht kërkon.

Në asnjë çështje mos bëj durim,
dramat e dashurisë ke intensifiko.
Do të shquesh se ke shumë guxim,
"Instagramin" me postë mbulo.
Ndize, shpërthe!
Rebelimi është "In"
Për rininë tonë të plogësht do t'ju ligjërojmë me nge,
burimin e rebelimit tuaj do ta përkëdhelim me injorim.

Po me ëndrrat ç'të bëjmë?!
T'i lëmë të veniten.
Ngushëllimin në "Netflix" do ta gjejmë,
Pa provuar jetën e vërtetë, bashkë me juve si prind do të zvarritem.

Testoni limitet!
Si të vetmen shkencë që keni provuar.
Ne do të bëjmë "Google", adoleshentët si rriten,
ashtu kuturu, kurrë me të vërtetë pa ju dëgjuar.

Selam nga zemra për ty, o i Dërguar!

Emër që troket në çdo zemër,
Erdhe nga Meka e bekuar.
Muhamed, shumë mëshirë nga ky emër.
Paqe dhe selam për ty, o i Dërguar!

Bota nga padituria sundohej,
Idhujtaria çdo cep e mbulonte.
Por një breg shpëtimi afrohej,
Një dritë që zemrat do të ndriçonte.


Ti nga Mëshiruesi erdhe për ne mëshirë,
Kur çdo zemër ishte e turbulluar.
Rruga që kalove ishte shumë e vështirë,
Selam nga zemra për ty, o i Dërguar!

Sa këshilla e porosi na le,
Por shpesh ne i harrojmë.
"Për Kuran e Sunet mbahuni!" the,
Se faji është te ne, sikur nuk po e kuptojmë.

Mallin që shtohet pa të parë,
E shuan vetëm uji që do e pimë nga duart tua.
Me ty shpresojmë kurrë për të mos u ndarë.
Për hir të dashurisë për ty që vazhdimisht u shtua.

Anita Gërguri

BOTIM
I RI



“El-Ihtijaru li Ta’lili-l-Muhtari” në shqip

Tri komunitetet islame shqiptare sjellin për herë të parë në gjuhën shqipe veprën klasike hanefite “El-Ihtijaru li Ta’lili-l-Muhtari” të Imam Abdullah el-Mevsilijut. Ky botim është një ngjarje e rëndësishme për literaturën islame, duke ofruar një burim të vlefshëm për studiues e lexues të fushës së fik’hut.

Libri do të jetë i qasshëm në Tiranë, Prishtinë dhe Shkup, si fryt i një bashkëpunimi ndërinstitucional që pasuron trashëgiminë tonë fetare dhe kulturore.

DITURIA ISLAME • Nr. 418 SHTATOR 2025